binicilik em 1. hipje në kalë; 2. sport kalorësie
binmek *fl* ngjitem, hip në një lartësi ose në një mjet transporti
bir *em* një; **bir an,** një çast, një moment; ***bir daha***, edhe një herë; ***bir dakika***, një minutë; ***bir de. . . .***, edhe. . . . . ; ***bir defa***, një herë; ***bir saniye***, një sekundë; ***bir süre***, një kohë të caktuar; ***bir şey değil***, nuk është gjë; ***bir yerde***, në një vend **bira** *em* birrë
birader *em* vëlla
biraderlik *em* vëllazëri
birahane *em* vend ku shitet birra, pijetore
biraz *mb* pakë; ***biraz sonra***, pas pak kohe, pak më vonë
birazcık *ndf* pak, pakëz, shumë pak, një çikë
birazdan *ndf* tash shpejt; pas-pak kohe; ***birazdan geleceğim,*** do të vij pas pak kohe
birden *ndf* 1. me një herë; në të njejtën kohë; 2. befas, papritmas
birdenbire *ndf* pa pritmas, me një herë, ngutësisht, me hov; ***tren birdenbire durdu*** treni u ndal pa pritmas, menjëherë
birey e*m* individ, vetë
bireysel *mb* 1. individual, që i përket një individi, pesonal; 2. veçantë, i ndarë
bireysellik *em* individualizëm
biri *perem* 1. njëri (nga ata); 2. dikush
birikim *em* grumbullim
biriktirmek *fl* 1. grumbulloj, mbledh, akumuloj; 2. kursej
birim *em* njësi (matjeje); ***uzunluk birimi***, njësi gjatësie
birinci *mb* i parë; ***birinci sınıf***, klasa e parë; ***birinci dünya savaşı***, lufta e parë botërore; *em sp* kampion
birincilik *em* kampionat
birisi *përem* 1. njëri (nga ata); 2. dikush
birkaç *mb* disa , ca, do
birleşik *mb* 1. i bashkuar; ***Birleşik Amerika*** **Devletleri,**

Copyrighted material

Shtetet e bashkuara të Amerikës; 2. i përbërë, i përbashkët
birleşmek *fl* bashkohem
birleşmiş *mb* i bashkuar; ***Birleşmiş Milletler Teşkilatı***, Organizata e Kombeve të Bashkuara
birleştirmek *fl* bashkoj, njësoj, përbëj, lidh, ngjis (ngjit)
birlik *em* 1. bashkim; 2. lidhje, shoqatë; ***mimarlık* birliği**, shoqata e arkitektëve; ***Sovyetler Birliği***, Bashkimi Sovjetik, 3. *usht* njësi ushtarake
birlikte *ndf* bashkërisht, së bashku
bisiklet *em* biçikletë
bisküvi *em* biskotë
bit *em zool* morr
bitaraf *mb* neutral, asnjanës, që nuk mban anë
bitirmek *fl* e mbaroj, kryej (një punë)
bitiş *em* mbarim, fund
bitişik *mb* i bashkangjitur, dy gjëra që e takojnë njëri tjetrin, të afërt
bitki *em* bimë; ***bitki anatomisi***, anatomia e bimëve; ***bitki bilimi***, botanikë
bitkin *mbi* i rraskapitur, i lodhur shum, i këputur
bitkinlik *em* rraskapitje, lodhje, kapitje , dobësi, ligështi
bitkisel *mb* bimor, ***bitkisel lif***, fije bimore
bitlenmek *fl* 1. zë morra, morrohem; 2. heq morra, qërohem nga morrat
bitmek *fl* mbaroj; ***sınavlar bitti***, provimet mbaruan; ***paralar* bitti**, të hollat (parat) u mbaruan
biyografi *em* biografi, jetëshkrim
biyolog *em* biolog
biyoloji *em* biologji
biyolojik *mb* biologjik
biz 1. *perem* ne; ***bizler***, ne të gjithë; ***biz bize***, ndërmjet nesh; 2. *em* **biz**, fëndyell; ***saraç bizi*** fëndyell saraçi
bize, **bizi** *perem* ne, (neve); ***bizim***, ***bizimki***, i yni, e jona
bizzat *ndf* vetë, unë vetë; ***bizzat katılacağım***, do të marrë pjese unë vetë (personalisht unë)
blok *em* bllok (me kuptime të ndryshme):***blok evler***, grup shtëpish; ***askeri blok***, bllok ushtarak; ***mermer bloku***, bllok mermeri; ***siyasî bloklar***, blloqe politike
bloknot *em* bllok (fletore) shënimesh
blöf *em* blof, mashtrim
bluz *em* bluzë
boa *em zool* boa, një lloj gjarpri helmues
bobin *em fiz* bobinë, solenoid
bocalamak *fl* 1. (për anijen): zvarrit kundër erës; 2. dyshim, jam me dy mendje (për të bërë diçka)
bodrum *em* bodrum
bodur *mb* shkurtabiq, shkurtalaq
boğa *em zool* dem, tarak, mëzat
boğaz *em* 1. *anat* fyt, gushë, gabzherr; 2. *gjeog* grykë, ngushticë; ***İstanbul Boğazı*** Gryka e Bosforit
boğazlamak *fl* ther (kafshën ose diçka tjetër për fyti), përfyt
boğma *em* mbytje, të mbyturit

Copyrighted material

boğmak *fl* mbyt, zë frymën
boğucu *mb* i zabullueshëm, që zë frymën; ***boğucu hava*** ajër i zabullueshëm
boğuk *mb* i ngjirur (zëri)
boğuşmak *fl* përlahem, rrokem, kapem, zihem
bok *em* mut, fëlliqësirë, ndyrësirë
boklamak *fl* fëlliq, ndyej
boklu *mb* i fëlliqtë, i felliqur, i ndyrë,
bokluk *em* fëlliqësi, ndyrësi
boks *em sp* boks
boksör *em* boksier
bol *mb* i gjërë; 2. i begatshëm, i bollshëm; ***bol şanslar,*** dëshiroj fate të shumta
bolluk *em* bollëk, begati, pasuri, mirëqenie
bomba *em* bombë
bombacı *em* bombardues, ai që hedh bomba
bombalamak *em* bombardoj
bombardıman *em* bombardim
bomboş *mb* krejt i zbrazët
boncuk *em* rruazë, stringla qelqi
bono *em* çek, kambial, vërtetim (shtetëror financiar)
bonservis *em* certifikatë sjelljeje
borazan *em muz* 1. bori, trumpetë, vegël muzikore me frymë; 2. trumbetar, borizan
bor *em kim* bor
borç *em* 1. borxh, hua; ***borç almak***, marr borxh; ***borç vermek***, jap hua; ***borçlu olmak***, jam borxhli; 2. obligim
borçlanmak *fl* bëhem borxhli, marr hua
borçlu *mb* borxhli, i ngarkuar me borxh
bordo *em* ngjyrë e kuqe e mbyllyr
borsa *em* bursë, treg ku bëhen veprime financiare
boru *em* 1. gyp, qyng; 2. trumbetë
bostan *em* kopsht perimesh
bostancı *em* kopshtar
bostancılık *em* kopshtari
boş *mb* 1. i zbrazët; pa përmbajtje; i pa punë; ***boş bir hayat***, jetë pa përmbajtje; 2. i lirë (taksi, vend); ***bugün boş musun?*** sot a je i lirë? 3. jo i dobishëm, pa vlerë
boşalmak *fl* zbrazem
boşaltmak *fl* zbraz
boşanma *em* shkurorëzim, ndarje e bashkëshortëve
boşanmak *fl* shkurorëzoj
boşanmış *mb* i shkurorëzuar
boşboğaz *mb* llafazan, i gojështhurur
boşluk *em* 1. zbrazëti, zbrazëtirë, zgavër; 2. vakum
boşuna *ndf* kot, pa dobi
bot *em* lundër me motor
botanik *em* botanikë
boy *em* 1. gjatësi, naltësi; shtat¸ 2. fis, klan
boya *em* ngjyrë, bojë
boyacı *em* 1. bojaxhi, ngjyrtar; 2. pastrues këpucash
boyalı *mb* i ngjyrosur, i ngjyrshëm
boyama *em* ngjyrosje
boyamak *fl* bojatis, ngjyroj, ngjyros
boyanmak *fl* ngjyrosem
boykot *em* bojkot; ***boykot etmek,*** bojkotoj

Copyrighted material

boylu *mb* i shtatshëm; ***yüksek boylu adam***, njeri me shtat të gjatë **boynuz** *em* bri/ri; ***boynuzlu koyun***, dele me brirë
boyun *em anat* qafë, ***boyun eğmek***, nënshtrohem (dikujt), zmbrapsem, dorëzohem (dikujt)
boyuna *ndf* 1. pa ndërprerë, pa pushim; 2. gjatë gjësendi, për së gjati (gjësendi)
boyunbağı *em* kravatë
boyunca *ndf* për rreth, përqark, gjatë, pran një gjëje; ***sahil boyunca gezdik***, shetitëm për rreth bregut; ***aylar boyunca***, gjatë muajve të tëra
boyundurak *em* 1. zgjedhë; 2. *fig* robëri
boyut *em mat* 1. dimension; 2. madhësi, përmasë
boysuz *mb* i shkurtër nga shtati, shtatshkurtër
bozdurmak *fl* 1. prish (diçka); 2. prish, bëj para të imta
bozgun *em* disfatë, humbja e një lufte, çrregullim, konfuzion
bozkır *em gjeog* stepë
bozmak *fl* prish; 2. prish të holla; bëj para të imta
bozuk *mb* i prishur, i dëmtuar; ***bozuk makine***, makinë e prishur
bozukluk *em* 1. prishmëri; 2. para të imta, imtësi
bozulmak *fl* prishem; ***et bozuldu***, mishi u prish; ***motor bozuldu***, motori u prish
bozuşmak *fl* (reciprokisht) prishem (marrëdhëniet, etj.)
böbrek *em anat* veshkë
böbürlenmek *fl* lavdërohem, mburrem, krenohem
böcek *em zool* insekt; ***ip k böceği***, krimb mëndafshi
böğürtlen *em bot* fermanzë, mana ferash
bölge *em* zonë, krahinë, regjion, vis
bölgesel *mb* zonal, krahinor
bölme *em* 1. *mat* pjesëtim; 2. ndarje (e diçkaje me mur); 3. mur ndarës
bölmek *fl* 1. *mat* pjesëtoj; 2. ndaj; 2. ndaj me mur
bölük *em* 1. pjesë; 2. *usht* njësi ushtarake; 3. grup
bölüm *em* 1. pjesë; 2. *mat* herës; 3. pjesë e një lokali, e një sipërmarrjeje ose një enti
bölümleme *em* ndarje, klasifikim
bölümlemek *fl* ndaj, klasifikoj, rendit, rendis
bölünmek *fl* ndahem, përçahem (reciprokisht)
börek *em* bürek
böyle *mb* i këtillë, *ndf* kështu, kësisoj, në këtë mënyrë
böylece *ndf* 1. në këtë mënyrë; 2. (më) së mundi, sipas kësaj
böylelikle *ndf* në këtë mënyrë, në atë mënyrë
branş *em* degë (shkence a zeje), profesion
briç *em* brixh (lojë me letra)
bronşit *em med* bronhitis
broşur *em* broshurë
brüt *mb* bruto
bu *përem* ky, kjo; ***bu akşam***, në këtë mbrëmje; ***bu gece***, sonte; ***bu defa*** kësaj here; ***bu gibi***, si

Copyrighted material

ky (kjo); ***bu kadar***, kaq; ***bu nedenle***, për këtë arsye; ***buna rağmen***, megjithatë; ***bundan başka***, përveç kësaj; ***bundan böyle***, prej tash e tutje; ***bundan dolayı***, për këtë arsye, ***bunun gibi***, si ky (kjo); ***bununla birlikte***, bashkë me këtë,

bucak *em* 1. kënd, koshe; 2. buxhak, nahiye, zonë administrative në Turqi

buçuk *mb* gjysmë (nuk pëdoret më vete); ***bir buçuk***, një e gjysëm; ***saat beş buçuk***, ora është pesë e gjysëm

budak *em* 1. degë (e drurit); 2. nyje e drurit

budala *mb* i trashë nga mendja, gjysmak, pa mend, kokëtrashë, budalla; *em* budalla

budalalık *em* marrëzi, marri, budallalëk

budama *em* krasitje (degët)

budamak *fl* krasit, krasis (degët)

budist *em* budist

budizm *em* budizëm

bugün *em* sot

bugünkü *mb* i sotëm, i sotshëm, i kësaj dite

bu günlerde *ndf* në këto ditë, tash shpejt, para pak kohësh ose pas pak kohësh

buğday *em bot* grurë

buğu *em* avull, ***su buğusu***, avull uji

buğulama *em* avullim

buğulamak *fl* avulloj

buğulanmak *fl* mjegullohem (qelqi etj), mbulohem me avull

buğulu *mb* i mjegulluar, i turbulluar; ***buğulu bardak***, gotë e mjegulluar, mbuluar me avulll

buhar *em* avull, ***su buharı***, avull uji

buharlaşmak *fl* avullohem

buharlı 1. me avull; 2. që punon me fuqinë e avullit; ***buhar* kazanı**, kazan avulli

buhran *em* krizë

buhranlı *mb* kritik, ***buhranlı durum***, gjendje kritike

buji *em* kandellë; ***motor bujisi***, kandella e motorit

bu kadar *ndf* kaq

bukalemon *em zool* kameleon

buket *em* tufë lulesh, buqetë lulesh

bulandırmak *fl* turbulloj; ***suyumu bulandırıyor***, më turbullon ujin

bullanık *mb* i turbulluar; **bulanık su**, uj i turbulluar

bulanmak *fl* 1. lyhem, fëlliqem, përlyhem; ***çocuk çamura bulandı***, djali u përlue me baltë; 2. turbullohem; ***havuz suyu bulandı***, uji i bazenit u turbullua

bulantı *em* neveritje, vështirësi

bulaşıcı *mb med* ngjitës, infektiv, molepsës; ***bulaşıcı* hastalık**, sëmundje molepsëse

bulaşık *em* enë kuzhinore të pa pastruara; ***bulaşık makinesi***, makinë për larjen e enëve; ***bulaşık yıkamak***, laj enët

bulaşmak *fl* 1. lyhem, fëlliqem, përlyhem; 2. ndërhyj, përzihem (në ndonjë ndodhi ose në punët e tjetërkujt) .

Copyrighted material

bulaştırmak *fl* 1. lyej, fëlliq, ndyj; 2. *med* infektoj, moleps; 3. ndërhyj (dikë), përziej (dikë) (në punët e tjetërkujt)
buldozer *em* buldozer
Bulgar *em* bullgar; *mb* që i përket bullgarit
Bulgarca *mb* bulgarisht, gjuha bulgare
Bulgaristan *em* Bulgari
bulgu *em* zbulim, shpikje
bulgur *em* bullgur
bulmaca *em* fjalëkryq, enigma; kashe e lashë
bulma *em* gjetje, të gjeturit
bulmak *fl* gjej; zbuloj, shpik
buluş *em shiko* ***bulgu***
buluşma *em* takim, pjekje
buluşmak *fl* takohem, piqem (me dikë)
bulut *em* re/ja
bulutlu *mb* 1. vrenjtur (kohë me re); 2. *fig* i turbullt
bulutsuz *mb* (për qiellin) i çelur, që nuk ka re
bulvar em bulevard
bunak *mb* (pleqësisht): i harruar, senil; mendjedobtë, matuf; i marrë
bunaklık *em* senilitet, harrueshmëri (nga pleqësia); matufosje, marrosje
bunalım *em* krizë shpirtërore, shqetësim shpirtëror
bunalmak *fl* mbytem nga të zenët e frymës, marr frymë vështirë, mbytem
bunaltıcı *mb* i frymëzënës, i zabollueshëm, që të merr frymën
bunama *em* marrosje, senilitet
bunamak *fl* senilohem, bëhem i harrueshëm (shpirtërisht) nga pleqësia; marrosem
bunca *mb* shumë, mjaftë shumë; ***bunca zaman*** **geçti,** kaloi shumë kohë
bundan başka *ndf* veç kësaj, përveç kësaj, pos kësaj
bundan dolayı *lidh* prandaj, për këtë arsye
bunlar *përem* këta, këto
bununla birlikte *lidh* megjithatë, megjithëse, ndonëse, sado që, megjithë që
bura *em* ky vend, këtu; ***buralarda***, në këto vende; në këtë rreth, këtu afër **burada** *ndf* këtu, në këtë vend
buralı *mb* i këtushëm, i këtij vendi, i vendit, që nuk eshtë i huaj
burası *ndf* ky vend, këtu
buraya *ndf* këndej
burgu *em* turjelë
burgulamak *fl* shpoj me turjelë
burjuva *em* borgjez
burjuvazi *em* borgjezi
burkmak *fl* ndrydh, përdredh
burma *em* dredhje, përdredhje
burmak *fl* 1. dredh, përdredh, rrotulloj; 2. tredh (dashin, kalin)
burs *em* bursë
buruk *mb* 1. i dredhur, i përdredhur; 2. i tredhur (dashi, kali etj); 3. *fig* i fyer, i ofenduar
burun *em anat* 1. hundë; ***burun kanaması***, gjakim i hundës; **burnunu silmek**, e fshij hundën; 2. *gjeog* kep; ***Ümit Burnu*** Kepi i shpresë së mirë

Copyrighted material

buruşturmak *fl* rrudh, ndrydh; ***anlını buruşturur***, e rrudh ballin; ***kitabı buruşturur***, e drydh librin
buruşuk *mb* i rrudhur, i ndrydhur
but *em anat* kofshë; ***but kemiği***, ashti i kofshës
butik *em* butikë
buyruk *em* urdhër, komandë
buyurmak *fl* urdhëroj, komandoj; ***içeri buyurun***! urdhëroni mbrenda! ***buyurun***! urdhëroni!
buyuru *em* 1. urdhër; 2. porosi
buz *em* akull; ***buz gibi***, ftohtë si akulli
buzağı *em zool* viç
buzdağı *em* akullnajë
buzdolabı *em* frigorifer
buzkıran *em* akullthyes
buzlama *em* akullim
buzlanmak *fl* akullohem, bëhem akull, zë akull
buzlu *mb* 1. i ngrirë, i akullt; 2. i përzier me akull; 3. i turbullt; ***buzlu cam***, xham i turbullt
buzul *em* akullnajë
bücür *mb* i imët, i shkurtër, shkurtabiq, shkurtëllaq, i shkurtër dhe i trashë nga shtati
büfe *em* bufe
bühtan *em* shpifje
büklüm *em* 1. lak, kthesë, bërryl (rruge, lumi etj); 2. rrudhë
bükmek *fl* lakoj, përkul, dredh
bükülmek *fl* shtrembërohem, lakohem, përkulem
bülbül *em zool* bilbil
bülten *em* buletin
bünye *em* shtat/i
büro *em* 1. byro, zyrë ***danışma bürosu***, byro për informacione; 2. masë, tryezë (për shkrim)
bürokrasi *em* burokraci
bürokrat *em* burokrat
bürokratik *mb* burokratik, që i përket byrokracisë
bürümek *fl* 1. mbështjell, mbuloj; 2. ndikoj shumë
büsbütün *ndf* krejt, gjithë, tërë, kryesisht
büst *em* bust
bütçe *em* buxhet
bütün *mb* i gjithë, i tërë;
bütünlemek *fl* 1. plotësoj, kompletoj; ***bütünleme sınavı***, riprovim
bütünlük *em* tërësi, integritet, pandashmëri; ***toprak bütünlüğü***, pandashmëria tokësore
büyü *em* magji; ***büyü yamak***, bëj magji
büyücü *em* magjibërës, magjistar
büyücülük *em* magjepsje, magjistari
büyük *mb* i madh; ***büyük harf***, shkronja e madhe
büyük anne *em* gjyshe
büyük baba *em* gjysh
büyük elçi *em* ambasador
büyük elçilik *em* ambasadë
büyüklük *em* 1. madhësi; 2. zemërgjerësi, zemërmadhësi, shpirtgjerësi, fisnikëri; 2. mendjemadhësi, arrogancë
büyüleme *em* magjepsi
büyülemek *fl* 1. magjepsoj, marrë mendjen (dikujt); 2. entuziazmoj, tërheq shumë

Copyrighted material

büyüleyici *mb* tërheqës/e, simpatik, sharmant, i këndshëm, joshës, ndikues
büyülü *mb* i magjepsuar
büyültmek *fl* zmadhoj; *fig* teproj (në diçka); zmadhoj për së tepërmi
büyüme *em* zmadhim, rritje
büyümek *fl* 1. rritem; 2. plakem; 3. forcohem; 4. zmadhohem (në numër); 5. zgjerohem
büyüteç *em fiz* gastare zmadhuese, thjerrëz
büyütmek *fl* 1. rrit (rris), zmadhoj; 2. zgjeroj; 2. teproj (në diçka); 4. kujdesem, ushqej, rris (djalin)
büyütülmüş *mb* i zmadhuar, i rritur
buzgu *em* rrudhë
büzmek *fl* rrudh, tkurr
büzük *mb* i rrudhur, i tkurrur
büzülmek *fl* rrudhem, tkurrem

Copyrighted material

C

caba *ndf* falas, falë, gratis, badihava
cacık *em* sallatë e përzier me kos, krastaveca e hudhra
cadaloz *em* shtrigë, grua zemërkeq
cadalozluk *em* shtrigësi
cadde *em* rrugë e gjerë
cadı *em* 1. shtrigë; 2. grua e keqe dhe e shëmtuar; 3. vampir, lugat
cahil *mb* i paditur, i padijshëm, jo i shkolluar, injorant
cahillik *em* padituri, padije, injorancë
caiz *mb* (nga pikëpamje fetare) i pranueshëm, i lejueshëm, i lejuar
caka *em* mburrje, krenari, lëvdatë; ***caka etmek,*** lëvdohem
cam *em* qelq, xham
cambaz *em* 1. akrobat; 2. tregtar kuajsh; 3. *fig* njeri dinak, dhelpërak
cambazhane *em* vend ku bëhen akrobata, cirk
cambazlık *em* akrobaci
camekân *em* vitrinë me xhama
camgöz *em* 1. sy artificial; 2. njeri me sy artificial; 3. *mb* i lakmueshëm, i pangopur
cami *em* xhami, faltore e myslimanëve
camlamak *fl* vë xhama (dritareve etj)
camlı *mb* i qelqtë, i pajisur me xhama
can *em* 1. shpirt; 2. jetesë; 3. shëndetësi; 4. person, njeri; 5. forcë
canan *em* dashnore; e dashura
canavar *em* përbindësh, egërsirë, njeri mizor
canavarlık *em* përbindëshi, egërsi, mizori
canciğer *mb* shumë i afërt, intim (mik)
candan *mb* nga zemra, i përzemërt, i sinqertë; *ndf* sinqerisht, me kënaqësi
cani *em* delikuent, shkelës ligji, vrasës, gjakësor, kriminal
canilik *em* vrasje, gjakderdhje, kriminalitet
cankurtaran *em* 1. mjet për të shpëtuar dikë, mjet për ndihmë urgjente; 2. shpëtimtar, shpëtues
canlandırma *em* gjallërim
canlandırmak *fl* 1. gjallëroj, frymëzoj; 2. freskoj
canlanma *em* gjallëri
canlanmak *fl* gjallërohem
canlı *mb* i gjallë, jeton, që rron; 2. aktiv, energjik; 3. gëzueshëm, gazmor
canlılık *em* gjallëri
cansız *mb* 1. i pashpirt, i vdekur; 2. i dobët, i pafuqishëm, i plogtë

Copyrighted material

cansızlık *em* 1. pashpirtëri, pagjallëri; 2. plogështi
cari *mb* i rrjedhshëm; ***cari hesap***, llogari e rrjedhëse
casus *em* spiun
casuslamak *fl* spiunoj
casusluk *sm* spiunazhë; ***casusluk etmek***, spiunoj
caydırmak *fl* e shmang (dikë nga drejtimi)
caymak *fl* mohoj, shmangem, zbrapsem
caz *em muz* xhaz; ***caz orkestre***, xhaz orkestër
cazibe *em* joshje, tërheqje, ngashënjim
cazibeli *mb* joshë, tërheqës, magjik; ***cazibeli kız***, vajzë tërheqëse
cazip *mb* i ngashëruar, tërheqës, atraktiv
cebir *em mat* algjebër
cebirci *em* algjebrist
cebirsel *mb* algjebrik
cebren *ndf* me forcë, me zor, me detyrim
cebretmek *fl* detyroj
cebrî *mb* i detyrueshëm
cefa *em* vuajtje
cefakâr *mb* i vuajtur
cehalet *em* padituri, padije, mungesë arsimimi, injorancë
cehennem *em* ferr, skëterrë, xhehenem
ceket *em* setër, xhaketë
celâl *em* madhëri, madhështi
cellat *em* xhelat, ekzekutor i dënimit me vdekje; 2. mizor, gjakatar
celse *em* sesion; seancë
cemaat *em* 1. bashkësi (grup njerëzish); 2. bashkësi fetare, bashkësi etnike; ***islam cemaatı***, bashkësia islame
cemiyet *em* shoqëri, bashkësi, lidhje, shoqatë, organizatë; ***yazarlar cemiyeti***, shoqata e shkrimtarëve
cenaze *em* njeri i vdekur, kufoma e njeriut të vdekur, kufomë
cendere *em* shtypës, vegël shtypëse
cennet *em* parajsë, xhenet
cenk *em* luftë
cenkleşmek *fl* luftoj
centilmen *em* xhentëlmen
cep *em* xhep; ***cep harcı***, para xhepi; ***cep sözlüğü***, fjalor xhepi; ***cep telefonu***, telefon mobil
cephane *em usht* municion
cephanelik *em usht* depo e madhe armësh
cephe *em* 1. front; 2. fasadë
cerahat *em* qelb (i plagës)
cereyan *em* 1. rrym, korrent; ***hava cereyanı***, rrym ajri; 2. elektrik; ***elektrik cereyanı***, rryma elektrike
cerrah *em med* kirurg, operator
cerrahî *mb med* kirurgjik
cerahlık *em med* kirurgji, degë e mjekësisë
cesaret *em* guxim, trimëri; ***cesaret etmek***, trimëroj dikë, bëj të jetë guzimtar
cesaretlenmek *fl* marr guxim të bëj diçka, trimërohem
cesaretli *mb* i guximshëm
cesaretsiz *mb* i paguximshëm, jo i vendosur, frikacak
cesaretsizlik *em* paguximshmëri, ndruajte

Copyrighted material

ceset *em* kufomë
cesur *mb* guximtar
cesurca *ndf* trimërisht, guximtarisht
cesurluk *em* guxim, trimëri, pafrikshmëri
cetvel *em* 1. vizore; 2. listë
cevap *em* përgjegje; ***cevap vermek***, përgjigjem
ceviz *em bot* arrë
ceylan *em zool* antilopë
ceza *em* dënim, ndëshkim, sankcion
ceza evi *em* burg
cezalandırmak *fl* dënoj, ndëshkoj
cezalanmak *fl* dënohem, ndëshkohem
cezalı *mb* i dënuar, i ndëshkuar
cezasız *mb* pa dënim, pa ndëshkim
Cezayir *em gjeog* Algjeri
Cezayirli *em* Algjerian
cezbetme *em* tërheqje
cezbetmek *fl* tërheq
cezir *em geog* zbaticë
cezve *em* xhezve
cılız *mb* i dobët, i pafuqishëm, i hollë
cılızlaşmak *fl* dobësohem
cılızlık *em* dobësi, dobëti
cımbız *em* pincë, xhimbidhë
cıva *em kim* xhivë, engjërdhi, merkur
cıvata *em* vidhë
cıvık *mb* i lagur, i ujshëm, i butë (brum, baltë etj); ***cıvık hamur***, brum i ujshëm, i butë
cıvıldamak *fl* cicëroj
cızırdamak *fl* kërcit, kërcas, gërthit
cici *mb* i bukur, i mirë, i dashur, i hijshëm
cidar *em* mur
cidden *ndf* seriozisht, me gjithë mend
ciddi *em mb* serioz
ciddileşmek *fl* bëhem serioz
ciddilik *em* seriozitet
ciddiyet *em* seriozitet
ciddiyetle *ndf* seriozisht, pa shaka
ciğer *em anat* mëlçi; ***ak ciğer***, mëlçi e bardhë, mushkëri
cihan *em* 1. botë; 2. gjithësi, rruzulli
cihaz *em* aparat
cilâ *em* llak, lustër, shkëlqim
cilâlama *em* lustrim
cilâlamak *fl* lustroj, bëj që të shkëlqen
cilâlanmak *fl* lustrohem
cilalı *mb* i lustruar
cildiye *em med* dermatologji
cilt *em* 1. lëkurë (njeriu); 2. lidhje librash; 3. vëllim libri; ***ikinci cilt***, vëllim i dytë
ciltçi *em* libralidhës
ciltlemek *fl* lidh (librin) me kapakë; bëj (librin) me kapakë
ciltli *mb* 1. I lidhur (libri) me kapakë
cilve *em* naze
cilveli *mb* nazeqar, që është plot me naze
cimnastk *em* gjimnastikë
cimri *mb* koprrac, dorështrënguar, dorërrudhur
cimrilik *em* kopraci, ves i kopracit
cin *em* xhind, demon

Copyrighted material

cinayet *em* krim, vrasje (e njeriut); ***cinayet işlemek,*** vras (njeriun)
cingöz *mb* dinak, dhelparak
cinnet *em* marrëzi, budallallëk, çmendësi
cins *em* 1. loj, farë; soj; 2. gjini; ***erkek cinsi,*** gjini mashkulli
cinsel *mb* që i përket gjinisë, seksual; ***cinsel eğitim,*** edukatë seksuale
cinsellik *em* gjini, seksualitet
cinsî *mb* seksual, i gjinisë
cinsiyet *em* gjini, seksualitet; ***cinsiyet hastalığı,*** sëmundje venerike
cip *em* xhip (mjet transporti)
cirit *em* shtizë, heshtë, ushtë
cisim *em fiz kim* trup, materie
cisimcik *em* trupi shumë i vogël
civar *em* 1. rethinë, vendi i afërm, fqinjësi, paralagje (e një qyteti)
civciv *em* zog (i pulës), zogëz
coğrafi *mb* gjeografik
coğrafya *em* gjeografi
coğrafyacı *em* gjeograf
cokey *em* xhokej
cop *em* çomagë polisi
coşku *en* entuziazëm
coşkunlu *mb* i entuziazmuar
coşkun *mb* i shqetësuar, i tronditur
coşkunluk *em* entuziazmim; shqetësim, tronditje
coşmak *fl* entuziazmohem, shqetësohem, tronditem
cömert *mb* 1. bujar; dorëdhënës, dorë lirë; 2. i frytshëm, pjellor; ***cömert toprak,*** tokë pjellorë
cömertçe *ndf* bujarisht, me bujari
cömertlik *em* 1. bujari, dorëdhënësi; 2. frytshmëri, pjellshmëri
cuma *em* e premte
cumartesi *em* e shtunë
cumhur *em* 1. popull; 2. shoqëri
cumhurbaşkanı *em* kryetar i republikës, president
cumhuriyet *em* republikë
cumhuriyetçi *em* republikan
cüce *em* xhuxh, xhuxh mor-xhuxh, shkurtabiq
cücelik *em* shkurtabiqësi
cümbüş *em* 1. xhunbush, argëtim, dëfrim, gëzim; 2. *muz* instrument me tela me trup metali
cümle *em mb* 1. *garm* fjali; 2. të gjithë, të tërë; 3. sistem
cümleten *ndf* plotësisht, krejt fare
cüppe *em* xhybe
cüruf *em* zgjurë
cürüm *em* delikt, krim
cüse *em* trup njeriu
cüseli *mb* shumë i madh, i trashë, trashaman, trup madh (njeri)
cüzdan *em* 1. portofol, kuletë; 2. librezë; ***banka cüzdanı,*** librez kursimi (banke); ***evlenme cüzdanı,*** dokument (çertifikatë, librezë) kurorizimi; ***nüfus (hüviyet*** ose ***kimlik) cüzdanı,*** letërnjoftimi

Copyrighted material

Ç

çaba *em* përpjekje, orvatje, mundim
çabalamak *fl* përpiqem, mundohem
çabalanmak *fl* përpiqem, mundohem
çabucak *ndf* shpejt, me të shpejt
çabuk *mb* i shpejt; ***çabuk ol!*** shpejto!
çabukça *ndf* me shpejtësi
çabuk çabuk *ndf* shpejt e shpejt
çabuklaşmak *fl* shpejtohem, ngutem
çabuklaştırmak *fl* shpejtoj (dikë ose diçka)
çabukluk *em* shpejtësi
çadër *em* tendë, shatorë; ***çadır kurmak***, ngre një tendë
çağ *em* 1. kohë, periudhë; ***çocukluk çağı***, periudha e fëmijërisë; 2. shekull, epokë, erë
çağcıl *mb* bashkëkohor, modern
çağcılık *em* modernizëm
çağcılaşmak *fl* modernizohem
çağdaş *mb* bashkëkohor, i kohës moderne
çağdışı *mb* i jashtkohshëm, që nuk eshtë i kohës; fig i prapambetur
çağırdamak *fl* gurgulloj
çağırmak *fl* 1. thërras, bërtas; 2. ftoj
çağlamak *fl* gurgulloj
çağlanmak *fl* gurgullohem
çağlayan *em geog* uyvarë, katarakt
çağrı *em* thirrje, apel; ftesë
çağrıcı *em* thirrës, ai që thërret
çakal *em zool* çakal; fig spiun
çakı *em* çaki, brisk (xhepi)
çakıl *em* zhavorr, gur i thyer, gur i imtësuar
çakışmak *fl* 1. përputhem (në kohe etj); 2. *mat* përputhem (në madhësi); 3. përshtat
çakma *em* ngulim, ngulje, mbërthim, mbërthyerje
çakmak *fl* 1. mbërthej, ngul (gozhdën); 2. trokas; 3. *em* çakmak (për ndezjen e cigares)
çalar saat *em* orë me zile
çalgı *em* 1. instrument muzikor; 2. shoqëri muzikor
çalgıcı *em* muzicient
çalgılı *mb* muzikal, muzikor
çalı *em* kaçubë, shkurre
çalılık *em* pyll kaçubash, shkurre
çalım em kryenaltësi, madhështi, mendjemadhësi
çalımlı *mb* kryelartë, krenar, madhështor
çalıntı *mb* i vjedhur, diçka e vjedhur
çalışkan *mb* i vyeshëm, i zellshëm, punëtor

Copyrighted material

çalışkanlık *em* veprimtari, zellshmëri
çalışma *em* punë, punim, mund; veprim; ***çalışma bakanlığı*** ministria a punës; 2. *sp* ushtrim
çalışmak *fl* punoj, mundohem, përpiqem, veproj, orvatem
çalıştırıcı *em* punëdhënës, ai që jep punë
çalıştırmak *fl* 1. përpunoj (një mekanizëm) për të punuar mirë; 2. e vë në veprim (motorin); 3. punësoj (e fus dikë në punë), jap punë (dikujt)
çalkalama *em* 1. shpërlarje; 2. tundje, të tundurit
çalkalamak *fl* 1. shpërlaj; 2. tund, përziej, trazoj
çalma *em* vjedhje, të vjedhurit
çalmak *fl* 1. vjedh; 2. trokit, trokas, bie; ***kapıyı çalmak,*** e trokas derën; 3. *muz* bie; ***o kemane çalıyor,*** ai i bie violinës
çam *em bot* pishë
çamaşır *em* rroba të brendshme, ndërresa: këmishë, brek etj; ***çamaşır makinesi,*** rrobalarës; ***çamaşır yıkamak,*** laj rroba
çamaşırcı *em* ndërresalarës, teshalarës
çamaşırhane *em* vend ku lahen teshat, ndërresat
çam fıstığı *em* frytë pishe
çamlık *em* pishnajë, pyll pishe
çamur *em* baltë; *fig.* ***çamur atmak***, shpif
çamurlamak *fl* baltos, bëj me baltë
çamurlanmak *fl* baltosem, ndyem me baltë
çamurlu *mb* me baltë, i baltosur; ***çamurlu sokak,*** rrugë me baltë
çamurluk *em* 1. parafangë, baltëmbrojtës (i automobilit); 2. vend me baltë, baltinë, balttishtë; 3. pastrues këpucësh që vihet para derës
çan *em* kambanë, kambana e kishës
çanak *em* çanak (enë prej argjili)
çanakçı *em* poçar
çanlık *em* kambanorë (e kishës)
çanıltı *em* zëri i kambanës
çanta *em* çantë
çantacı *em* çantapunues ose çantashitës
çap *em* 1. *mat* diametër; 2. madhësi, dimension; 3. *usht* kalibër, ***küçük çap,*** kalibër i vogël; 4. vlerë; ***cevahir çapında bir eser,*** vepër me vlerë diamanti
çapa *em* 1. shat; 2. *det* hekur anije, spirance
çapacı *em* shatëtar
çapalama *em* gërmim me shatë, mihje, prashitje
çapalamak *fl* gërmoj me shat, rrëmoj, mih (me shat), punoj me shat
çapkın *mb* 1. çapkën, i dhënë pas grash; 2. i paurtë, i mbrapshtë
çapkınlık *em* çapkënllëk, sjellje çapkëni; mbrapshti, dhënie pas grash, epshore
çapraşık *mb* i ngatërruar, i ndërlikuar, i gërshetuar, i paqartë, i pakuptueshëm
çapraz *mb* i tërthortë, i kryqëzuar, i diagonaltë

Copyrighted material

çapul *em* plaçkitje, grabitje, rrëmbim
çapulcu *em* plaçkitës, grabitës, rrëmbyes, bandit
çapullamak *fl* plaçkit, grabis, rrëmbej
çarçabuk *ndf* shumë shpejt, shpejt e shpejt, vrik e vrik
çarçur *em* shpenzim pa nevojë dhe i tepruar, plëngprishje
çare *em* çare, mundësi, rrugë, mënyrë për daljen nga një pozicion
çaresiz *mb* i pamundshëm, i padalshëm, i pakapërcyeshëm; ***çaresiz durum*** gjendje e pakapërcyeshme
çaresizlik *em* pamundësi, mungesë mundësie, pa rrugëdalie
çarık *em* opingë
çarıkçı *em* opingëpunues, opingëshitës
çark *em* 1. rrot (e ndonjë makine); ***dişli çark***, rrotë me dhëmba; 2. ***çark etmek*** shmang (nga rruga; dajthtas, majtas, prapa), devijoj; 3. mprehëse (mjet a vegël që përdoret për të mprehur diçka)
çarpan *em mat* shumëzues
çarpı *em mat* shenjë shumëzimi (x), herës; 2. malter i vrazhdë
çarpım *em mat* shumzim; prodhim; ***çarpım tablosu***, tabellë shumëzimi
çarpıntı *em* dridhje (për të rahurit e zemrës fortë dhe shpesh)
çarpışma *em* 1. përplasje, ndeshje; 2. *usht* ndeshje, (luftë) midis dy forcave armike; ***hava çarpışması***, ndeshje ajrore
çarpışmak *fl* përplasem; ndeshem, luftoj
çarpıtmak *fl* 1. shtrembëroj; 2. *fig* shtremboj, përmbys (të vërtetën)
çarpma *em* 1. përplasje; 2. goditje, rrahje; 3. *mat* shumëzim
çarpmak *fl* 1. godit, përplas; 2. *mat* shumëzoj
çarşaf *em* çarshaf, mbulesë; ***karyola çarşafı***, mbulesë krevati
çarşamba *em* e mërkurë (ditë)
çarşı *em* rejon tregu, çarshi
çatal *em* 1. pirun; 2. tërfurk; 3. *mb* çatall, i ndarë dysh, që ka trajtën e tërfurkut
çatalağız *em gjeog* deltë (lumi)
çatı *em* pullaz, çati, ***çatı katı***, banesë ndër pullaz
çatırdamak *fl* kërcit, kërcas
çatırtı *em* kërcitje, krisje
çatışma *em* 1. ndeshje, luftë, konflikt; 2. kontradiktë, kundërthënie; 3. grindje, zënie; 4. përputhje
çatışmak *fl* 1. ndeshem, luftoj; 2. jam në kontradiktë, kundërshtoj, nuk pajtohem; 3. zihem, grindem; 4. përputhem
çatlak *mb* i plasur, i pëlcitur, i krisur; ***çatlak eller***, duar të plasura; ***çatlak cam***, xham i plasur; 2. *em* çarë
çatlama *em* plasje, të plasurit, kërcitje
çatlamak *fl* plas, pëlcas; çaj
çatlamış *mb* i plasur, i çarë
çavdar *em bot* thekër; ***çavdar ekmeği***, bukë thekre
çavuş *em usht* kapter

Copyrighted material

çay *em gjeog* 1. lumë; 2. çaj; ***çay bardağı***, gotë çaji; ***çay kaşığı***, lugë çaji
çaycı *em* çajshitës; çajtore
çaydanlık *em* çajnik, ibrik çaji
çayır *em* livadh, luadh
çehre *em* 1. fytyrë; 2. pamje, dukje; ***köyün çehresi değişti***, u ndërrua pamja e fshatit
çek *em* çek; ***çek karnesi***, librezë çeku
çekap *em med* pesmejkër
çekecek *em* lugë për këpuca
çekememek *fl* 1. lakmoj, kam zili, jam xheloz për. . . ; 2. *fig* nuk mund të duroj, nuk mund përmbaj (kritikën etj)
çekicilik *em* magjepsi, tërheqësi, joshje
çekiç *em* çekan, çekiç
çekidüzen *em* rregull, rregullim
çekilir *mb* i durueshëm, që mund të durohet (gjendje etj)
çekiliş *em* 1. heqje; 2. heqja e llotarisë; 3. *usht* tërheqje, prapavajtje
çekilme *em* tërheqje, prapavajtje
çekilmek *fl* 1. hiqem, tërhiqem; 2. jap dorëheqje (nga detyra)
çekilmez *mb* i pa durueshëm, që nuk mund të durohet
çekim *eç* heqje, tërheqje; 2. *fiz* gravitacion (i tokës); 3. inçizim (film, zë); 4. *gram* lakim (në rasa, në veta)
çekimser *mb* i abstenuar, i përmbajtur; ***çekimser oy vermek***, abstenoj nga votimi
çekingen *mb* i turpshëm, i ndrojtur, i kujdesshëm, i rezervuar, i mbyllur në vetvete
çekingenlik *em* ndruajtësi, tutje, frikësim, turpshmëri
çekinmek *fl* largohem, refuzoj, ruhem, përmbaj vetën; ***benden mi çekiniyorsun?*** vall, prej meje largohesh? ***alkolden çekiniyorum***, e përmbaj vetën (largohem) nga alkoholi
çekirdek *em* bërthamë, thelb; farë; ***kabak çekirdeği***, bërthamë kungulli; ***atom çekirdeği***, bërthamë e atomit
çekirge *em zool* karkalec
çekişme *em* 1. heqje, tërheqje (reciprokisht); 2. grindje, zënie
çekişmek *fl* 1. hiqem, tërhiqem (reciprokisht); 2. grindem, zihem
çekişmeli *mb* i kontestueshëm, i diskutueshëm, i polemizueshëm, i konfliktueshëm, i grindshëm; 2. i ashpër, i rreptë, **çekişmeli maç**, ndeshje (sportive) e ashpër
çekiştirmek *fl* 1. heq (në an të kundërta); 2. *fig* shpif, marrë nëpër gojë
çekme *em* heqje
çekmece *em* 1. sirtar, syzë; 2. kuti e vogël për stoli; 3. gji i vogël deti
çekmek *fl* heq; ***arabayı çekmek***, e heq qerren; 2. zgjas (duke tërheq); 3. thith; 4. tërheq; ***devlet paralari piyasadan çekti***, shteti i torhoqi parat nga qarkullimi
çelenk *em* kurorë (lulesh)
çelik *em* çelik; *mb* i çeliktë, prej çeliku

Copyrighted material

çelişki *em* kundërshti, kundërthënie
çelişmek *fl* kundërshtoj, nuk pajtohem (me dikë)
çelme *em* nënkëmbëz, stërkëmbës
çelmek fl nënkëmbëzoj, stërkëmbëzoj
çember *em* 1. rreth; 2. *gjeom* rreth
çemberleme *em* rrethim
çemberlemek *fl* rrethoj
çene *em anat* nofull; ***çene çalmak*** bëlbëzoj
çengel *em* çengel, gremç, kanxhë
çengellemek *fl* vë gremçin
çengelli iğne *em* gjilpërë me gremç
çengi *em* valltarë
çentik *em* prerje, çarje, thellësirë (e cekët)
çerçeve *em* kornizë, parvaz, suazë
çerçeveleme *em* kornizim
çerçevelemek *fl* kornizoj, vë në korniz, rrethoj me kornizë
çerçeveli *mb* i kornizuar, i vërë në kornizë
çerez *em* antipastë (ngrënie e lehtë e përbërë nga arra, lajthia, kikirikë, rrush i thatë, leblebira etj)
çeri *em* ushtar
çeşit *em* 1. lloj, farë, soj; 2. larmi; 2. asortiment
çeşitli *mb* i llojshëm, i llojllojshëm, i shumëllojshëm
çeşitlilik *em* llojshmëri
çeşme *em* çezmë, krua
çete *em* bandë, grup banditësh, grumbull njerzish të armatosur; çetë
çeteci *em* pjesëtar bande
çetin *mb* i vështirë, i zorshëm, i rëndë, i ashpër; **çetin savaş,** luftë e ashpër
çevik *mb* i shpejtë, i shkathët; ***çevik kuvvetler*** *usht* njësi të shpejta
çeviklik *em* shkathtësi, aftësi
çeviri *em* 1. përkthim, të përkthyerit; 2. vepër e përkthyer
çevirici *em* përkthyes, ai që përkthen
çevirme *em* përkthim, të përkthyerit
çevirmek *fl* 1. përkthej; 2. kthej, rrotulloj (në anën tjetër); 3. kthej prapa, 4. incizoj (film); 5. rrethoj (diçka); 6. udhëheq (punën)
çevirmen *em* përkthyes
çevre em 1. rrethinë, periferi; 2. ambient, mjedis; 3. rreth; **siyasi çevreler**, rrethe politike; 4 *gjeom* rreth; 5. shami e qëndisur me sërma
çevrebilim *em* ekologji
çevrebilmci *em* ekolog
çevrelemek *fl* 1. rrethoj (diçka); 2. bëj një shëtitje rreth diçkaje
çevresel *mb* periferik
çeyiz *em* prikë
çeyrek *em* çerek, një e katërta (e diçkaje)
çıban *em* çiban, lungë, i thatë
çığ *em* ortek
çığır *em* 1. rrugë e hapur nëpër borë; 2. gjurmë (e bashkudhëtarit), rrugicë, shteg; 3. *fig* sistem, metodë
çığlık *em* britmë, piskamë

Copyrighted material

çıkagelmek *fl* vij papritmas, paraqitem befas
çıkar *em* dobi, interes
çıkarcı *em* lakmues. ai që shef vetëm interesin e vet, egoist
çıkarcılık *em* interes personal, egoizëm
çıkarma *em* 1. nxjerje; ***kuyudan su çıkarmak,*** nxjerje uji nga pusi; ***para çıkarmak*** të fituarit para; 2. *usht* zbarkim; ***asker çıkarma,*** zbarkim ushtrije; 3. *mat* zbritje
çıkarmak *fl* nxjerr; ***bir diş çıkardı,*** nxori një dhëmb; 2. zhvesh; ***gömleği çıkardı,*** e zhveshi këmishën; 3. *usht* zbarkoj; 4. *mat* zbres, bëj operacionin e zbritjes; 5. përjashtoj; **okuldan çıkardılar,** e përjashtuan nga shkolla
çıkartma *em usht* zbarkim
çıkartmak *fl usht* zbarkoj
çıkış *em* 1. dalje; 2. *fig* qortim
çıkmak *fl* 1. dal; 2. hip; ***beşinci kata çıktı,*** hipi në katin e pestë; **dağın tepesine çıktı,** hipi (doli) na majë të malit; 3. shkoj (nisem) në një udhëtim; ***yurt dışına çıkmak,*** shkoj jashtë shtetit
çıkmaz *em* 1. rrugë pa dalje, qorsokak; 2. *fig* gjendje e pazgjidhshme
çıkrık *em* çikrik, çekërk
çıldırmak *fl* 1. çmend (dikë); bëj që dikush të çmendet; 2. çmendem, humb arsyen, marrosem
çılgın *mb* i marrë, i çmendur, i paarsyeshëm
çılgınca *ndf* marrëzisht, marrisht
çılgınlık *em* marri, marrëzi, çmenduri, mungesë arsyeje, budallallëk
çınar *em bot* çinar, rrap
çıngırak *em* zile
çıngırdamak *fl* kumboj, tingëlloj
çınlamak *fl* 1. ushtoj, kumboj, tingëlloj
çıplak *mb* 1. lakuriq, i zhveshur; ***çıplak dağlar,*** male të zhveshura; 2. tullac, i paflok; 3. jo i pajisur me orendi; **çıplak oda,** dhomë pa orendi
çıplaklaşmak *fl* zhvishem, bëhem lakuriq
çıplaklık *em* lakuriqësi
çıplatmak *fl* zhvesh (dikë), bëj lakuriq (dikë)
çıra *em* pishë
çırak *em* çirak, shegert
çırılçıplak *mb* plotësisht lakuriq
çırpınma *em* tundje, dridhje (nga dhimbja)
çırpınmak *fl* tundem, dridhem (nga dhimbja); 2. (për muskul) dridhet vetvetiu; 3. (për detin) valëzohet lehtë; 4. *fig* (në gjendje të rënda) panikohem, shqetësohem, tronditem, brengosem
çıta *em* shufër, thupër
çıtırdamak *fl* kërcas, plas, përplas
çıtırtı *em* krisje, kërcitje, të kërciturit
çiçek *em bot* 1. lule; 2. *med* variola, lijë
çiçekçi em 1. kopshtar lulesh; 2. dyqan lulesh; 3. luleshitës (person)
çiçekçilik *em* kulturë lulesh
çiçeklenmek *fl* lulëzohem

Copyrighted material

çift *mb* 1. çift, dysh, palë; ***bir çift ayakkabı,*** një palë këpuca; 2. pendë; ***bir çift öküz*** një pendë qe; 3. bashkëshortet (burr e grua)
çiftçi *em* bujk
çiftçilik *em* bujqësi
çifte *mb* 1. i dyfishtë; 2. embarkë me dy lopata; 3. shkelm (i kalit, i gomarit); 2. çifte, pushkë gjahu me dy gypa
çiftelemek *fl* shkelmoj
çiftlemek *fl* dyfishoj, çiftëzoj
çiftleşme *em* dyfishim, çiftosje
çiftleşmek *fl* 1. dyfishohem, bëhem çift, bëhem palë; 2. çiftosem, martohem
çiftleştirmek *fl* 1. e çiftos, e dyfishoj; 2. parëzoj, çiftoj (kafshët me qëllim që të shtohen); 3. martoj (dikë)
çiftlik *em* çiflik
çiğ *mb* i pazier, i papjekur (për ushqime); ***çiğ et,*** mish i papjekur; ***çiğ elma***, mollë e papjekur; 2. i pabërë, i paarritë (për pemë, perime); 3. *fig* i vrazhdë, i pagdhendur, brutal (për sjellje); i papërvojë, i pastërvitur
çiğdem *em bot* lule pranvere
çiğlik *em* papjekuri
çiğneme *em* përtypje
çiğnemek *fl* 1. përtyp (me gojë); 2. shkel (me këmbë); **yasayı çiğniyor**, e shkel (dhunon, përdhunon) ligjin
çiklet *em* gomë për përtypje (me gojë)
çikolata *em* çokollatë
çil *em* 1. *zool* pulëdushke; 2. njollë, damkë (përgjithësisht në fytyrë)
çile *em* 1. vuajtje vullnetare 40 ditëshe të dervishëve; 2. vuajtje, mundim, ngashërim, dhembje; ***çile çekmek,*** vuaj; 3. lëmsh (mëndafshi etj); 4. lak, harkut
çileli *mb* vuajtës, ai që vuan, heqës
çilek *em bot* dredhëz, luleshtrydhë
çilingir *em* brava ndreqës, farkëtar, mekanik
çim *em bot* bar, mbulesë e gjelbër e tokës
çimdik *em* pickim
çimdiklemek *fl* pickoj
çimdiklenmek *fl* pickohem
çimen *em bot* bar, gjelbërim
çimenlik *em* vend me bar, ledinë, barishte
çimento *em* çimento; ***çimento fabrikası***, fabrikë e çimentos
çimentolu *mb* i çimentuar
Çin em *gjeog* Kina
çingene *em* jevg, cigan
çini *em* fayans, pllaka qeramike
çinicilik *em* tërësia e prodhimeve te qeramikës
çinko *em kim* zink; *mb* që është prej zinku; ***çinko levha***, pllakë zinku
Çinli *em* Kinezë
çirkin *mb* i shëmtuar, jo i hijshëm
çirkinleşmek *fl* shëmtohem
çirkinleştirmek *fl* shëmtoj (dikë)
çirkinlik *em* shëmti
çise *em* shi i hollë, shi i imët
çiselemek *fl* bie shi i hollë
çiş *em* shurrë, urinë
çit *em* gardh

Copyrighted material

çivi *em* 1. gozhdë; 2. *fig* ***çivi gibi***, njeri i fort dhe i shkathët
çivileme *em* gozhdim, mbërthim me gozhdë
çivilemek *fl* gozhdoj, mbërthej me gozhdë
çivilenmek *fl* gozhdohem
çivili *mb* i gozhduar
çiy *em* vesë, shi i hollë
çiyli *mb* me vësë, i njomë
çizelge *em* listë, tabellë, grafikon, formular
çizgi *em* vijë
çizgili *mb* me vija, që është vija-vija
çizgilik *em* vizore
çizikli *mb* i gërvishtur
çizinti *em* gërvishtje e vogël
çizim *em* vizatim
çizme *em* 1. çizme; 2. të vizatuarit; 3. të hequrit vija
çizmek *fl* 1. vizatoj, 2. heq vija; 3. shkaravis, fshij (me vija), shlyj
çoban *em* bari, çoban
çocuk *em* fëmijë, kalama; ***yeni doğan çocuk***, fëmijë i posalindur; ***çocuk bahçesi***, kopsht fëmijësh; ***çocuk doktoru*** pediatër
çocuk bilimi *em* pedagogji
çocukluk *em* fëmijëri; sjellje fëmijësh
çoğalma *em* shumim, shtim
çoğalmak *fl* 1. shumohem, shtohem, rritem (në numër); 2. *biol* shumoj, shtoj (në pjellë)
çoğu *ndf* shumicë, pjesa më e madhe (e një gjëje); ***çoğu zaman***, shumë herë
çoğul *em gram* shumës
çoğulcu *em* pluralist
çoğullamak *fl* shumoj, shtoj
çoğullanmak *fl* shumohem, shtohem
çoğunluk *em* shumicë; ***oy çoğunluğu***, shumica e votave
çoğunlukla *ndf* përgjithësisht, zakonisht, me shumicë, në shumë raste,
çok *mb* shumë; **çok defa**, shumë herë
çokevlilik *em* poligami
çokgen *em gjeom* shumëkëndësh
çokhücreli *mb* shumëqelizor
çok kutuplu *mb* shumëpolar
çokluk *em* shumicë (mazhorancë), sasi e madhe, numër i madh
çoktan *ndf* që moti, qyshkur, para shumë kohe, kaherë
çorak *mb* 1. (për tokën) i pafrytshëm, jopjellor, jofrytor, shterp; 2. (per ujin) i hidhur
çoraklık *em* thatësirë, pafrytshmëri
çorap *em* çorap
çorapçı *em* çorapështitës
çorba *em* çorbë
çökel *em* llum, fundëria
çökerme *em* gjunjëzim
çökermek *fl* gjunjëzoj
çökme *em* shembje, shembim, rrënim
çökmek *fl* 1. shembem, shkatërrohem, rrënohem etj
çökük *mb* i shembur, i shkatërruar
çöl *em gjeog* shkretëtirë
çölleşme *em* shndërrim në shkretëtirë
çömelmek *fl* ulem galiç
çömlek *em* enë prej dheu (shtambë, vorbë, poçë etj)

Copyrighted material

çömlekçi *em* poçar
çömleçilik *em* poçari
çöp *em* 1. ndyrësi, bërllok, pleh; 2. ***kibrit çöpü,*** fije shkrepësi
çöpçatan *em* ndërmjetës në martesë, shkues
çöpçü *em* 1. fshesar; 2. pastrues i rrugës
çöplük *em* plehërishte, vend ku hidhen e grumbullohen plehrat
çörek *em* kulaç; një far kurabie
çözelti *em* tretje
çözmek *fl* zgjidh
çözülmek *fl* zgjidhem
çözünme *em* tretje, shkrirje
çözünmek *fl* tretet, shkrihet, zgjidhet
çözüm *em* zgjidhje, solucion
çözümlemek *fl* analizoj, zgjidh (problemin)

çubuk *em* 1. thupër, shufër; **demir çubuk**, thupër hekuri; 2. fidan degë e njomë; 2. çibuk
çukur *em* gropë, hendek; zgavër
çukurlu *mb* vend me gropa, gropa gropa
çuval *em* thes
çük *em popull* organ i mashkullit
çünkü *lidh* sepse, për arsye se, për shkak se, nga se
çürük *mb* i kalbur, i prishur
çürüklük *em* kalbësirë, gjë e kalbur
çürüme *em* kalbje, prishje
çürümek *fl* kalbem, prishem
çürütmek *fl* 1. bëj që të kalbet diçka; 2. mohoj, kundërshtoj, thyej arsyet (e ndonjë pikëpamjeje shkencore)

Copyrighted material

D

da, de 1. *lidh* dhe, edhe, poashtu, gjithashtu; ***babam da pazara gitti***, edhe babai im shkoi në treg; ***bir çikolata da aldım***, po ashtu bleva edhe një çokolatë; 2. prapashtesë për rasën lokativ; ***evde*** në shtëpi; ***pazarda***, në pazar
dadanmak *fl* mu bë shprehi të....
dadaş *em* vëlla
dadı *em* dadë, rritëse fëmijësh
dağ *em* mal
dağcı *em* alpinist
dağcılık *em* alpinizëm
dağılım *em* shpërndarje
dağılmak *fl* shpërndahem, ndahem
dağınık *mb* 1. i shpërndarë; 2. i hallakatur, i hutuar; 3. i parregullt (dhomë, shtëpi etj), i çrregulluar
dağınıklık *em* 1. shpërndarësi; 2. hutim, mendjeshkëpsi; 3. çrregullim, parregullsi
dağınıklık *em* 1. shpërndarësi; 2. hutim; 3. çrregullim, parregullsi
dağıtıcı *em* shpërndarës
dağıtmak *fl* 1. shpërndaj, hedh andej këndej; 2. ndaj, jap (para, ushqim etj); ***fakirlere para dağıttı***, ndau para vobektëve
dağlamak *fl* 1. vulos (kafshën me hekur të nxehtë); 2. *med* djeg (plagën)
dağlı *em* malësor
dağlık *mb* malor; ***dağlık arazı***, vend malor
daha *ndf* 1. përsëri, prapa; ***bir daha***, edhe një herë; 2. edhe, më tutje, ende, akoma; **o *bu otelde daha* kalıyor,** ai akoma rrin në këtë hotel; 3. deri tash; ***kimse daha gelmedi***, deri tash kurrkush nuk erdhi; 4. më; **daha *büyük***, më i madh; ***onu bir daha görmedim***, atë më nuk e pash; 5. *mat* plus, edhe; ***iki daha altı eder sekiz***, dy edhe (plus) gjasht bëjnë tetë
dahi *lidh* edhe, gjithashtu, as; ***bunu ben dahi tanımıyorum***, këtë as (edhe) unë nuk e njoh
dahi *em* gjeni
dahi *mb* gjenial
dahil *em* brendi, brendësi; ***dahil olmak***, marr (përfshij) brenda
dahilen *ndf* brendazi, nga brenda
dahilî *mb* i brendshëm
dahiliye *em* 1. (në punët shtetërore) punë të brendshme; 2. *med* medicinë për sëmundje të brendshme
daima *ndf* 1. gjithmonë; 2. përherë, pandërprerë, vijueshëm

Copyrighted material

daire *em* 1. *mat* rreth; *mat* sipërfaqe e rrethit; 2. banesë (në apartament); 3. zyrë; 4. *müz* tef
dakik *mb* i përpiktë, i saktë, preciz; pedant
dakiklik *em* përpikëri, saktësi, pedantëri
dakika *em* 1. minutë (njësi kohe);2. *mat* minutë (1/60 pjesë e gradës këndor)
daktilo *em* 1. makinë daktilografike; 2. daktilograf/e
daktilografi *em* daktilografi
dal *em bot* 1. degë; 2. *fig* degë; ***bilim dalı***, degë shkencore
dal *em pop* 1. kurriz, shpinë; 2. krahë; 3. qafë
dalak *em anat* shpënetkë, shpretkë
dalamak *fl* 1. kafshoj (qeni, ujku, insekti); 2. shkaktoj kruarje, djegie (hidh, hidhës)
dalaşmak *fl* 1. kafshohen (njëri tjetrin); 2. grinden, përlahen (njëri me tjetrin)
dalavere *em* mashtrim, dredhi, intrigë
dalavereci *em* mashtrues, intrigant
daldırma *em* zhytje
daldırmak *fl* zhyt, zhys; fundos (në ujë); 2. fut, fus (diçka në brendinë e diçkaje)
dalga *em* valë, tallaz, dallgë
dalgacı *em mb* intrigant
dalgakıran *em* digë, ledh, pendë (në limanet detare)
dalgalanmak *fl* valëvis, valëvit (deti, flamuri)
dalgalı *mb* që është valë valë
dalgıç *em* zhytës, ai që zhytet në ujë
dalgın *mb* i shpërndarë, i hutuar (ne mejtime)
dalgınlık *em* hutim, hutje (në mejtime), pavetëdije
dalkavuk *em* lajkatar, përgëdhelës, ledhatar, dallkauk
dallandırmak *fl* degëzoj
dallanma *em* degëzim
dallanmak *fi* degëzohem
dallı *mb* i degëzuar, me degë
dalma *em* zhytje
dalmak *fl* 1. zhytem (në ujë); 2. hyj (në brendin e diçkaje); 3. jap vehtën krejtësisht (pas një pune); 4. thellohem, zhytem (në libër etj); 5. më zuri gjumi; ***hasta daldı***, të sëmurin e zuri gjumi
dam em 1. pullaz, mblojë shtëpie, çati; 2. damë, partnere në vallëzim
damak *em anat* qiellzë (në gojë)
damar *em anat* enë gjaku, venë, arter
damat *em* dhëndër
damga *em* 1. vulë; 2. shenjë, nishan, gjurmë, markë, njollë; ***fabrika damgası***, marka e fabrikës; 3. ***damga pulu***, pullë takse
damgalamak *fl* 1. vulos; 2. vë shenjën e prodhimit; 3. *fig* vulos, turpëroj, njollës (dikë)
damgalanmak *fl* vulosem
damıtık *mb* i destiluar
damıtma *em* destilim
damıtmak *fl* destiloj
damla *em* pikë; ***su damlası***, pikë uji
damlama *em* pikim

Copyrighted material

damlamak *fl* 1. pikoj; 2. *fig* hyj (brenda diku) pa leje, pa ftesë
damlatmak *fl* 1. bëj të pikon, bëj të rrjedhën pika pika, 2. pikoj pika (në sy, në hund etj)
damping *em* damping; ***damping fiyatı***, çmim i ulët
dana *em zool* viç; ***dana eti***, mish viçi
dangalak *mb* i marrë, i paarsyeshëm, torollak, kokëtrashë
danışma *em* këshillim, konsultim; 2. informacion
danışmak *fl* 1. këshillohem; 2. informohem
danışman *em* këshilltar
Danıştay *em* Keshilli Juridik Shtetëror
dans *em* danc, valle, vallëzim; ***dans etmek***, vallëzoj
dansçı *em* valltar
dansör *em* valltar, vallëzues
dansöz *em* valltare, vallëzuese
dantel *em* dantellë
dar *mb* i ngushtë; ***dar sokak***, rrugë e ngushtë; **darda kaldı**, mbeti pa të holla; mbeti në pozitë të rëndë
dara *em* pesha e enës
daracık *mb* shumë i ngushtë
dar ağacı *em* trekëmbëshi për ekzekutimin e të dënuarit me varje
daralmak *fl* ngushtohem
daraltmak *fl* e ngushtoj
darbe *em* goditje, mësymje, grusht, mëshim
dargın *mb* i zemëruar, i hidhëruar; ***bu iki komşu*** **dargındır**, këto dy fqinjë janë të zemëruar
dargınlık *em* zemërim, idhnim
darı *em bot* mel
darılma *em* zemërim, idhnim
darılmak *fl* zemërohem, idhnohem; ***dünkü*** **dostlar** ***bugün darıldılar***, miqtë e djeshëm sot u zemëruan
darlaşmak *fl* ngushtohem
darlık *em* 1. ngushticë; 2. skamje, mangësi, varfëri
darmadağınık *mb* i hallakatur, i shkapërderdhur, i shpërndarë, i çrregulluar
darp *en* goditje
darphane *em* vend ku behet shtypja e të hollave
dava *em* 1. padi, akuzë; 2. problem; ***sınırlar*** **davası,** problemat e kufijve
davacı *em* paditës, akuzues, ai që ngre padinë
davalı *em* (ai që është) i paditur, i akuzuar
davar *em* emri i përbashkët për dhen e dhi, bagëti; **davar sürüsü**, kope dhensh e dhish
davet *em* ftesë, thirrje
davet etmek *fl* ftoj, thërres
davetçi *em* thirrës
davetiye *em* letër ftese
davetli *mb* i ftuar, i thirrur; *em* mysafir, mik, i ftuar
davetsiz *mb* i paftuar, i pathirrur
davranış *em* sjellje, qëndrim
davranmak *fl* sillem; ***budala gibi davranıyor***, sillet (ka qëndrim) si i marrë
davul *em* lodër, daulle, tupan
davulcu *em* daullxhi, tupanxhi, lodërtar

Copyrighted material

dayak *em* 1. rrahje, dajak; ***dayak atmak***, rrah (dikë me shkop); ***dayak yemek***, rrihem (nga dikush); 2. shtyllë, mbështetje, mbështetës
dayalı *mb* 1. i mbështetur; 2. rregulluar, i furnizuar; ***dayalı döşeli daire***, banesë e rregulluar (e furnizuar) me orendi
dayamak *fl* mbështes; ***bastonu duvara dayadı***, bastunin e mbështeti në mur
dayanıklı *mb* 1. i fort, i qëndrueshëm, që rron shumë, i vazhdueshëm
dayanıksız *mb* i dobët, që nuk rron shumë, i paqëndrueshëm
dayanılmaz *mb* i padurueshëm; **bu baskına dayanılmaz**, ky presion nuk mund të durohet
dayanışık *mb* solidar
dayanışma *em* solidaritet, ndihmë reciproke
dayanışmak *fl* solidarizohem
dayanmak *fl* 1. mbështetem; 2. duroj; ***bu terore artık dayanamam***, këtë terror nuk mund të duroj më; 3. përballoj, kundërshtoj; ***bu gemi fırtınaya iyi dayanır***, kjo anije këtë stuhi e përballon mirë
dayı *em* dajë, vëllau i nënës
dazlak *mb* tullac, i shogët, i paflok
dede *em* gjysh
dedektiv/detektif *em* detektiv, agjent i policisë
dedikodu *em* thash e thënë
defa *em* herë; ***ilk defa***, për të parën herë; ***öbür defa***, tjetrën herë; ***beş defa***, pesë herë
defetmek *fl* dëboj, qes jashtë, nxjer (jashtë nga një vend)
defile *em* defile, parakalim mode
define *em* thesar i fshehur, pasuri e fshehur (në tokë)
defineci *em* gërmues i thesarit
defo *em* defekt, e metë, mangësi; ***defolu mal***, mall me të meta
defolmak *fl* shmangem, largohem (fshehurazi, me të shpejtë)
defol! *psth* largohu! hiqu!, zhduku! (pasthirrmë brutal)
defolu *mb* i metë, me të meta, që ka ndonjë mangësi ose e metë; **defolu mal**, mall ose me të meta
defter *em* fletore
defterdar *em* funksionar i lartë që bën administrimin e të ardhurave të prefekturës
deftedarlık *em* ent ku bëhet administrimi i të ardhurave të prefekturës
değer *em* 1. vlerë; 2. çmim
değerbilir *mb* mirënjohës
değerbilmez *mb* mosmirënjohës
değerlendirme *em* vlerësim
değerlendirmek *fl* 1. vlerësoj, bëj të vlerëshëm; 2. çmoj, caktoj çmimin; caktoj vlerën; 3. çmoj, çmoj mejtimet e tua
değerlenmek *fl* vlerësohem
değerli *mb* 1. i çmueshëm, i vlerëshëm, 2. i çmuar, i nderuar; ***bu adam değerli bir kişidir***, ky burrë eshtë një njeri i çmuar, i nderuar

Copyrighted material

değersiz *mb* i pavlershëm, që nuk ka vlerë
değil *paraf* nuk (parafjalë negative); ***değildir***, nuk është; ***o hasta değildir***, ai nuk është i sëmurë
değim *em* meritë
değimli *mb* i merituar
değinmek *fl* 1. prek; 2. bëj fjalë për diçka, përmend diçka
değirmen *em* mulli
değirmenci *em* mullis
değiş *em* këmbim
değiş etmek *fl* këmbej, shkëmbej (gjëra)
değişik *mb* 1. i ndryshuar; 2. i ndryshëm, i llojllojshëm, tjetër (lloj)
değişiklik 1. ndryshueshmëri; 2. ndërrueshmëri; 3. llojllojshmëri
değişim *em* ndërrim
değişken *mb* i ndryshueshëm, i paqëndrueshëm, që mund të ndërrohet
değişmek *fl* 1. ndryshohem; 2. këmbehem (me një gjë tjetër); 3. ndërroj rrobat me rroba të tjera
değiştirmek *fl* 1. ndryshoj; 2. këmbej, shkëmbej 3. ndërroj rrobat (e fëmijës etj)
değme *em* prekje
değmek *fl* 1. prek; 2. arrij, mbërrij
değnek *em* shkop
deha *em* 1. njeri gjenial; 2. gjenialitet
dehşet *em* tmerr, frik e madhe; ***deprem dehşetinden sokağa atıldılar***, nga frika prej tërmetit u
hodhën në rrugë
dehşetli *mb* i tmerrshëm, tmerrues, i trishtueshëm
dejenere *mb* bastard, degjenerik
dek *paraf* gjer, deri; ***tepeye dek çıktı*** doli deri në kulm
dekan *em* dekan
dekolte *em* dekolté; ***dekolteli elbise***, fustan me dekolte
dekor *em* dekor
dekorasyon *em* dekoracion
dekoratör *em* dekorator
dekore etmek *fl* dekoroj
delege *em* delegat
deli *em* i çmendur, i marrë, i luajtur; ***deli etmek***, e çmend (dikë); ***deli olmak***, çmendem; 2. *fig* për së tepërmi i dhënë pas diçkaje, që e ka humbur kryen (nga dashuria etj); ***kitap delisi***, i dashuruar pas librit; ***oyun delisi***, i dhënë përsëtepërmi pas lojës
delik *em* 1. vrimë, birë; 2. *fig* burg
delikanlı 1. *em* djalosh, djalë i ri; 2. *pasth* (në thirrje): **Delikanlı!** Hej djalosh!
delil *em* 1. dëshmi, argument, provë
delilik *em* çmenduri, marrëzi, munges arsyeje
delirmek *fl* çmendem, marrosem, e humb arsyen
delmek *fl* 1. shpoj, vrimoj, çel vrima; 2. *fig* ofendoj
demeç *em* deklaratë (dhënë shtypit nga personi i autorizuar)
demek *fl* 1. them; 2. emër toj; ***buna Türkçe elma derler***, Turqisht kësaj i thonë mollë; 2. do të thotë, domethënë, ***"kamer" sözcüğü "ay" demektir***,

Copyrighted material

fjala "kamer" domethënë "hënë"
demet *em* 1. tufë, tubë (lulesh), duj, duaj
demin *ndf* pak para, mëpara, përpara (kohë); ***okuldan demin geldim***, nga shkolla erdha pak përpara
demincek *ndf* pak përpara, më parë
deminki *mb* i mëparshmi
demir *em kim* 1. hekur; 2. *detë* spirancı, hekur anije
demirbaş *em* inventar
demirci *em* farkëtar
demiryolu *em* hekurudhë
demlemek *fl* përvëloj (çajin)
demlik *em* enë (ibrik) për të përvëluar çajin
demokrasi *em* demokraci
demokrat *em* demokrat
demokratik *mb* demokratik
deneme *em* 1. provë, orvatje; 2. provë, eksperiment
denemek *fl* 1. provoj; 2. eksperimentoj
denetim *em* kontroll, inspektim
denetici *em* kontrollor
denetleme *em* kontrollim
denetlemek *fl* kontrolloj, inspektoj
deney *em* provë, eksperiment; ***deney yapmak***, bëj provë, bëj eksperiment
deneyim *em* përvojë, eksperiencë
deneyimli *mb* i përvojshëm, që eshtë me përvojë, që eshtë me eksperiencë
deneyimsiz *mb* i papërvojë, i paeksperiencë
denge *em* drejtpeshim, ekuilibër, baraspeshë
dengeli *mb* i ekulibruar, i sjellur në drejtpeshim
dengesiz *mb* i paekuilibruar, i padrejtëpeshuar, që nuk është në drejtpeshim
dengesizlik *em* paekuilibrim
deniz *em* det/i
denizaltı *em usht* nëndetëse
deniz anası *em zool* meduzë (Aurelia)
deniz aşırı *ndf* përtej detit; ***deniz aşırı ülkeler***, vende (shtete) përtej detit
deniz bilimi *em* okeanografi
denizci *em* 1. detar, marinar, shtegtar deti, lundërtar; 2. pronar anije
denizcilik *em* 1. lundrim detar; 2. marinë, ushtri detare; 3. mjeshtrija e ndërtimit të anijeve
denk *em* 1. vandak, deng; 2. ekuilibër; 3. gjysma e barrës së kalit
denklem *em* ekuacion, barazim; **bir bilinmeyenli denklem,** barazim me një të panjohur
denkleştirmek *fl* ekuilibroj, barazoj, sjell në drejtpeshim
deplasman *em sp* ndeshje në teren të huaj (si mysafir)
depo *em* depo, magazinë
depolama *em* deponim
depolamak *fl* deponoj, vendos (diçka) në depo
depozito *em* depozitë
deprem *em* tërmet
deprem bilimi *em* sizmologji
dere *em* përrua
derebeyi *em* feudal, pronar i madh tokash

Copyrighted material

derebeylik *em* feudalizëm
derece *em* 1. shkallë, grad; 2. rang, rend, grad; 3. termometër
dergâh *em* teqe
dergi *em* revistë; ***aylık dergi***, revistë mujore
derhal *ndf* menjëherë, në atë çast, aty për aty
deri *em* lëkurë
derin *mb* i thellë; ***derin kuyu***, pus i thellë
derinleşmek *fl* thellohem
derinlik *em* thellësirë
dernek *em* shoqatë
ders *em* mësim; orë mësimi; ***ders kitabı***, libër mësimi; **ders programı**, orar javor i mësimeve ***ders vermek***, jap mësim; *fl fig* qortoj (dikë)
dershane 1. klasë (dhomë) mësimi; 2. ent mësimor jashtë shkollor
dert *em* 1. sëmundje shumë zgjatëse e pashërueshme; 2. dert, brenga, hall, pikëllim, hidhërim, shqetësim
dertleşmek *fl* qaj hallin (tim dikujt)
dertli *mb* 1. i brengosur, i vuajtur, i pikëlluar; 2. i sëmurë, i dobët, i pafuqishëm
dertsiz *mb* i pabrenga, pa hall, pa dert
derleme *em* përmbledhje
derlemek *fl* përmbledh
derli toplu *mb* i rregullt, i rregullshëm
desen *em* 1. mostër, model, shembull, zbukurim (në tekstil, qeramik etj)
destan *em letërsi* epope
deste *em* tufë, buqetë (lulesh)
destek *em* 1. mbajtës, mbështetjedhënës (send); 2. përkrahje, mbrojtje, ndihme; ***destek olmak***, përkrah, mbroj
desteklemek *fl* 1. mbështes (që të mos rrëzohet); 2. përkrah, mbroj, ndihmoj
destekli *fl* 1. i mbështetur; 2. i përkrahur
deşmek *fl* 1. skalit, gdhend; çaj
detay *em* detaj, hollësi, imtësi
detaylı *mb* i hollësishëm, i imtësuar, me detaje
detektif *em* dedektiv
dev 1. *em* div, xhind,, figurë e përrallave popullore; 2. vigan, gjigant, kolosal
deva *em* mjet shërimi, bar, ilaç
devaluasyon *em* devalvim
devam *em* vazhdim; ***devam etmek***, vazhdoj
devamlı *mb* i vazhdueshëm, i pandërprerë, i përhershëm
devamlılık *em* vazhdueshmëri
devamsız *mb* i pavazhdueshëm, i pa vijueshëm
devamsızlık *em* pavazhdueshmëri
deve *em zool* deve (Camelus)
devir *em* 1. kohë, epokë, periudhë, shekull; 2. rrotullim; 3. shetitje (rreth diçkaje); ***kentin çevresinde bir devir yaptık***, rreth qytetit bëmë një shetitje
devirli *mb* periodik
devirme *em* përmbysje, rrëzim
devirmek *fl* përmbys, rrëzoj

Copyrighted material

devlet *em* shtet; ***devlet bashkanı,*** kryetar (president) i shtetit
devletleştirme *em* shtetëzim, të shtetëzuarit, nacionalizim
devletleştirmek *fl* shtetëzoj, nacionalizoj
devre *em* 1. periodë, kohë e caktuar, fazë; ***birinci devre,*** *sp* periodë (pjesa, gjusma) e parë (e lojës) 2. *fiz* ***elektrik devresi,*** qarku elektrik
devrik *mb* 1. i përmbysur, i rrëzuar; 2. i kthyer (prapësht)
devrilmek *fl* përmbysem, rrëzohem
devrim *em* 1. revolucion; 2. reform
devrimci *em* revolucionar
devriye *em* patrullë
deyim *em* 1. shprehje; 2. fjalë e urtë, proverb
deyiş *em* shqiptim
dezavantaj *em* gjendje e pavolitshme, disfavor, pengesë
dezenfekte *mb* i dezinfektuar
dış *em* 1. pamja (ama) e jashtme (e diçkaje); 2. *mb* i jashtëm; ***dış kapı,*** dera e jashtme; ***dış siyaset,*** politika e jashtme **dışarı** *ndf* jashtë, jo brenda; ***çocuk dışarı çıktı***, djali doli jashtë
dışbükey *mb* konveks, kurrizor
dışlamak *fl* lë jashtë, përjashtoj
dışişler *em* punë të jashtme; ***dışişleri bakanlığı***, ministria e punëve të jastme
dışkı *em* bagët, mut
didaktik *mb* didaktik
didiklemek *fl* bëj copa copa, coptoj
didinmek *fl* përpiqem, mundohem, orvatem, punoj fort; ***o kadar didindim ki sonunda baygın düştüm,*** aq u përpoqa sa që më në fund më ra të fikët
difteri *em med* difteri
diğer *mb* (diçka ose dikush) tjetër; ***diğer taraftan***, nga ana tjetër
dijital *mb* digjital
dik *mb* 1. *mat* normal (ndaj ndonjë sipërfaqe a vijë); 2. vertikal, pingul
dikdörtgen *em mat* katërkëndësh kënddrejtë (drejtkëndësh)
diken *em* ferrë, gjemb
dikenli *mb* me ferra, me gjemba, i gjembshëm
dikensi *mb* që i përngjan gjembit
dikey *em* 1. *mat* normal; 2. vertikal, pingul
dikili taş *em* obelisk
dikilmek *fl* 1. vë, vendoj, vendos (diçka diku); ***buraya bir anıt dikilecek***, këtu do të vendoset një monument; 2. mbjell; ***bahçeye meyve ağaçları*** **dikilecek**, në kopsht do të mbillen druj pemësh
dikiş *em* qepje; ***dikiş makinesi***, maqinë qepse
dikişçi *em* qepës, rrobaqepës
dikiz *em* vështrim i fshehur, përgjim; ***dikiz aynası***, retrovizor; ***dikiz etmek***, vështroj, përgjoj
dikizlemek *fl* vështroj fshehurazi

Copyrighted material

dikkat *em* kujdes, vëmendje; *pasth* Vini re! ***dikkat etmek,*** kujdesem, vëj re
dikkatle *ndf* me kujdes, me vëmendje
dikkatlı *mb* i kujdesshëm, i vëmendshëm
dakkatsız *mb* i pakujdesshëm
dikkatsizlik *em* pakujdesi, pavendshmëri
dikme *em* 1. qepje; 2. mbjellje; 3. vendosje
dikmek *fl* 1. qep; 2 mbjell; 3. vë, vendos
dikmek *fl* 1qep; 2. mbjell; 3. vë, vendos
diktatör *em* diktator
diktatörlük *em* diktaturë
dikte *em* diktat, diktim
dil *em* 1. *anat* gjuhë; 2. mjet komunikacioni, të folurit; ***ana dili,*** gjuha amtare, ***yabancı dil***, gjuhë e huaj
dilbilgisi *em* shkenca e gjuhës, gramatikë
dilek *em* dëshirë, lutje, kërkesë
dilekçe *em* lutje (e shkruar), kërkesë (e shkruar)
dilemek *fl* dëshiroj, kërkoj, lus
dilenci *em* lypës, lypsar, ai që lyp lëmoshë
dilencilik *em* lypësi
dilenme *em* lypje
dilenmek *fl* lyp, kërkoj lëmoshë
dilim *em* thelë, rriskë; ***bir dilim ekmek,*** një thelë bukë
dilimlemek *fl* ndaj në thela
dilsiz *mb* 1. memec, pa gojë, i nemtur; 2. *fig* i heshtur
dimdik *mb* plotësisht i drejt, pingul
din *em* fe, religjion, besim
dinamik *em* dinamikë; *mb* dinamik
dinamit *em* dinamit, substancë eksplozive
dinamo *em* dinamo
dinamometre *em fiz* dinamometër
dinç *mb* i fortë, i shëndosh, i fuqishëm, i gjallë, energjik, i zhdërvjelltë
dindar *em* fetar, religjioz
dindarlık *em* fetari, besimtari
dindaş *em* bashkëfetar
dindirmek *fl* e qetësoj
dingil *em* bosht
dinî *mb* fetar, ***dinî kitaplar,*** libra fetare
dinleme *em* dëgjim
dinlemek *fl* dëgjoj
dinlenme *em* pushim, çlodhje
dinlenmek *fl* pushoj, çlodhem
dinmek *fl* mej, pushoj, ndal; qetësoj; ***yağmur dindi,*** shiu pushoj; ***ağrı dindi***, dhembja u ndal
dinleyici *em* dëgjues
dinozor *em zool* dinozaur
dinsel *mb* i fesë, që i përket fesë, fetar, relgjioz
dinsiz *mb* i pafe, ateist
dinsizlik *em* ateizëm
dip *em* fund; ***deniz dibi***, fundi i detit; 2. afër (diçkaje); ***ağaç dibinde oturduk,*** ndejtëm afër (pran drurit)
diploma *em* diplomë
diplomasi *em* diplomaci
diplomat *em* diplomat
diplomatik *mb* diplomatik
diplomatlık *em* diplomaci
dipsiz *mb* pa fund, që s'ka fund

Copyrighted material

direk *em* shtyllë, direk
direksiyon *em* drejtues, timon (i automobilit)
dierekt *mb* i drejtpërdrejtë, direkt; *ndf* në mënyrë direkte
direktif *em* direktivë, udhëzime
direktör *em* drejtor
diren, dirgen *em* tërfurk, tërfurq, cfurk
direnç *em* 1. rezistencë, qëndresë; 2. *fiz* rezistencë; 3. *fiz* reostat
dirençsiz *mb* pa rezistencë, paqëndresë
direnmek *fl* këmbëngul, kundërshtoj, nuk bëj lëshim, insistoj, rezistoj
diri *mb* i gjallë; 2. . *fig* i gëzueshëm, i hareshëm, energjik, i fuqishëm, i zhdërvjelltë
dirilik *em* gjallëri, të qenët i gjallë
diriliş *em* rilindje
dirilme *em* ngjallje
dirilmek *fl* ngjallem
dirsek e*m anat* bërryl; ***dirseğini kırdı***, e theu bërrylin
disiplin *em* disiplinë
disiplinli *mb* i disiplinuar
disiplinsiz *mb* i padisiplinuar
disk *em sp* disk
diskalifiye etmek *fl* diskualifikoj
disket *em* disket
disko *em* disko
diskotek *em* diskotekë
dispanser *em* dispanseri
distribütör *em* distributor, shpërndarës, ndarës
diş *em anat* dhëmb; ***diş ağrısı***, dhembja e dhëmbit
dişçi *em* dentist, dhëmbëtar
diş eti *em anat* mish i dhëmbëve
dişi *mb* i femrës, femëror
dişlemek *fl* kafshoj, grimcoj
dişli *em* me dhëmbë
diyalog *em* dialog, bashkëbisedim
diyanet *em* religjion, besim
diyafram *em* diafragmë
diye *ndf* për, duke mejtuar; ***sizi göreyim diye geldim***, erdha për të parë ju; ***telefon edersin diye bekledim***, prita duke menduar se do të telefonosh
diyet *em* dietë
diz *em anat* gju; ***diz çökmek***, qëndroj i gjunëzuar, gjunjëzohem
dizanteri *em med* dizenteri
dizel *em* dizel
dizgi *em* radhitje germash në shtypshkronjë
dizgici *em* radhitës (në shtypshkronjë)
dizgin *em* kapistër, dizgjin, fre
dizginlemek *fl* frenoj
dizi *em* 1. seri; 2. rresht, radhë, varg, rend
dizilmek *fl* renditem, hyj në rresht
dizim *em* indeks, listë sipas renditit alfabetik
dizmek *fl* rreshtoj, radhis, rregulloj
diz üstü *ndf* mbi gju
doçent *em* docent
doğa *em* natyrë
doğacı *em* natyralist
doğacılık *em* natyralizëm
doğal *mb* natyror; i natyrës
doğa ötesi *em* metafizikë
doğa üstü *mb* i mbinatyrshëm
doğma *em* lindje, të lerët, të lindurit në botë

Copyrighted material

doğmak *fl* 1. lind (fëmija); 2. lind (dielli); 3. zbardhet, agon (dita)
doğrama *em* copëtim duke prerë
doğramacı *em* zdrukthëtar
doğramacılık *em* zdrukthëtari
doğramak *fl* copëtoj duke prerë
doğru *mb* 1. i drejt; ***doğru yol,*** rrugë e drejt; 2. vërtetë; ***doğru haber***, lajm i vërtetë; 3. drejt; ***doğru adam,*** njeri i drejtë; 4. *mat* drejtëz, vi; 5. *ndf* në më- nyrë te drejtë; 6. *paraf* kah, në drejtim të; ***batıya doğru,*** kah (në drejtim të) perëndimit
doğruca *ndf* drejtas
doğrudan *ndf* drejtpërsëdrejti, direkt
doğrulama *em* vërtetim, pohim
doğrulamak *fl* vërtetoj, pohoj (të qenit vërtetë të ndonjë lajmi a ndodhi)
doğrulmak *fl* drejtohem, ndre-qem
doğruluk *em* drejtësi, vërtetësi; sinqeritet, ndershmëri
doğu *em* lindje, ana nga lind dielli
doğulu *mb* oriental
doğum *em* lindje, të ardhurit në botë; ***doğum günü,*** ditëlindja; ***doğum kontrolu*** , kontrolli i të lindurit; ***doğum yapmak***, lind, pjell (gruaja); ***doğum yeri***, vend-lindje
doğum evi *em* maternitet, lindë-tore, shtëpi lindjeje
doğumlu *mb* i lindur (në vjet a vend)
doğurgan *mb* pjellor, që pjell shumë
doğurma *em* pjellje
doğurmak *fl* lind, pjell (gruaja)
doğuştan *mb* i lindur, i natyr-shëm, nga lindja; ***doğuştan hasta***, i sëmurë nga lindja
doksan *em* nëntëdhjetë
doksanar *mb* nga nëntëdhjetë
doksanıncı *mb* i nëntëdhjeti
doktor *em* doktor, mjek
doktora *em* doktoratë; ***doktora tezi,*** vepër doktorate, disertacion
doku *em anat* ind/i
dokumak *fl* end (në vargje); ***bütün gün bez dokudum,*** tërë ditën enda pëlhurë
dokunaklı *mb* i prekshëm, i mallëngjyeshëm
dokunma *em* prekje
dokunmak *fl* prek (me dorë, me. . .)
dokunulmazlık *em* paprekshmëri, pacenueshmëri, imunitet
dokuz *em* nëntë
dokuzuncu *mb* i nënti
doküman *em* dokument
dolamak *fl* 1. mbështjell¸ 2. mbledh (si lëmsh diçka)
dolambaç *em* lak, kthesë, bë-rryl (rruge, lumi etj), dredhë
dolambaçlı *mb* dredha – dredha
dolandırıcı *em* mashtrues
dolandırıcılık *em* mashtrim, të mashtruarit
dolandırmak *fl* 1. mashtroj; 2. rrethoj, mbështjell (me diçka)
dolanmak *fl* 1. rrethoj, kaloj, shetis (rreth e përqark një gjë-sendi); 2. mbështillem
dolap *em* dollap
dolapçı *em* 1. dollap punues; 2. *fig* gënjeshtar, mashtrues

Copyrighted material

dolar *em* dollar
dolaşık *mb* 1. i lakuar, gjarpërues; 2. i ngatërruar, i ndërlikuar; ***dolaşık iş***, punë e ndërlikuar
dolaşıklık *em* ngatërri, ngatërresë
dolaşım *em* shëtitje rreth e rrotull; qarkullim; ***kan dolaşımı***, qarkullim i gjakut
dolaşma *em* shëtitje rreth e rrotull
dolaşmak *fl* 1. shëtis; 2. shëtis rreth e rrotull; 3. ngatërroj, ndërlikoj, gërshetoj (flokët, penjët etj)
dolaştırmak *fl* e shetis (rrethin dikë); ***bana şehri dolaştırdı***, më shetiti nëpër qytet
dolayı *ndf* 1. rreth, përqark; 2. *parf* për arsye se, për shkak të, prandaj
dolayısıyla *ndf* 1. gjegjësisht, përkatësisht; 2. nga ky shkak, për këtë arësye, pra
dolaylı *mb* ndërmjetësisht, indirekt, tërthorazi
dolaysız *mb* direkt, i drejtpërdrejt
doldurmak *fl* mbush, bëj që diçka të mbushet
dolgu *em* 1. mbushje; 2. material për mbushjen (e diçkaje); 3. plombë (materijal për mbushjen e dhëmbit)
dolgulu *mb* i mbushur; ***dolgulu diş***, dhëmb i mbushur
dolgun *mb* 1. i mbushur; 2. i trashë, i majmë; 3. (për rrogën mujore) shum
dolma *em* 1. mbushje; 2. lloj gjelle; ***biber dolması***, speca të mbushura
dolmak *fl* mbushet (diçka); 2. mbushet, kalon (koha, afati)
dolmakalem *em* stilograf
dolmuş *mb* 1. i mbushur; 2. *em* lloj taksi që vozit në largësi të caktuar
dolu *mb* i mbushur
dolu *em* breshër; ***ceviz büyüklüğünde dolu yağdı***, ra breshër në madhësi të arrës
doludizgin *ndf* (për kuaj) vrapim me të katra
dolunay *em* hënë e plotë
domates *em bot* domate
dominyon *em* dominion
domuz *em zool* thi/u, derr/i; ***domuz eti*** mish derri
domuzluk *em fig* kokëfortësi
don *em* 1. brek; 2. acar, të ftohtët, akul; ***don ekinlere zarar verdi***, acari e dëmtoj të mbjellat
donakalmak *fl* 1. ngrij (nga të ftoftit); 2. *fig* habitem, gurëzohem, mbetem i shtangur; ***onu görünce donakaldım***, kur e pashë atë u gurëzova
donanım *em* mjete pajisjeje, instalim
donanma *em* 1. stolisje, zbukurim; 2. flotë; ***savaş donaması***, flota luftarake; 3. argëtim, solemn me flamuj, fishekzjarri etj në ditë të festave
donanmak *fl* stolisem
donatmak 1. zbukuroj, stolis; 2. furnizoj, pajis
dondurma *em* 1. akullore; 2. ngrirje
dondurmacı *em* akullore shitës

Copyrighted material

dundurulmuş *fl* i grirë, që ka grirë
dondurmak *fl* ngrij (diçka)
donma *em* grirje
donmak *fl* ngri, mërdhij, mërdhihem (nga të ftoftë)
donuk *mb* i ngrirë, 2. i turbull, i errët (që nuk shkëlqen; 3. *fig* i pagjallëri, i plogësht, i mpimë
donyağı *em* dhjam
dopdolu *mb* i mbushur plot
doping *em* doping
doruk *em* majë (e drurit, malit etj)
dosdoğru *mb* plotësisht drejt, shumë drejtë
dost *em* 1. mik, shok; 2. dashnor
dostane *ndf* miqësisht
dostça *mb* miqësor; *ndf* miqësisht
dostluk *em* miqësi
dosya *em* dosje; ***öğrenci dosyası***, dosja e nxënësit
dosyalamak *fl* klasifikoj në dosie
doyma *em* ngimje, ngopje
doymak *fl* ngihem, ngopem
doymuş *mb* i ngopur
doyum *em* 1. ngopje; 2. kënaqësi
doyurmak *fl* ngij, ngop (dikë)
doyurucu *mb* i kënaqshëm, që të kënaq dhe të plotëson dëshirën, i volitshëm
doz *em* 1. dozë; 2. ***dozunu kaçırmak***, teproj në diçka (në punë, në mesim, në të ngrënë, në të pirë etj)
dökme *em* derdhje, shkrirje, tretje
dökmecilik *em* mjeshtëria dhe puna e shkrirësit të metaleve
dökülmek *fl* derdhem; bij, fundosem, batis, shembem; ***tavan dökülür***, shembet tavani
döküm *em* shkrirje, tretje, derdhje (e metaleve); **demir dökümü**, hekur i derdhur, i shkrimë, gizë
dokümcü *em* shkrirës, tretës, derdhës i metaleve
dökümcülük *em shiko* dökmecilik
dokümhane *em* uzinë shkrirjeje
döküntü *em* mbeturira
döndürmek *fl* 1. rrotulloj; 2. kthej (prapa); ***paralarımı döndürdü***, m'i ktheu paratë
dönek *mb* (njeri) i paqëndrueshëm, jostabil, i ndryshueshëm, i mendjelehtë, i pabesë
dönem *em* 1. periudhë; 2. semestër
dönemeç *em* kthesë, lak (rruge, lumi etj)
dönemeçli *mb* me kthesa, lakor
döner *mb* 1. rrotullues; 2. *em* mish që piqet në bosht rrotullues vertikal
dönme *em* 1. rrotullim; 2. kalim në fenë muslimane
dönmek *fl* 1. rrotullohem; 2. kthej (shiqimin, drejtimin etj); 3. kthehem (prapa); ***okuldan dönüyor***, kthehet nga shkolla
dönüm *em* 1. rreth 1000 m² të sipërfaqes së tokës 2. kthesë, ndërim, ndryshim gjendjeje; ***savaşın dönüm noktası***, pika e ndërimit të gjendjes së luftës
dönüş em 1. rrotullim; 2. kthim
dönüşmek *fl* shndërroj (diçka në tjetër gjë), transformoj

Copyrighted material

donüşüm *em* transformim, shndërrim
dördüncü *mb* i katërti
dört *em* katër
dörder *mb* nga katër
dörtgen em *geom* katërkëndësh
dörtnal *em* më të katra
dörtyol *em* udhëkryq; ***dörtyol ağzı***, udhëkryq
döşek *em* dyshek, shtrat
doşeli *mb* i pajisur, i pajisur me orendi
döşeme *em* 1. dysheme; 2. mobilim
döşemek *fl* shtroj (çarçaf, shtrat, qilim etj); 2. kaploj, mbuloj (diçka me një shtresë tjetër); 3. furnizoj, shtroj banesën me mobilje; 4. instaloj
döşeyici *em* instalues, ai që instalon, ai që shtron
döviz *em* devizë, valutë; ***döviz kuru***, kurs valutash
dövme *em* rrahje
dövmek *fi* 1. rrah (dikë); 2. tund, turbulloj, përziej (kosin e bëj dhallë); 3. farkoj (rrah hekurin e nxehtë me çekiç)
dövülmüş *mb* i rrahur
dövüş *em* rrahje, të rrahurit
dövüşmek *fl* rrihem, mbytem, vritem (reciprokisht me dikë)
drama *em* dramë
dramatik *mb* dramatik
dramalaştırma *em* dramatizim
dramalaştırmak *fl* dramatizoj
dua *em* lutje fetare, dua; ***dua etmek***, lus(t) zotin
duacı *em* lutës, ai që bën dua
dudak *em anat* buzë
dul *mb* i vej, vejan; e vejë, vejushe
duman *em* tym
dumanlı *mb* 1. i tymuar, i tymosur; 2. i mjegulluar, i mbuluar me mjegull
dumanlamak *fl* tymos (dikë a diçka)
dumanlanmak *fl* tymosem
dupleks *em* banesë ose shtëpi dykatëshe
durak *em* stacion; ***otobüs durağı***, stacion autobusi
duraklama *em* ndalje, të ndalët, ndërprerje
duraklamak *fl* ndal, ndërpres (punën, lëvizjen etj)
durdurma *em* ndalim, ndalje, ndërprerje
durdurmak *fl* 1. ndal, ndaloj (dikë); 2. ndërpres (punët, pagesën etj)
durdurmaksızın *ndf* pandalë, papushim, pandërprerje
durgun *mb* 1. i palëvizshëm, amull; 2. *fig* i qetë, i pazëshëm; pa valë (për detin)
durgunlaşmak *fl* qetësohem, amullohem
durgunluk *em* palëvizshmëri, amulli, ndalje, ngecje, ndërprerje
durmak *fl* 1. ndalem, ***saat durdu***, ora u ndal; 2. qëndroj, jam; ***kitaplar hala dolapta duruyor***, librat ende qëndrojnë (janë) në dollapë; 3. pres; ***ne duruyorsun, devam et***, çka po pret, vazhdo
duru *mb* i kthjellët
durulama *em* kthjellim, shpëlarje

Copyrighted material

durulamak *fl* kthjelloj; shpërlaj
durum *em* gjendje, situatë, pozitë
duruş *em* 1. ndalje, të ndalët; 2. qëndrim
duruşma *em jur* seancë gjyqësore, proces gjyqësor
duş *em* dush; ***sıcak duş***, dush i nxehtë; ***soğuk duş***, dush i ftohtë
dut em *bot* man; ***kara dut***, man i zi
duvak *em* duvak, vel i nusërisë
duvar *em* mur
duvarcı *em* murator
duyarlı *mb* i ndjeshëm, i prekshëm, sentimental
duyarlık *em* ndjesi, prekshmëri
duygu *em* ndjenjë, ndijë, shqisë, ndijim
duygulanmak *fl* tronditem, prekem, mallëngjehem, ndjej kënaqësi
duygulu *mb* i ndjeshëm, sentimental
duygusal *mb* i ndjeshëm, sentimental, emocional
duygusuz *mb* 1. i pandjeshëm, zemërgur, i padhembshëm, indiferent
duygusuzluk *em* pandjesi, padhimbsuri, indiferentizëm
duymak *fl* 1. dëgjoj; 2. ndjej, kap me shqisa
duyurmak *fl* lajmëroj, informoj, shpall
duyuru *em* lajmërim, informim, shpallje
düdük *em* zamare, bilbil, fishkëllyese e vogël
düğme *em* kopsë, pullë, sumbull, mbërtheckë; ***elektrik düğmesi,*** çelës elektriku
düğmelemek *fl* mbërthej, kopsit, (kopsis)
düğüm *em* nyje
düğmlemek *fl* lidh nyje
düğümlenmek *fl* lidhem me nyje
düğün *em* dasmë
dükkân *em* dyqan, shitore
dülger *em* zdrukthëtar, karpentier
dülgerlik *em* zdrukthëtari, karpentieri
dümdüz *mb* plotësisht i rrafshtë
dümen *em* timon, drejtues
dün *em* dje
dünkü *mb* i djeshmi
dünür *em* krushkë/u
dünya *em* 1. botë, rruzulli i tokës; 2. botë, njerëzia, gjithkush; ***dünya rekoru***, rekord botëror; ***dünya şampionu***, kampion i botës; ***dünya güzeli***, bukuroshja e botës
dürbün *em fiz* dylbi
dürmek *fl* 1. duke rrotulluar mbështjell një send në formë cilindri (qilim, letër etj), palos
dürtmek *fl* 1. thumboj, ngacmoj (leht); 2. prek (dikë); 3. nxit, stimuloj
dürtü *em* shtytje, shtysë, nxitje, inkurajim, stimul
dürüst *em* korrekt, i ndershëm, i drejtshëm
dürüstlük *em* korrektësi, ndershmëri, drejtësi
düş *em* ëndër; ***gece heyecanlı bir düş gördüm***, mbrëmë pash një ëndër tronditës
düşey *mb* vertikal

Copyrighted material

düşkün *mb* i varfër, i vobektë, i mjerë; 2. i prirë, i dhënë pas (një gjëje)
düşkünlük *em* 1. varfëri, vobeksi; 2. pirje, pasion, të dhënët pas diçkaje
düşman *em* armik
düşmanlık *em* armiqësi
düşme *em* rrëzim
düşmek *fl* rrëzohem
düşük *mb* i rrëzuar
düşünce *em* 1. mendim; 2. ide; 2. brengë
düşünceli *mb* 1. i mendshëm, i kuptueshëm, i arsyeshëm; 2. i brengosur, i shqetësuar
düşüncesiz *mb* i pakuptueshëm, i paarsyeshëm; i pakujdesshëm
düşünmek *fl* mendoj, gjykoj, sajoj në mendje
düşünür *em* mendimtar
düşünme *em* mejtim, mendim, të menduarit
düşürme *em* rrëzim, rrëzuarje
düşürmek *fl* 1. lëshoj (diçka) të bie (poshtë); 2. rrëzoj, përmbys
düşüş *em* rrëzim
düz *mb* i rrafshët, i drejt, i lëmuet
düzelmek *fl* rrafshohem, drejtohem, përmirësohem (i sëmuri)
düzeltmek *fl* 1. rrafshoj, lëmoj; 2. drejtoj; 3. rregulloj; 4. ndreq, korrigjoj
düzeç *em* nivelues
düzeçleme *em* rrafshim, nivelim
düzeçlemek *fl* rrafshoj, niveloj
düzeltmen *em* korrektor
düzen *em* rend, rregullim (shoqëror), regjim
düzenbas *em* gënjeshtër, rrenacak
düzenleme *em* rregullim, organizim
düzenlemek *fl* 1. rregulloj, sjell (diçka) në rregull; 2. organizoj
düzenleyici *em* rregullues, organizator
düzenli *mb* i rregullt, i rregullshëm, i rregulluar
düzenlik *em* rregullsi
düzensiz *mb* i parregullt, që s'ka rregull
düzensizlik *em* parregullsi
düzenteker *em* volant
düzey *en* nivel; ***göl suyun düzeyi,*** niveli i ujit të liqenit
düzgün *mb* i rrafshët, i lëmuar, i rregullt, pa të meta
düzgünlük *em* rregullsi, përpikëri
düzine *em* duzinë, (12 copa të një sendi)
düzlük *em* rrafshinë; sipërfaqe e rrafshët, e gjerë dhe e çelur
düzyazı *em letërsi* prozë

Copyrighted material

E

e - shkronja e gjashtë e alfabetit Turk
ebat *em* dimension, përmasë, madhësi
ebe *em* mami, mamicë, mëndeshë
ebedilik *em* përjetësi, amshim
ebe kuşağı, ebem kuşağı *em* ylber, brezi i zonjës
ebediyen *ndf mb* i përhershëm, i përjetëshëm
ebelik *em* mjeshtëria e mamicës
ebevyen *em* prind
ecel *em* koha (moment) e vdekjes
ecdat *em* stërgjyshërit, ta parët tanë
ece *em* mbretëreshë
ecnebi *mb* i jashtëm, i huaj; *em* njeri i huaj
ecza *em kim* prodhime kimike
eczacı *em* farmacist
eczacılık *em* farmakologji
eczane *em* farmaci, barnatore (shitore)
edat *em gram* parafjalë
edebî *mb* letrar, që ka lidhje me letërsinë
edebiyat *em* letërsi, literaturë,
edebiyatçı *em* letrar, shkrimtar
edepli *mb* i sjellshëm
edepsiz *mb* imoral, i pandershëm
edepsizce *ndf* paturpësisht
eder *em* çmim, vler; kushton
edilgen *em gram* pasiv; trajta pasive (pësore) e foljes
edilmek *fl* bëhem
edinmek *fl* marr, fitoj, përfitoj, siguroj; ***yeni bilgiler edindi,*** përfitoj dije të reja
editör *em* botues, editor
efe *em* 1. trim, trim i fshatit; 2. vëllai i madh; 3. kabadai
efendi *em* 1. zotëri, zotni; 2. zotërues, pronar; **köylü memleketin efendisidir**, fshatari eshtë pronar i atdheut; 3. zotëri, fisnik; 4. *fig mb* i sjellshëm, i kulturuar; i njerëzishëm; **komşumuz efendi bir adamdır,** fqiu i ynë është njeri i kulturuar
efendim! *pasth* 1. (gjatë thirjes): Urdhëroni! **Hasan**! -**Efendim**! Hasan! -Po zotëri!, Urdhëroni zotëri! 2. (në pyetje): ***Efendim?*** Nuk të kuptova (nuk mora vesh)? 3. (duke bërë nderë): ***Haklısın efendim!*** Keni të drejt zotëri!
efkâr *em* 1. brengë, hidhërim, pikëllim; 2. *(shumës)* mendime
efkârlı *mb* i brengosur, i hidhëruar, i pikëlluar
efsane *em* legjendë
egemen *em mb* sovran
egemenlik *em* sovranitet
egoist *mb* egoist

Copyrighted material

egzama *em med* ekzema, majasil
egzersiz *em* ushtrim, stërvitje; ***egzersiz yapmak,*** ushtroj, stërvis
egzotik *mb* ekzotik
egzos *em* hedhja e gazrave të djegura jasht nga motori i automjeteve
eğe *em* 1. limë; 2. *anat* brinjë
eğelemek *fl* gdhend me limë, limoj
eğer *lidh* në se, në qoftë se, në rastë se; ***eğer hava güzel olursa gezeceğim,*** në qoftë se koha do të jetë e mirë do të shëtis
eğik *mb* i pjerrët, ***eğik düzlem*** *fiz* rrafsh i pjerrët; i kërrusur
eğiklik *em* pjerrtësi, kërrusje
eğilim *em* prirje
eğilimli *mb* 1. i prirur, që eshtë me prirje; 2. i pjerrët
eğilme *em* përkulje **eğilmek** *fl* 1. përkulem; 2. përkul, lakoj; 3. *fig* nën-shtrohem
eğim *em* pjerrësi, pjerrësirë
eğirme *em* tjerrje
eğirmek *fl* tjerr
eğirmen *em* vegël tjerrëse
eğitici *mb* edukues, që edukon; ***eğitici film,*** film edukues
eğitim *em* 1. arsim; ***yüksek eğitim,*** arsim i lartë; ***zorunlu eğitim,*** arsim i detyruar; 2. edukatë, edukim
eğitimci *em* edukator
eğitmek *fl* edukoj, mësoj (dikë), ushtroj (dikë)
eğlence *em* zabavitje, dëfrim, argëtim
eğlenceli *mb* zbaviteshëm
eğlendirici *mb* zbavitës, që të zbavit
eğlendirme *em* argëtim, zbavitje
eğlendirmek *fl* argëtoj (dikë)
eğlenme *em* argëtim, zbavitje
eğlenmek *fl* 1. zbavitem, dëfrehem, argëtohem; 2. *fig* vonohem (diku); 3. *fig* bëj shaka, tallem (me dikë)
eğlenti *em* argëtim, dëfrim, zbavitje
eğmek *fl* pjerrësoj; ***bardağı eğmeyin, içindeki su dökülür,*** mos e pjerrësoni gotën, do të derdhet uji
eğreti *mb* 1. i përkohëshem; 2. i papështatshëm; 3. **eğreti almak** *fl* marr hua, huaj (diçka)
eğri *mb* i shtrembër; 2. i pjerrët; 3. *em mat* hark, lakore
ehemmiyet *em* rëndësi
ehemmiyetli *mb* i rëndësishëm
ehemmiyetsiz *mb* i parëndësishëm
ehli *mb* shtëpiak
eklileştirmek *fl* zbut (një kafshë të egër)
ehliyet *em* aftësi, zotësi; ***sürücü ehlijeti,*** patentë për vozitjen (drejtimin) e automjetit
ehliyetli *mb* i aftë, i zoti; kompetent, i auturizuar për kryerjen e ndonjë detyre
ek *em* shtesë, plotësues; *gram* sufiks, shtesë
ekili *mb* i mbjellur
ekim *em* 1. tetor (muaj) 2. mbjellje; ***ekim zamanı,*** koha e mbjellave
ekinci *em* mbjellës, bujk
ekip *em* ekip, skuadër

Copyrighted material

eklem *em anat* kyç, nyje (vend bashkimi)
eklemek *fl* shtoj, plotësoj
ekme em mbjellje
ekmek 1. *em* bukë; 2. *fl* mbjell
ekmekçi *em* bukëpjekës, furrtar
ekoloji *em* ekologji
ekolojik *mb* ekologjik, që i përket ekologjisë, në lidhje me ekologjinë
ekonomi *em* ekonomi
ekonomik 1. *mb* ekonomik, që i përket ekonomisë, që është ekonomike; *ndf* ekonomikisht, kursimtarisht
ekran *em* ekran
eksen *em* bosht, ***dünya ekseni,*** boshti i tokës
ekser, enser *em* gozhdë e madhe
ekseriyet *em* shumicë, numri i madh, pjesa dërmuese
ekseriyetle *ndf* përgjithësisht, kryesisht
eksi *em* 1. *mat* shenja negative, minus (-),shenja e zbritjes; ***altı eksi iki eşittir dört,*** gjashtë minus dy barazi katër; 2. *fiz* negativ, nën zero; ***bugün sıcaklık eksi - 5° derecedir,*** sot temperatura është -5° grad nën zero
eksik *mb* i paplotë, i mangët; 2. *em* mungesë, mangësi; ***evin eksikleri çoktur,*** mangësitë e shtëpisë janë të shumta
eksiklik *em* mungesë, mangësi, defekt, e metë,
eksiksiz *mb* i plotë, pa të meta, i përsosur; *ndf* plotësisht, tërësisht
eksilme *em* pakësim, zvogëlim
eksilmek *fl* pakësohem, zvogëlohem
eksiltmek *fl* pakësoj, zvogëloj
eksper *em* ekspert
ekspres *em* ekspres (tren, aeroplan etj)
ekstra *mb* 1. shumë i mirë, i përsosur; 2. plotësues, i veçantë, i posaçëm
ekşi *em* i thartë
ekşilik *em* thartësirë
ekşimek *fl* thartohem
ekşitme *em* thartim
ekşitmek *fl* thartoj
ekvator *em gjeog* ekuator
ekvatoral *mb* ekuatorial
el *em anat* dorë; ***el çantası,*** çantë dore, ***el freni,*** fren dore; ***el kitabı,*** doracak (libër); ***el koymak,*** konfiskoj; ***ele ele tutulun,*** kapeni dorë për dore; ***el sallamak,*** jap shenjë me dorë;***el yazısı,*** shkrim dore; ***elde etmek,*** përfitoj; ***elden,*** nga dora; ***ele almak,*** marr në shqyrtim, marr parasysh; ***ele geçirmek,*** marrë në zotërim, pushtoj, përfitoj, ***ele vermek,*** tradhtoj, jap informacione kundërshtarit; ***eli açık,*** dorë çelur, dorëdhënës
el *em* huaj, jabanxhi
elastikiyet *em* elasticitet
elbette *ndf pasth* natyrisht, nënkuptohet, padyshim
elbise *em* 1. veshje, rroba; 2. fustan
elçi *em* 1. ambasador; 2. përfaqësues diplomatik; 3. profet

Copyrighted material

elçilik *em* 1. ambasadë; 2. ndërtesa e ambasadës
eldiven *em* dorezë; ***bir çift eldiven***, një palë dorezë
eldivenci *em* mjeshtër dorëzash
elebaşı *em* 1. udhëheqës (në lojë të fëmijve); 2. udhëheqës i një grupi banditësh
elek *em* sitë, shoshë
elekçi *em* sitë mbarues
elektrik *em fiz* elektricitet; *mb* në lidhje me elektricitetin; ***elektrik düğmesi***, çelës elektrik; ***elektrik kesintisi***, prerja elektrike; ***elektrik mühendisi***, inxhinieri elektrik; ***elektrik süpürgesi***, fshesa elektrike
ektrikçi *em* elektricist
elektrikleme *em* elektrizim
elektrikleme *fl* elektrizoj
elektrkilenmek *fl* elektrizohem
elektrikli *mb* elektrik/e, me elektricitet, gjendje e elektrizuar
elektroliz *em fiz* elektrolizë
elektron *em fiz* elektron
elktronik *em* elektronikë; *mb* elektronik; **elektronik cihazı**, aparat elektronik
elektroskop *em fiz* elektroskop
elektrot *em* elektrodë
eleman *em* 1. personel i një enti; 2. çdo pjesë (e ndonjë makine)
elemek *fl* 1. sit, shosh, shoshit; *sp* eliminoj, diskualifikoj
element *em kim* element
elenme *em* eliminim, diskualifikim
elenmek *fl* eliminohem, diskualifikohem
eleştiri *em* kritik (mendim në lidhje me ndonjë vepër)
eleştirmek *fl* kritikoj, jap mendim, shkruaj kritikë
eleştirmen *em* kritik (person); 2. recensent
elips *em gjeom* elipsë
eliptik *mb* eliptik, vezak
elleme *em* prekje (me dorë)
ellemek *fl* prek (me dorë)
elli *em* pesëdhjetë
ellinci *mb* i pësëdhjeti
elma *em bot* mollë
elmas *em* diamant
elti *em* kunatë
elveda ! *pasth* lamtumir! (thënie e dhimbshme gjatë ndarjes prej diçkaje që nuk do të kthehet më); ***Elveda güzel günler!*** Lamtumirë ditë të mira! ***Elveda sosyalizm!*** Lamtumirë socializëm! ***Elveda gençlik!*** Lamtumir rini - djalëri!
elverişli *mb* i volitshëm, i përshtatshëm
elverişsiz *mb* i pavolitshëm, i papërshtatshëm
emanet *em* 1. besim; ***emanet etmek***, jap në besim (në ruajtje diçka); 2. porosi e fundit
emanteçi *em* ai qe merr gjëra në dorëzim për t'i ruajtur
emaje *em* smallt
emek *em* punë, mund; ***emek vermek***, mundohem, punoj etj
emekçi *em* punëtor, punënjës
emeklemek *fl* zvarritem, tërhiqem zvarrë (fëmija)
emekli *em* pensionist, ***emekli olmak***, pensionohem

Copyrighted material

emeklilik *em* pension
emektar *em* veteran
emektaş *em* shok i punës, koleg
emel *em* dëshirë, ambicie, pikësynim
emilmek *fl* thithem
emilmiş *mb* i thithur
emin *mb* i sigurt; ***emin olmak,*** jam i sigurt
emir *em* urdhër, komandë; ***emir vermek***, jap urdhër, urdhëroj, komandoj
emirber *em* ordinancë
emirname *em* urdhëresë me shkrim
emlak *em* pasuri e patundshme
emlakçı *em* ndërmjetës (agenci) në shit-blerjen e pasunive të patundshme
emmeç *em* aspirator
emmek *fl* thith
emniyet *em* 1. siguri, sigurim; ***emniyet kemeri,*** rrip sigurimi; 2. organ sigurimi shtetëror, policia
emniyetli *mb* 1. i sigurt, i siguruar; 2. i besueshëm, i besës, besnik
emniyetsiz *mb* i pasigurt, i pasiguruar; 2. i pabesë, i pa besueshëm
emnijetsizlik *em* pasiguri, mungesë sigurie
emretmek *fl* urdhëroj, komandoj
emsal *em* 1. përngjasim; 2. shembull
emsalsız *mb* i pakrahasueshëm, i rrallë, i pashoq, i vetëm
emzirmek *fl* jap gji fëmijës
en *ndf* më; ***en az***, më pak se. . . ; ***en çok***, më tepër se. . . ; ***en geç***, më von se. . . ; ***en iyi***, më mirë se. . . ; ***en kötü***, më keq se. . . ; ***en küçük***, më i vogël ndër. . . ; ***en yüksek***, më i lartë se. . . **en** *em* gjërësi; ***yolun eni***, gjerësia e rrugës; ***kumaşın eni***, gjerësia e stofit; ***kâğıdın eni***, gjerësia e letrës
enayı *mb* naiv, i trash nga mendja, i pa të keq, që beson lehtë
enayilik *em* naivitet
endam *em* shtat
endamlı *mb* i shtathedhur, shtatmadh
ender *mb* shum i rrallë; ***böyle eli açık adam ender bulunur***, rallë gjindet njeri kaq bujar (me dorë kaq të çelur)
endişe *em* 1. shqetësim, breng, merak; **endişe etmek,** shqetësoj, merakos
endişeli *mb* i shqetësuar, i brengosur, i merakosur
endişelenmek *fl* shqetësohem, brengosem, merakosem
endişesiz *mb* i pabrengosur, i pa merakosur
enerji *em* energji
enfes *mb* i shkëlqyeshëm, shumë i bukur
enflasyon em inflacion
engebe *em gjeog* parafshirat e tokës, valë valësira e tokës, reliefi i tokës
engebeli *mb* i parrafshët, i thyer, i valëzuar (toka etj)
engel *em* pengesë; ***engel olmak,*** pengoj, ndaloj
engelleme *em* pengim
engellemek *fl* pengoj, ndaloj

Copyrighted material

engelli *em* i penguar, me pengesa
engelsiz *mb* pa pengesa
engin *mb* shumë i gjerë (pothuajse nuk i shihet fundi); ***engin deniz,*** deti i gjerë; ***engin ufuklar***, horizonte të gjëra
enginlik *em* gjerësirë, hapësirë
enişte *em* enishte, dhëndër, burri i motrës ose i hallës
enjekte etmek *fl med* injektoj
enkaz *em* rrënoja, mbeturinat e ndërtesave të shembura, gërmadhë, rrënim
enli *mb* që ka gjerësi, i gjerë
ense *em anat* zverk, ana e pasme e qafës
enser *em* gozhdë e madhe
ensiz *mb* që nuk ka gjerësi, i ngusht
enstitü *em* institut
enstrüman *em* instrument
entari *em* fustan
entelektüel *em* intelektual
enteresan *mb* interesant, tërheqës
entrika *em* intrigë
envanter *em* inventar
epey, epeyce *ndf* mjaft, mjaftueshëm, që mjafton, në një farë mase, aq sa duhet
epilasyon *em* heqja e qimeve të padëshiruara, epilasion
er *em* 1. mashkull; 2. ushtar i thjeshtë; 3. trim
er *mb* herët; ***er geç***, herët a vonë; ***er geç bu iş olacak,*** (sidoqoftë) herët a vonë kjo punë do të bëhet
erbap *mb* i zoti, i aftë, qe i vjen nga dora çdo gjë
erbaş *em usht* nënoficer
erdem *em* virtyt, mirëbërësi, etj
erdemli *mb* i virtytshëm, i ndershëm
ergen *em* 1. djalosh; 2. njeri i pa martuar, beqar
ergenli *mb* virgjëri
erek *em* qëllim
ergeç *ndf* më së fundi, herët ose vonë
ergenlik *mb* burrëzim
erik *em bot* kumbull
eril *em gram* gjinia mashkullore
erim *em* sihariq, lajmi i mirë
erime *em* shkrirje, tretje
erimek *fl* shkrihem, tretem
erimiş *mb* i shkrirë, i tretur
eritmek *fl* shkrij, tres
erişim *em* mbërritje, arritje,
erişmek *fl* mbërrij, arrij; ***yüksek bir mefkiye erişti,*** arriti në një pozitë të lartë
eriyik *em kim* tretësirë, solucion
erkân *em* epror
erkeç *em zool* cjap, mashkulli i dhisë
erkek *em* 1. mashkull; ***erkek çocuk,*** fëmijë mashkull; 2. burrë; ***köyün erkekleri askerde,*** burrat e fshatit janë në ushtri; 3. bashkëshort; 4. burrë, njeri i fjalës, njeri i besës; ***erkek arkadaş,*** shok
erkekçe *ndf* burrërisht, si burrë, trimërisht
erkeklik *em* burrëri, burrni
erken *mb* herët
erkinci *em mb* liberal
erkincilik *em* liberalizëm
erlik burrëri, trimëri
ermek *fl shiko* **erişmek**
Ermeni *em* armen

Copyrighted material

erotik *mb* erotik
erotizm *em* erotizëm
erozyon *em* erozion, gërryerje
erteleme *em* shtyrje
ertelemek *fl* shtyj, shtyj për më vonë, vonoj
ertesi *mb* vijues, pasues, i ardhshmi; **ertesi hafta,** java e ardhshme; **ertesi ay,** muaji pas kësaj
erzak *em* ushqime, rezerva ushqimeşh
esaret *em* robëri, skllavëri
esas *em* 1. themel, bazë; 2. thelb, esencë
esasen *ndf* kryesisht, në të vërtet
esasî *mb* themelor
esaslı *mb* themelor, parimor, kryesor, esencial, thelbësor
esen *mb* i shëndosh, i shëndetshëm, i gëzueshëm, pa sëmundje; ***Şen ve esen kalın!*** *pasth* mbetshi me plot gëzim e shëndosh!
esenlemek *fl* përshëndet
esenleşmek *fl* përshëndetem
esenlik *em* shëndet (të mirë) dhe kënaqësi e lumturi
eser *em* vepër; ***edebiyat eseri,*** vepër letrare; ***sanat eseri,*** vepër artistike
esin *em* 1. frymëzim; 2. erë e lehtë mëngjezi
esindirmek *fl* frymëzoj
esinlenmek *fl* frymëzohem
esinti *em* erë e lehtë
esir *em* rob, skllav; ***savaş esiri***, rob lufte; ***esir almak,*** robëroj; ***esir düşmek***, bie në robëri;
esirgemek *fl* mbroj, ruaj
eski *mb* i vjetër, i lashtë, i kohës së shkuar
eski çağ *em* periudha parahistorike
eskici *em* shitës vjetërsirash, ai që merr dhe shet sende të vjetra
eskiden *ndf* dikur, në të kaluar
eskimek *fl* vjetrohem
eskitmek *fl* vjetroj (diçka)
esme *em* fryerje
esmek *fl* fryn (era); ***rüzgâr batıdan esiyor,*** era fryn nga perëndimi
esmer *mb* zeshkan, i zeshkët
esmerleşmek *fl* zeshkësohem, nxihem në fytyrë
esmerlik *em* zeshkësi
esnaf *em* zejtar; shoqëri zejtarësh dhe tregtarëve të imta
esnek *mb* elastik
esneklik *em* elasticitet
esneme *em* gogëzimë
esnemek *fl* 1. më hapet goja, gogësoj; 2. zgjas, përkul (gomën etj)
Esperanto *em* Esperanto
espri *em* thënie zbavitëse dhe me shaka
esrarengiz *mb* misterioz, i fshehtë, sekret
esrarkeş *em* narkotik
esrarlı *mb* misterioz, i fshehtë, sekret
estetik *em* estetikë; *mb* estetik
eş *em* palë, par tner; ***güvercin eşini arıyor***, pëllumbi e kërkon partnerin (palën) e vet; 2. bashkëshort / bashkëshorte; 3. moshatar, moshanik; 4. *pop* shok/shoqe **eş anlamlı** *mb gram* sinonim; ***eş anlamlı sözcük,*** fjalë sinonimike

Copyrighted material

eşarp *em* shall, shami qafe
eşbasınç *em* izobar
eşbasınçlı *mb* izobarik
eşcinsel *mb* homoseksual
eşdeğerli *mb* ekuivalent
eşek *em zool* gomar; *fig* njeri kokëfort
eşeklik *em* gomari, gomarlëk
eşeleme *em* gërmim
eşelemek *fl* gërmoj
eşik *em* prag (i derës)
eşit *mb* i njëjtë, i barabartë
eşitlemek *fl* barazoj
eşitlenmek *fl* barazohem
eşitlik *em* barabartësi, barazi; shoqërim
eşkâl *em* formë
eşkenar *em gjeom* barabrinjës
eşkiya *em* cub, grabitës, kusar, bandit
eşleme *em* sinkronizim
eşlemek *fl* sinkronizoj
eşlik *em* shoqërim; ***eşlik etmek,*** shoqëroj
eşofman *em sp* veshje sportive e përbërë prej dy pjesëve
eşsiz *mb* 1. i papalë, pa partnerë; që nuk ka palë; ***bu güvercin eşsiz kaldı***, ky pëllumb mbeti pa palë; 2. i vetmi, që nuk ka të shoqen, që nuk mund të arrihet
eşya *em* gjë, send, plaçkë, orendi (emër i përbashkët për gjëra të lëvizshme të bëra nga njeri për nevoja të ndryshme
et *em* mish; ***et suyu,*** lëng mishi
etçil *em* mishngrënës
etek *em* 1. fund (i çarçafit, mbulesës, veshjes etj); 2. rrëzë, rrëzë (e malit)
eteklik *em* fund (veshje grash); 2. material për funde
eter *em kim* eter
etiket *em* etiket
etimoloji *em* etimologji
etken *em* faktor, që ndikon
etki *em* ndikim, influencë
etkilemek *fl* ndikoj, influencoj
etkilenmek *fl* ndikohem
etkileyici *mb* ndikues, ai (ajo) që ndikon; i ndikueshëm, përshtypjedhënës
etkili *mb* i efetkshëm, që ka sukses në punë; ndikues
etkin *mb shiko* ***etkileyici***
etkinlik *em* 1. aktivitet, veprimtari; 2. ndikueshmëri
etkisiz *mb* 1. i paefekshëm, i pafrytshëm, i padobishëm; 2. i pandikueshëm, që nuk ndikon
etli *mb* i mishtë, me mish, i bushur, i majmë, buçkan
etmek *fl* 1. bëj, veproj, kryej; 2. vlej; 3. *gram* (folje ndihmëse): bëj
etmen *em* faktor
etnik *mb* etnik
etnografya *em* etnografi
etnoloji *em* etnologji
etraf *em* 1. rrethanë, mjedis, ambient; 2. anë
etrafında *ndf* rreth, përreth, përqark
ettirgen *mb gram* faktitiv; ***ettirgen fiil,*** folje faktitive
ev *em* shtëpi, banesë; ***ev işi,*** punë shtëpiake; ***ev kadını,*** amvise; ***ev sahibi***, i zoti (pronari) i shtëpisë; ***ev sahibesi***, zonjë shtëpie

Copyrighted material

evceğiz *em* shtëpizë
evcil *mb* shtëpiak, i zbutur (për kafshët); ***evcil hayvanlar,*** kafshët shtëpiake
evcilleştirmek *fl* zbut (kafshën e egër)
evcimen *mb* i lidhur ngusht me shtëpinë, me familjen
evet *ndf* po, ashtu, gjithashtu
evgin *mb* urgjent, i ngutshëm
evlat *em* emër i përbashkët për fëmijë: bir, bijë
evlatlık *em* fëmijë e birësuar, adoptuar, përvetësuar
evlenme *em* martesë, të martuarit
evlendirmek *fl* martoj (dikë)
evlenmek *fl* martohem
evli *mb* i martuar, e martuar
evlilik *em* martesë
evrak *em* fletë letre; ***yazılı evrak***, dokument i shkruar, dëshmi e shkruar
evre *em* fazë, shkallë, stadium, periudhë
evren *em* bota (në kuptim të gjërë), gjithësi, rruzullim, kozmos; ***evrenin oluşumu,*** krijimi i gjithësisë (i botës)
evrenbilim *em* kozmologji
evrensel *mb* 1. kozmik, që është në lidhje me gjithësinë; 2. i përgjithshëm, botëror; universal
evrim *em* evolucion
evrimci *em* evokucionist
evvela *ndf* pikësëpari, para së gjithash
evvelce *ndf* dikur, që moti
evvelki *mb* i mëparshëm; **evvelki gün,** dita e më përparshme, pardje
eyalet *em* provincë, krahinë, autonomi
eyer *em* shalë (kali); ***ata eyeri kapamak,*** i vë shalën kalit
eylem *em* 1. aktivitet, veprim; 2. *gram* folje
eylemek *fl* veproj
eylemli *mb* veprues
eylül *em* shtator (muaj)
eyvah! *pasth* Vaj! Medet! Mjerë! ***Vay bana!*** Vaj për mua, i mjeri unë!
ezan *em* ezan, thirrje te myslimanët për lutje (në xhami)
ezbere *ndf* përmendsh; ***dersi ezber etmek***, e mësoj mësimin përmendsh
ezberlemek *fl* mësoj përmendësh, mbaj mend, memoroj
ezgi *em muz* melodi, këngë
ezik *mb* i shtypur, i shtrydhur, i ngjeshur, i shkelur
eziklik *em* shtypje, shtrydhje, ngjeshje, shkelje
eziyet *em* torturë, mundim, vuajtje
ezme *em* 1. shtypje, shkelje, shtrydhje, ngjeshje; që është i shtypur, ngjeshur: ***patates ezmesi,*** gjellë: patate të shtypura
ezmek *fl* 1. shtyp, shtrydh, ngjesh; 2. shkel (qerja); 3. torturoj, mundoj
Ezrail *em* Azrail, i (engjëll i vdekjes, engjëlli Perëndisë që i merr shpirtrat e njerëzve)

Copyrighted material

F

f – shkronja e shtatë e alfabetit Turk
fa *em muz* fa (notë)
faal *mb* aktiv, energjik, veprues
faaliyet *em* aktivitet, veprimtari
fabrika *em* fabrikë, ***fabrika fiyatı***, çmim fabrike
fabrikacı *em* fabrikant, pronar i fabrikës
fabrikatör *em* fabrikant, pronar i fabrikës
facia *em* fatkeqësi e madhe, katastrofë, ndodhi tragjik
facialı *mb* katastrofal, tragjik
fahişe *em* kurvë, prostitutë
fahişelik *em* kurvëri, prostitucion
fail *mb* shkaktar, veprues, kryes
faiz *em* kamatë, fajde, interes
faizli *mb* me kamatë, me interes
faizsiz *mb* pa kamatë, pa interes
fak *em* grackë, kurth
fakat *ndf* por, mirëpo, vetëmse
fakir *mb* i varfër, i vobektë; *em* varfënjak
fakirleşme *em* varfërim
fakirleşmek *fl* varfërohem
fakirleştirmek *fl* varfëroj (dikë)
fakirlik *em* varfëri, vobeksi
fakirhane *em* shtëpia (strehim) e të varfërve
faks *em* faks
fakslamak *fl* faksoj
faktör *em* faktor
fakülte *em* fakultet
fal *em* fall; parashikim i ardhmërisë
falan *em* (fjalë që zëvendëson emrin i cili nuk dëshirohet të përdoret) ***falan geldi falan gitti***, ky erdhi ky shkoi, ai erdhi ai shkoi, filani erdhi filani shkoi disa erdhën disa shkuan etj
falcı *em* falltor/e, fallxhor/e, parashiques i ardhmërisë
fani *mb* i vdekshëm, që vdes, që ka vdekje
fanila *em* 1. fanellatë, pëlhurë prej pambuku, e butë dhe me push; 2. nënkëmishë, fanellë që vishet ndër këmishë
fanilik *em* vdekshmëri
far *em* far, dritë automobili
faraş *em* lopatë plehërash, farashë
fare *em zool* mi/u
fark *em* 1. *mat* ndryshim, diferencë; 2. ndryshim; fark etmek dalloj (ndryshimin); 3. dallim
farklı *mb* 1. i ndryshëm; 2. i llojllojshëm
farklılaşma *em* diferencim, dallim
farklılaşmak *fl* diferencohem, dallohem
farklılık *em* 1. dallim, ndryshim; 2. *mat* diferencë, ndryshim

Copyrighted material

farksız *mb* i ngjashëm, i pandryshueshëm, i njëjtë, identik, që nuk ka ndryshim
Frasça *em* Persishte, Gjuha Persiane
Fas *em gjeog* Maroko (shtet)
fasıl *em* kapitull, kaptinë
fasikül *em* pjesë
fasulye *em bot* grosh, fasule
faşist *em* fashist
faşizm *em* fashizëm
fatih *mb* ngadhënjimtar
fatura *em* faturë
fayans *em* fajans, plakë qeramike
fayda *em* dobi, përfitim
faydalanma *em* shfrytëzim, përfitim
faydalanmak *fl* shfrytëzoj; kam dobi
faydalı *mb* i dobishëm, i vlerëshëm
faydasız *mb* i pa dobishëm, i pavlerëshëm, i kotë
faz *em* fazë
fazilet *em* virtyt, cilësi pozitive e karakterit të njeriut; denjësi, meritim, nderë, madhëri, dinjitet, krenari, patriotizëm etj
faziletli *mb* i virtytshëm
fazla *mb* i tepërt, i panevojshëm, i pamasë, që është jashtë çdo mase
fazlalık *em* stërmadhim, tepërsi, të kaluarit e masës
feci *mb* tragjik, i tmerrshëm
feda *em* viktimë, flijim, theror; sakrificë
fedailik *em* sakrifikim
fedakâr *mb* safrikues, vetëmohues
fedakârlık *em* sakrificë, vetëmohim
felaket *em* fatkeqësi, katastrofë, fatkeqësi natyrore
felaketli *mb* i kobshëm, katastrofal
felç *em* paralizë; ***felçe uğramak***, paralizohem; ***felçe uğratmak***, paralizoj (dikë)
felçli *mb* i paralizuar
felsefe *em* filozofi
felsefeci *em* 1. ai që merret me filozofi; 2. arsimtar i filozofisë
feminist *em* feminist
feminizm *em* feminizëm
fen *em* 1. shkencat natyrore; 2. teknik; 3. shkencë
fena *mb* 1. i keq, ***fena hava***, koha e keqe; ***fena değil***, nuk eshtë (i) keqë, mjafton; 2. i pakëndshëm; ***fena koku***, erë e pakëndshme (e keqe); 3. shumë fort; ***fena bir yağmur yağdı***, ra një shi i fortë
fenalaşmak *fl* keqësohem (nga shëndeti); keqësohet (koha, puna etj)
fenalatırmak *fl* keqësoj (dikë a diçka)
fenalık *em* keqësi
fend *em* dredhi, dinakëri, djallëzi
fener *em* fener
fennen *ndf* shkencërisht
fennî *mb* shkencor
feragat *em* të hequrit dorë nga diçka
ferah *mb* 1. i gjerë, i hapur, komod; ***ferah bir ev***, shtëpi e gjërë, shtëpi komode; 2. i bollshëm, i begatshëm; 3. gëzim, gazmend, hare, kënaqësi, qetësi shpirtërore
ferdî *mb* individual, vetjak, personal

Copyrighted material

feribot *em* anije automobilash
fermuar *em* patentë-kopsë
fert *em* individ
fertçi *mb* individual
fertçilik *em* individualizëm
feryat *em* britmë, vaj, e qarë, klithmë, piskamë **feryat etmek** bërtas, piskat
fesat *em* grindje, ngatërresë
fesatçı *mb* ngatërrestar, intrigant
feshetmek *fl* anuloj, joligjësoj; shpërndaj
festival *em* festival
fethetmek *fl* pushtoj (me luftë)
fetih *em* pushtim (me luftë); ***fetih savaşı***, luftë pushtuese
fiçı *em* fuçi, vozë; ***şarap fıçısı***, fuçi vene
fiçıcı *em* fuçimbarues
fikra *em* 1. anekdotë; 2. *(ligj)* paragraf
fındık *em bot* lajthi
fındıklık *em* lajthishte
fırça *em* furçë, brushë
fırçalamak *fl* pastroj, fshij me furçë
fırçalanmak *fl* pastrohem me furçë
fırın *em* furrë
fırıncı *em* furrtar, bukëpjekës
fırlama *em* hedhje
fırlamak *fl* hidhem (prej vendit)
fırlatmak *fl* hedh (diçka) ***taşı uzağa fırlattı***, e hodhi gurin larg
fırsat *em* rast (i volitshëm); ***fırsat bekliyor***, e pret rastin (e volitshëm); ***fırsatı kaçırdı***, e lëshoj rastin
fırsatçı *em* njeri që shfrytëzon çdo rast të volitshëm, njeri dinak, dhelprak
fırtına *em* stuhi, furtunë, shtrëngatë
fırtınalı *mb* i stuhishëm, me shtrëngatë
fısıldamak *em* pëshpëris, murmuris, flas më zë të ulët
fışkırmak *fl* rrjedh me hov, gufon, çurgon ; ***su fışkırıyor,*** uji rrjedh çurg, uji gufon
fidan *em* fidan
fidanlık *em* fidanishte
figan *em* britmë
figüran *em* figurant
fiil *em* 1. veprim; 2. *gram* folje
fikir *em* ide; 2. mendim; ***fikir edinmek,*** marr mendim
fil *em zool* elefant
file *em* 1. rrjetë; 2. torbë rrjeti
filiz *em* filiz, njomëz, lastar, pip
film *em* film
filo em *usht* flotë
filolog *em* filolog
filoloji *em* filologji
filozof *em* filozof
filtre *em* filltër, kullesë, kullosje
final *em* finale
fialist *em* finalist
finans *em* financë
finanse etmek *fl* financoj
fincan *em* filxhan
firar *em* ikje (ikje nga burgu, nga ushtria); ***firar etmek,*** dezertoj, iki nga burgu, iki nga ushtria
firavun *em* faraon
icra *em* kryerje, realizim, zbatim, ekzekutim; ***icra konseyi***, këshilli ekzekutiv; ***icra etmek***, kryej, zbatoj, realizoj; ***icraya vermek***, ngre padi, e padis (dikë)
icraat *em* shumësi i fjalës: ***icra***: aksione, veprime, punë
iç *em* brendi; ana e brenshme; ***iç çamaşırı***, ndërresa (rroba) e brendshme; ***iç hastalıkları***, sëmundje të brendshme; ***içini çekmek***, psherëtij; ***içini dökmek***, hapem (dikujt), e hap zemrën (time dikujt)
içdekorasyon *em* stoli e brendshme
içecek *em* pije
içerde *ndf* brenda
içeri *em* brendi, brenda, ana e brendshme; ***içeri almak***, marr brenda; ***içeri girmek***, hyj brenda
içerik *em* përmbajtje
içeriye *ndf* brenda
içerme *em* përfshirje
içermek *fl* përfshij, përmbaj
içgüdü *em* instikt
içgüdüsel *mb* instiktiv/e
içgüvey *em* dhëndër që qëndron ne familjen e gruas

Copyrighted material

içilir *mb* i pijshem, që pihet
için *parf* për
içinde *parf* në, brenda në. . . ; ***zaman içinde***, gjatë kohës. . .
içindekiler *em* përmbajtje (e librit)
içine *parf* brenda; ***içine almak***, marr brenda; ***içine koymak***, vë brenda
içişleri *em* punë të brendshme; ***İçişleri Bakanlığı***, Ministria e punëve të brendshme
içki *em* pije alkoolike; ***içki içmek***, pi pije alkoolike
içkili *mb* 1. i pirë, i dehur, 2. Vend ku shërbehet alkool; ***içkili lokanta***, restorant ku shërbehet alkool
içli *mb* 1. gjë që në brendinë e tij ka diçka, me brendësi, i mbushur me. . . . ; 2. i ndjeshëm; 2. i tronditshëm, që të trondit
içlilik *em* ndieshmëri
içme *em* pirje
içmek *fl* pi
iç salgı *em* sekrecion i brendshëm
iç savaş *em* lufta civile
içten *mb* i sinqertë, i çelur, i përzemërt
içtenlik *em* sinqeritet, përzemërsi
iç tüzük *em* rregullore e brendshme
içyüz *em* thelb, esencë (e diçkaje), gjendja e brendshme
idam *em* dënim me vdekje; ekzekutim i dënimit me vdekje
idare *em* 1. drejtori, kryesi, këshill drejtues; 2. drejtim, qeverisje, qeverisje, të qeverisurit, administrim, udhëheqje; 3. regjim; 4. ekonomi, kursim; ***idare etmek*** *fl* 1. qeveris, drejtoj, udhëheq; 2. kursej, veproj ekonomikisht
idareci *em* 1. drejtues, udhëheqës, organizator; 2. ekonomik, kursimtar
idareli *mb* ekonomik
idarî *mb* administrativ
idealizm *em* idealizëm
identik *em* identik, njësoj, i njëjti
iddia *em* 1. pretendim, mëtim, 2. vërtetim, pohim; **iddia etmek**, pretendoj, pohoj
iddialı *mb* 1. pretendues/e, i mëtueshëm; 2. i vetëbesueshëm
iddianame *em* akt padije
iddiasız *mb* pa pretendim; modest
ideal *em* ideal; *mb* ideal/e
idealist *em* idealist; *mb* idealist/e
idman *em* ushtrim, stërvitje (sportive); ***idman yapmak***, ushtroj, stërvit
idmancı *em* ushtrues, stërvitës
idrak *em* 1. kuptim, të kuptuarit; 2. *psik* perceptim, aftësi njohëse; 3. arrijtje (në një qëllim; ***idrak etmek***, 1. kuptoj; 2. perceptoj; 3. arrij **idrar** *em* urinë, shurrë
ifade *em* 1. shprehje, mënyrë e të shprehurit; 2. pamja (gjendja) e fytyrës; 3. deklaratë, dëshmi; ***ifade etmek*** deklaroj, shpreh
iffet *em* nder, seder,
iffetli *mb* i ndershëm, me nder
iflas *em* faliment, falimentim; ***iflas olmak*** falimentoj

Copyrighted material

iftar *em* 1. iftar, të çelurit e agjërimit; 2. koha e të çelurit të agjërimit; 3. darkë ramazani
iftihar *em* krenari, kryelartësi, mburrje; ***iftihar etmek***, krenohem, mburrem
iftira *em* shpifje; ***iftira etmek***, shpif
iftiracı *mb* shpifës
iğdiş *mb* i tredhur
iğfal *em* gënjim, ngashënjim; ***iğfal etmek***, mashtroj, ngashënjej
iğne *em* 1. gjilpërë; ***toplu iğne***, gjilpërë me krye, karficë; 2. ***pusula iğnesi***, gjilpërë magnetik (e kompasit); 2. *med* injekcion, shiringë; ***iğne yapmak***, bëj injekcion
iğneleme *em fig* tallje (me dikë)
iğnelemek *fl* 1. lidh (disa gjëra me gjilpërë); 2. shpoj me gjilpërë; 3. *fig* flas me ironi, shpoj, tallem (me dikë)
iğrenç *mb* i gërditshëm, i neveritshëm
iğrenmek *fl* neveritem, gërditem, ndjej vështirësi
ihale *em* ankand
ihanet *em* tradhti¸ ***ihanet etmek,*** tradhtoj, dorëzoj (armikut sekretet)
ihbar *em* 1. lajmërim, njoftim; 2. njohtim, lajmërim sekret (policisë); ***ihbar etmek***, 1. lajmëroj; 2. lajmëroj, njohtoj (fshehurazi)
ihlal *em* dhunim, cenim, prishje, mosrespektim ***ihlal etmek,*** dhunoj, cenoj, nuk respektoj (ligjin)
ihmal *em* mospërfillje, pakujdesi, neglizhencë, shkujdesje; ***ihmal etmek***, lë pas dore, neglizhoj, nuk përfill
ihmalcı *mb* i pakujdesshëm
ihmalcılık *em* pakujdesi, mospërfillësi, neglizhencë
ihracat *em* eksportim; ***ihracat yapmak***, eksportoj
ihracatçı *em* eksportues
ihraç *em* 1. eksportim; 2. nxjerje, përjashtim; ***partiden ihraç ettiler,*** e përjashtuan nga partija; ***okuldan ihraç ettiler***, e përjashtuan nga shkolla
ihtar *em* 1. vërejtje, qortim; 2. paralajmërim, përkujtim
ihtilal *em* revolucion
ihtilâf *em* mosmarrëveshje, mospajtim; divergjencë
ihtimal *em* mundësi, rast, gjasë, supozim
ihtisas *em* specializim, specialitet
ihtişam *em* madhështi, luks, shkëlqim, grandioz
ihtiyaç *em* nevojë, nevojë e domosdoshme
ihtiyaçlı *mb* i nevojshëm, që ka nevojë
ihtiyar *em* 1. plak/u, 2. *mb* plakë
ihtiyarlamak *fl* plakem
ihtiyarlık *em* pleqësi, mosha e plakut
ihtiyat *em* kujdes, syçeltësi, vigjilent
ikamet *em* banim, qëndrim; **ikamet etmek**, banoj, qëndroj
ikametgâh *em* vendbanim, banesë
ikaz *em* vërejtje, qortim; paralajmërim, përkujtim; ***ikaz etmek*** qortoj; përkujtoj

Copyrighted material

ikbal *em* fat
iken *lidh* duke, ndërsa, derisa, gjersa, deri kur (përdoret si prapashtesë)
iki *em* dy; ***iki kat***, dy fish; ***iki kere***, dy herë
ikicili *mb* dualist
ikicilik *em* dualizëm
ikileme *em* dyfishim
ikilemek *fl* dyfishoj
ikinci *mb* i dyti
ikindi *em* ikindi, koha e lutjes së trete të ditës te myslimanët
ikişer ikişer *ndf* dy nga dy
iki yanlı *mb* dyanësh
ikiyaşayışlı *em* amfibie
iki yüzlü *mb* i dyfytyrshëm, hipokrit
ikiz *em mb* binjak; binjak/e
iklim *em* klimë
ikmal *em* 1. kryerje, mbarim; 2. plotësim; shtesë; . furnizim; 4. *usht* forcim; shërbim furnizimi ushtarak; ***ikmal imtihanı*** riprovim; ***ikmal yapmak***, furnizoj (anijen, avionin me materiale të nevojshme)
ikna *em* bindje; ***ikna etmek***, bind (dikë), e mbush mendjen (dikujt)
ikram *em* 1. pritje dhe gostitje e mysafirëve, gostitje, qerasje; 2. *pop* ulje (e çmimit, rrabat); ***ikram etmek***, gostit; e ul çmimin, jap rabat
ikramiye *em* 1. shpërblim (përveç rrogës); 2. fitim në lotari
iktidar *em* 1. fuqi, forcë; 2. pushtet, sundim politik, qeverisje; ***iktidar partisi***, partija që eshtë në pushtet; 3. potencë, aftësi seksuale te mashkujt
iktidarsızlık *em* 1. dobësi, pamundësi, mungesë fuqie; 2. impotencë, paaftësi seksuale (te meshkujt)
iktisadi *mb* ekonomik, që i përket ekonomisë
iktisat *em* 1. ekonomi; 2. kursimtari
iktisatçı *em* ekonomist
il *em* krahinë administrative (prefekturë) në Turqi
ilaç *em* ilaç
ilaçlı *mb* dezinfektues
ilahî *mb* hyjnor, i hyjnueshëm
ilahiyat *em* teologji; ***ilahiyat fakultesi***, fakultet i teologjisë
ilan *em* shpallje, lajmërim, prokllamatë; ***ilan etmek***, shpall, lajmëroj, proklamoj
ilave *em* shtesë; pjesë e shtuar; ***ilave etmek***, shtoj, bashkangjit
ilçe *em* zonë adminstrative (nënprefekturë) në Turqi
ile 1. *parf* me; ***Orhan ile***, me Orhanin; ***otobüs ile***, me autobus; ***ile beraber***, bashk me; 1. *lidhz* dhe, edhe; ***elma ile armut***, molla dhe dardha
ilelebet *ndf* përjetë, përgjithmonë
ileri 1. *em* përpara; *mb* i përparshëm, i përparmi; 2. *pasth* Përpara! ***İlk hedefimiz Akdeniz'dir, ileri!*** (***Atatürk***), Qëllimi ynë i parë është Deti Mesdhe, përpara! (Ataturku); ***ileri görüşlü***, me ide përparimtare,

Copyrighted material

progresive; ***ileri gitmek***, shkon përpara (ora etj.)
ilerici mb përparimtar
ilericilik em përparimtari
ilerleme em përparim
ilerlemek *fl* 1. eci, lëviz (përpara); 2. përparoj, zhvillohem; 3. kalon (koha)
iletişim *em* marrëdhënie, komunikim, lidhje
iletken *em* përçues; ***elektrik akımı iletkeni***, përçues i rrymës elektrike
iletmek *fl* 1. bart, çoj, përcjell, transmetoj; 2. *fiz elektr* përçoj
ilgi *em* l. lidhje, marrëdhënie, ***ilgisi olmak***, kam lidhje; 2. konsideratë, të marrun parasysh, kujdes, përflille, interesim; ***ilgi göstermek***, interesohem
ilgilendirmek *fl* e interesoj (dikë), bëj që të interesohet (dikë për diçka), nxis, nxit
ilgilenmek *fl* interesohem (përkujdesem për. . .), kushtoj kujdes (për. . .)
ilgili *mb* i interesuar, interesant/e
ilginç *mb* interesant/e, tërheqës/e
ilgisiz *mb* indiferent/e, i painteresuar
ilgisizlik *em* mosinteresim, të qenurit i painteresuar
ilham *em* frymëzim, inspirim
ilik *em* 1. palcë (e ashtit); 2. syth, vrimë për kopsë
iliklemek *fl* kopsit, mbërthej kopsën
ilim *em* shkencë
ilişik *mb* 1. i ngjitur, i bashkangjitur; 2. në lidhje me. . . .
ilişkin *mb* në lidhje me. . . .
ilişmek *fl* 1. prek (me dorë lehtazi); 2. ngacmoj, shqetësoj; përzihem, intervenoj; 3. *fig* përmend, bëj fjalë për diçka
iliştirmek *fl* (disa gjëra) ngjit, bashkangjit, lidh
ilk *mb* i pari, e para; ***ilk defa***, për të parën herë; ***ilk önce***, pikësëpari; ***ilk yardım***, ndihmë e parë
ilkbahar *em* pranverë (stinë)
ilke *em* parim, princip
ilkel *mb* 1. primitiv, elementar, i pazhvilluar; 2. *fig* i pashkolluar, i paarsimuar, i pakulturë, i papërvojë
ilkin *mb* në fillim, pikësëpari
ilkokull *em* shkolla fillore (deri në klasën e pestë)
ilköğretim *em* arsim themelor, arsim i parë
ilk yardım *em* ndihmë e parë
ilmî *mb* shkencor/e
ilmik *em* nyje, nyje e lirë
iltica *em* strehim, azil; ***iltica etmek***, strehoj (në vend të sigurt)
iltifat *em* kompliment, lajkatim, përkëdhelje; ***iltifat etmek*** bëj kompliment, lajkatoj, përkëdhel
iltihap *em med* inflamacion, pezmatim, përflakë
iltihaplanmak *fl* përflakem, infektohem, qelbëzohem (plaga)
ima *em* aluzion, paralajmërim indirekt; ***ima etmek*** paralajmëroj, jap në dijeni, aludoj

Copyrighted material

imaj *em* imagjinatë, përfytyrim, ëndërrim, fantezi; imixh
imal *em* prodhim, fabrikim, përpunim; ***imal etmek***, prodhoj, përpumoj
imalat *em* shumësi i fjalës: **imal**, prodhime
imalatçı *em* prodhues, fabrikant
imam *em* imam, njeri fetar te muslimanët që udhëheq faljen në xhami; 2. titulli i trashëgimtarëve - zëvendësve të Profetit
iman *em* iman, besim fetar, besimi i fesë islame
imar *em* ndërtim, ndërtimtari
imdat *em* ndihmë, ndihmë që jipet njeriut që është në rrezik; ***İmdat***! *pasth* Ndihmë!
imha *em* asgjësim, prishje e plot, shfarim, zhdukje; ***imha etmek***, asgjësoj, zhduk, shfaros, prish plotësisht
imkân *em* mundësi, rast i volitshëm
imkânsız *mb* i pamundur, që s'ka mundësi, i parealizueshëm
imkânsızlık *em* pamundësi
imla *em gram* drejtshkrim, ortografi
imperator *em* perandor
imepartoriçe *em* perandoreshë
imperatorluk *em* perandori
imrenmek *fl* 1. dëshiroj fort (diçka a dikë); mallëngjehem për diçka; 2. lakmoj, kam zili
imtihan *em* provim; ***imtihan etmek***, pyes (dikë) në provim; ***imtihana çıkmak*** dal në provim; ***imtihan olmak***, jap provim
imtiyaz *em* privilegji, përparësi, prioritet
imtiyazlı *mb* i privilegjuar
imza *em* nënshkrim
imzalamak *fl* nënshkruaj, firmos (firmoj) (një dokument)
in 1. gropë, zgavër, 2. shpellë
inanç *em* 1. besim, fe, religjion; 2. besim, të besuarit
inançlı *mb* ai që beson në fe, fetar/e
inançsız *mb* i pafe, i pabesë, ateist
inandırmak *fl* bind (dikë), i mbush mendjen dikujt
inanmak *fl* besoj (dikujt)
inat *em* inat, kokëfortësi; ***inat etmek***, inatosem, veproj me kokëfortësi, veproj me këmbëngulje, këmbëngul
inadına *ndf* për inat
inatçı *mb* inatçi, kokëfort/e, këmbëngulës/e, kryeneç/e
inatçılık *em* inatosje
ince *mb* i hollë; 2. i imët; ***ince kum***, rërë e imët; 2. i lehte (për veshje); ***ince elbise***, veshje e lehtë; 3. i rallë (për lëngje); 4. i naltë (shtati i njeriut)
inceleme *em* shqyrtim, hulumtim, hetim
incelemek *fl* shqyrtoj, studioj, analizoj
incelik *em* 1. hollësi, imtësi; 2. elegancë, stërhollim; 3. detaj
inceltmek *fl* 1. hollësoj; 2. hollësoj (lëngun), lëngësoj; 3. dobësoj (shtatin)
inci *em* perlë, inxhi, margaritar
incil *em* ungjill, dhiatë
incinmek *fl* 1. lëndohem; 2. ofendohem, fyem

Copyrighted material

incir *em bot* fik/u
incitici *mb* 1. lëndues; 2. fyes,
incitme *em* 1. lëndim; 2. ofendim, fyerje
incitmek *fl* 1. lëndoj (dikë); 2. ofendoj, fyej (dikë)
indeks *em* indeks
indirim *em* zbritje, ulje (e çmimit)
indirme *em* shkarkim, zbritje
indirmek *fl* 1. zbres (dikë nga qerrja etj); shkarkoj; 2. ul (çmimin); 3. lëshoj, e ul (poshtë)
inek *em zool* 1. lopë; 2. *fig* budallë, kokëtrash
infaz *em* zbatim, kryerje, ekzekutim
infilak *em* eksplodim, shpërthim; ***infilak etmek***, eksplodoj
İngiliz *em* Anglez/e; *mb* i Anglisë, që i takon Anglisë; ***İngiliz politikası***, politika Angleze
İngilizce *em* anglishte, gjuha Angleze
İngiltere *em gjeog* Angli
inisiyatif *em* iniciativë, hapi i parë në një punë
iniş *em* 1. zbritje, të zbriturit; 2. teposhtë, tatëpjetë
inkilâp *em* revolucion
inkilâpçı *mb* revolucionar
inkâr *em* mohim; ***inkâr etmek***, mohoj (nuk pranoj diçka të thënë më parë)
inleme *em* rënkim
inlemek *fl* 1. rënkoj; 2. gjëmoj
inmek *fl* 1. zbres (prej një vendi më të lartë); 2. ul (çmimin)
insaf *em* njerëzi; sjellje fisnike
insaf *em* drejtësi e bazuar në sjellje njerëzore, sjellje fisnike, ndërgjegje
insaf! *pasth* Mëshirë! Kij pak mëshirë!
insafsız *mb* i pamëshirshëm, çnjerëzor/e, pa ndërgjegje
insafsızca *ndf* mizorisht, jonjerëzisht
insafsızlık *em* pamëshirshmëri, mizori, çnjerëzori
insan *em* njeri
insanlık *em* 1. njerëzim; 2. njerëzi, humanitet, shpirtmirësi
inşa *em* ndërtim; ***köprü inşası***, ndërtim i urës; ***inşa etmek***, ndërtoj (mur, shtëpi, rrugë etj)
inşaat *em* 1. ndërtesë; 2. ndërtimtari, punëra ndërtimtarije; ***inşaat mühendisi***, inxhinier ndërtimtarije
inşallah! *pasth* 1. Dashtë perëndia! Nëse don perendia;
internet *em* internet
intiba *em* përshtypje, mbresë
intihal *em* plagiat, vjedhje letrare
intihar *em* vetëvrasje; ***intihar etmek***, bëj vetëvrasje
intikam *em* hakmarrje; ***intikam almak***, hakmerrem, ahmerrem
ip *em* 1. pe; 2. litar; 3. *fig* dënim i vdekjes me varrje
ipek *em* mëndafsh; *mb* i mëndafshtë; ***ipek böceği***, krimbi i mëndafshit
ipekli *mb* i mëndashtë, i bërë me mëndafsh
iplik *em* 1. pe; 2. fije; ***yün ipliği***, fije leshi
ipotek *em* hipotekë, peng

Copyrighted material

iptal *em* anulim, zhvleftësim, shfuqizim, abrogim; ***iptal etmek***, anuloj, shfuqizoj, abrogoj
ipucu *em* shenjë, shenjë dallues, paralajmërim, njoftim
irade *em* vullnet, dëshirë; e drejta për të sjell vendim
iradeli *mb* i vullnetshëm
iradesiz mb i pavullnetshëm
İran *em gjeog* Iran, Persi
İranlı *mb* Iranian, Persian
iri *mb* shumë i madh e i trash, kolosal, vigan
irilik *em* madhësi, trashësi
irin *em med* qelb (i plagës); ***irin toplamak*** qelbësohem (plaga)
iriyarı *mb* i madh, me trup të madh
irkilmek *fl* trishtohem, frikohem, dridhem, hutohem, tërhiqem, mblidhem (nga një ndodhi e pa pritur)
irkiltmek *fl* trishtoj (dikë)
İrlanda *em gjeog* Irlandë
İrlandalı *em* Irlandez
irsî *mb* trashëgues; ***irsi hastalık***, sëmundje trashëguese
irtibat *em* lidhje, kontakt; ***irtibat kurmak***, jam në lidhje, bëj lidhje (me dikë)
irtica *em* reaksion, kundërveprim
is *em* blozë
İsa *em* Isa,-i (profet), Jezu Krishti
isabet *em* goditje, të goditurit, të qëlluarit; ***isabet etmek***, godis, qëlloj
isabetli *mb* 1. përshtatshëm, që është me vend, si duhet; 2. ekzakt, i përpiktë, pa gabim, preciz
ise *lidhz* nëse, në qoftë se, ndërsa; ***o konuşur ise***, nëse ai flet; ***ben gazete okuyorum o ise gitar çalıyor***, unë lexoj gazetë ndërsa ai i bie gitarës
İsevî *em* krishterë
İsevilik *em* krishterim
ishal *em med* diarre, të qiturit bark
isim *em* emer, titull; *gram* emër
isimsiz *mb* i paemër, anonim/e
iskambil kâğıdı *em* leter loje, letër kumari (bixhozi)
iskele *em* 1. liman (për anije); 2. skele (në ndërtimtari)
iskelet *em med* skelet/i
iskemle *em* 1. karrige; 2. karrige pa mbështetse; 3. tryezë e vogël; ***iskemle kavgası***, grindje për kolltuk (për karrige)
İslam *em* İslam
İspanya *em gjeog* Spanjë
İspanyalı *em* spanjoll
İspanjolca *em* spanjisht, gjuha spanjolle
ispat *em* dëshmi, argument; ***ispat etmek***, argumentoj
ispatlamak *fl* argumentoj, dëshmoj
ispirto *em kim* shpirto
israf *em* shpenzim i panevojshëm dhe i tepruar, plëngprishje; ***israf etmek***, shpenzoj pa hesap (kot)
istasyon *em* stacion
istatistik *em* statistikë; *mb* statistik; ***istatistik verileri***, të dhënat statistike
istavrit *em zool* një lloj peshku *(Trachurus trachu rus)*

Copyrighted material

istek *em* kërkesë, dashje, dëshirë
istekli *mb* i dëshiruar, me dashje, i gatshëm për. . . . . ;
isteksiz *mb* i pa dëshirueshëm, pa vullnet, pa dashje
istemek *fl* kërkoj, dëshiroj
istif *em* stivë, turrë, renditje; ***istif etmek***, rendis (grumbulloj) stivë mbi stivë
istifa *em* dorëheqje (nga detyra, nga puna etj); ***istifa etmek***, jap dorëheqje, heq dorë
istifade *em* shfrytëzim, dobi, përfitim; ***istifade etmek***, shfrytëzoj
istihkâm *em* fortifikim, fortifikatë
istikbal *em* ardhmëri
istiklâl *em* pavaresi
istikrar *em* stabilizim
istilâ *em* 1. invadim, pushtim, okupim; 2. përhapje, zgjerim; ***istilâ etmek***, 1. invadoj, pushtoj; 2. përhapem, zgjerohem
istilâcı *em mb* invadues, okupator, okupues
istimlâk em shpronësim; ***istimlâk etmek***, shpronësoj
istirahat *em* pushim, prehje, çlodhje; ***istirahat etmek***, pushoj, çlodhem
istiridje *em zool* guaskë deti, gocë deti (*Ostrea bolulis*)
istismar *em* shfrytëzim; istismar etmek, shfrytëzoj
istisna *em* veçanti, veçori, përjashtim; ***istaisna etmek***, veçoj, përjashtoj, nuk marr parasysh
istisnasız *mb* i pa veçori, pa përjashtim
isyan *em* kryengritje; ***isyan etmek***, ngre (masën në) kryengritje
isyancı *em* kryengritës
iş *em* punë, veprim; ***iş vermek***, jap (dikujt) punë; ***işe girmek***, hyj në punë, punësohem; ***işe yaramaz***, nuk është i volitshëm për punë; ***işler nasıl gidiyor***, si shkojnë punët
iş adamı *em* biznesmen, burrë pune, afarist
işaret *em* shenjë, tregues, gjurmë, nishan, sinjal; shprehje me gjeste; ***işaret etmek***: 1. shënoj, i vë shenjën; 2. tregoj, shpreh (me gjeste)
işaretlemek *fl* shënoj, i vë shenjën
işaret parmağı *em anat* gishti tregues
işbirliği *em* bashkëpunim; ***işbirliği yapmak***, bashkëpunoj
işçi *eç* punëtor/e
işçilik *em* 1. mënyra e veprimit, mënyra e të punuarit, shkathtësi; 2. pagesë (rrogë, mëditje), shpërblim që pagohet për punën e kryer
işemek *fl* bëj shurrën, bëj ujin e vogël
işgal *em* pushtim, okupim; ***işgal etmek***, pushtoj, okupoj
iş günü *em* 1. ditë pune; 2. mëditje
işgüzar *mb* i aftë, i shkathtë, i zhdërvjelltë
işitmek *fl* dëgjoj, marrvesh
iş kadını *em* biznesmene, grua e punës, afariste
işkembe *em anat* pllancë

Copyrighted material

işkence *em* torturë, mundim; ***iskence yapmak***, torturoj, mundoj
işkenceci *mb* torturues
işlek *mb* 1. që është shumë punues, i levizëshëm, i dendur, intensiv; ***çok işlek yol***, rrugë me komunikacion te dendur, me komunikacion intensiv
işlem *em* 1. veprim, punë, proces, akcion; 2. *mat* veprim (katër veprime kryesore të matematikës)
işlemek *fl* punoj, veproj
işletme *em* 1. organizatë pune, sipërrmarje, ndërmarrje, institucion, ent, stabiliment; 2. drejtori, kryesi, udhëheqësi në punë, ; të organizuarit e punës
işletmeci *em* drejtor, udhëheqës i punës, organizator i punës në sipërmarrje, punëdrejtues
işletmek *fl* 1. organizoj punën në sipërmarrje, ent etj. 2. vë në lëvizje (në punë) një makinë
işlev *em* 1. funksion; 2. shkathtësi (aftësi) pune
işlevsel *mb* funksional
işportacı *em* shitës i lëvizshëm (në rrugë), shitës ambulant
işsiz *mb* i papunë, që nuk mund të gjejë punë, që s'gjen punë
işsizlik *em* papunësi; ***işsizlik sigortası***, sigurim papunësie
iştah *em* apetit, ëndje, oreks; *fig* dëshirë
iştahlı *mb* me apetit, me oreks
iştahsız *mb* 1. pa apetit, pa oreks; 2. *fig* pa dëshirë (për punë)
işte *lidhz* ja, qe; ***işte paralar buradadır***, ja parat janë këtu
iştirak *em* 1. shoqatë, shoqërim, ndërmarrje; 2. pjesëmarrje; ***iştirak etmek***, marr pjesë
işveren *em* punëdhënës, padron, pronar (i sipërmarrjes)
iş yeri *em* vend pune
it *em zool* qen
itaat *em* dëgjesë, bindje, dëgjueshmëri, përkulshmëri; ***itaat etmek*** dëgjoj, përulem
itaatlı *mb* i dëgjueshëm, i bindshëm, i përkulshëm; i përulur
itaatsız *mb* i padëgjueshëm, i pabindur
itaatsızlık *em* pandëgjesë, pandëgjueshmëri, papërkulshmëri
italik *em* kursiv (lloj shkronje shtypi)
İtalya *em gjeog* Itali
İtalyan *em* Italian; *mb* italiane; ***İtalyan müziği***, muzikë italiane
İtalaynca *em* italisht, gjuha italiane
itfaiye *em* skuadër zjarrfikësi, shërbim zjarrfikësi; ***itfaiye arabası***, makinë zjarrfikësi
itfaiyeci *em* zjarrfikës
ithal *em* importim; ***ithal etmek***, importoj; ***ithal mal***, mall i importuar
ithalat *em* (shumsi i fjalës: ***ithal***); importim, mallra të importuara
ithalatçı *em* importues
itham *em* akuzë
ithamname *em* aktakuzë
itibar *em* nderë, nderim, respekt, fam, nam, prestigj, autoritet

Copyrighted material

itibarlı *mb* i nderuar, që gëzon nderë, i ndershëm, i çmuar, i respektuar, autoritativ
itici *mb* 1. shtyrës, nxitës, ai që shtyn, shtytës; 2. *fig* i ftohtë, i gërditshëm, i neveritshëm, antipatik, i padëshirueshëm
itimat *em* besim, besë; ***itimat etmek***, besoj (dikujt)
itina *em* kujdes, vëmendje; ***itina etmek***, kujdesem, përpiqem, mundohem
itiraf *em* pohim, pranim si të vërtet, njohje; ***itiraf etmek***, pohoj, pranoj si të vërtet, e njoh
itiraz *em* kundërshtim, ankesë; ***itiraz etmek***, kundërshtoj, ankohem, protestoj
itme *em* shtyrje
itmek *fl* shtyj
ittifak *em* 1. aleancë, bashkim, lidhje, marrëveshje; pajtueshmëri; 2. njëzërësi, njëmendësi, unanimitet
ivedili *mb* urgjent, i ngutshëm
ivedilikle *ndf* ngutësisht, shpejtësisht
ivme *em fiz* nxitim
iye *em* posdues
iyi *mb* 1. i mirë, 2. është si duhet të jetë; 3. i shëndosh; ***iyi akşamlar***, mirëmbrëma; ***iyi kalplı***, shpirtmirë; ***iyi niyetli***, me qëllim të mirë; ***iyi olmak***, përmirësohem (shëndetërisht)
iyileşme *em* përmirësim, shërim
iyileşmek *fl* përmirësohem, shërohem
iyileştirmek *fl med* shëroj, përmirësoj
iyilik *em* mirësi; ***iyilik etmek***, bëj mirësi
iyilikbilir *mb* mirënjohës, që ta di e ta njoh të mirën që i ke bërë
iyimser *em* optimist
iyimserlik *em* optimizëm
iyot *em kim* jod
iz *em* 1. gjurmë, shenjë; 2. mbeturinë (e një gjëje)
izci *em* gjurmues
izah *em* sqarim, shpjegim; **izah etmek**, sqaroj, shpjegoj, komentoj
izdiham *em* turmë, shumicë njerëzish
izdüşüm *em* projektim
izin *em* leje, lejim; ***izin almak***, marr leje; ***izin vermek***, lejoj
izinli *mb* 1. i lejuar, që ka marr leje; 2. që është në pushim (vjetor, javor, i sëmurë etj)
izleme *em* ndjekje, të shkuarit pas
izlemek *fl* 1. ndjek, shkoj pas, shoqëroj; 2. vërej, vëzhgoj
izlenim *em* përshtypje, mbresë
izleyici *em* 1. ndjekës, shoqërues, përcjellës; 2. vëzhgues, vërejtes
izmarit *em* 1. lloj peshku (*Maena smaris*); 2. bisht cigareje (mbeturina e cigares)
izolasyon *em* izolim
izole *mb* 1. i izoluar; 2. i veçuar; 3. izolues/e; ***izole band***, sherit izolues; 3. *fig* ***izole etmek***, veçoj, e lë vet, ndaj

Copyrighted material

I

ı – shkronja e njëmbëdhjetë e alfabetit Turk
ığrıp *em* një lloj rrjete e madhe peshkatari
ığıl *em* ujë që rrjedh shumë ngadalë
ığıl ığıl *ndaf* ngadalë ngadalë, rëndë rëndë
ıhlamur *em bot* bli; ***ıhlamur çayı***, çaj bliri
ıkınmak *fl* mbaj frymën
ıkıntı *em* rënkim
ılgım *em fiz* fatamorganë, vegim
ılık *mb* i vakët, vokët; ***ılık su,*** ujë i vakët (i vokët)
ılımlı *mb* i përmbajtur, i arsyeshëm, i matur, modest
ımızgamak *fl* dremit
ımızganma *em* dremitje
ıra *em* karakter
ırak *mb* i largët
ıraklama *em* largim
ıraklamak *fl* largoj
ıraklaşmak *fl* largohem
ıraklık *em* largësi, distancë
ırgat *em* punëtor krahu që punon me mëditje, argat
ırk *em* 1. racë; ***beyaz ırk***, raca e bardhë; ***ırk ayrılığı***, diskriminacion racor; 2. prejardhje, origjinë
ırkçı *em* racistë; *mb* racist/e
ırkçılık *em* racizëm
ırki *mb* racial
ırmak *em* lum
ırz *em* nder; ***ırza geçmek***, çnderoj
ırzlı *mb* i ndershëm, me nderë
ısı *em* nxehtësi, ngrohtësi; ***ısıya dayanıklı*** i durueshëm ndaj nxehtësisë
ısınma *em* ngrohje, nxehje
ısınmak *fl* ngrohem, nxehem
ısı ölçer *em fiz* kalorimetër
ısırık *em* kafshim
ısırılmak *fl* kafshohem
ısırgan *em bot* hithër
ısırmak *fl* kafshoj
ısıtma *em* ngrohje, nxehje
ısıtmak *fl* ngroh, nxeh
ıskonto *em* skonto, zbritje, rabat
ıslah *em* përmirësim; ***ıslah etmek,*** përmirësoj
ıslahat *em* përmirësim, reformë
ıslahatçı *em* reformist
ıslak *mb* i lagët
ıslaklık *em* lagështirë, lagësirë
ıslanmak *fl* lagem, ligështohem
ıslatmak *fl* lag, lagështoj, ujis (ujit)
ıslık *em* fëshkëllim; ***ıslık çalmak,*** fëshkëlloj
ısmarlama *em* porosi, kërkesë e një malli

Copyrighted material

ısmarlamak *fl* porosis (porosit) (ndonjë mall)
ıspanak *em bot* spinaq
ısrar *em* këmbëngulje, insistim; ***ısrar etmek***, insistoj
ısrarlı *mb* insistues, këmbëngulës
ıssız *mb* shkretë, i pabanuar; ***ıssız sokak***, rrugë e zbrazët
ıssızlık *em* shkreti, shkretëtirë, vetmi
ıstakoz *em zool* gaforre
ıstavroz, istavroz *em* kryq
ıstırap *em* vuajtje, pikëllim, hidhërim; **ıstırap çekmek**, vuaj
ıstıraplı *mb* i vuajtur, i pikëlluar, i hidhëruar
ıstırapsız *mb* pa vuajtje, i pa brengosur
ışık *em* dritë
ışıklama *em* ndriçim
ışıklamak *fl* ndriçoj
ışıklı *mb* i ndriçuar, i ndritshëm
ışık ölçer *em fiz* fotometër
ışıksız *mb* i pandritshëm, i errët
ışıldak *em* 1. trup që jep dritë; 2. projektor
ışıldamak *fl* shndris, xixëlloj, jap dritë dridhëse
ışıma *em* rrezatim
ışımak *fl* rrezatoj, qes rreze
ışın *em* rreze; ***güneş ışını***, rreze dielli; r***öntgen ışınları***, rrezet e rëntgenit
ışınım *em* radiacion, rrezatim
ışınlandırma *em* rrezatim (diçkaje)
ışınlandırmak *fl* rrezatoj (diçka)
ışınmak *fl* rrezatoj
ıvır zıvır *em* gjëra te vogla, të imta e të pavlershme; imtësi
ızgara *em* skarë

Copyrighted material

J

j -shkronja e trembëdhjetë e alfabetit turk
jaguar *em zool* jaguar
jaluzi *em* zhaluzi, grilat e dritareve
jambon *em* proshutë, përzhutë
jandarma *em* 1. xhandar; 2. xhandarmëri
jandarmalık *em* detyra e xhandarit
jant *em oto* gavjell/i
Japon *em* 1. Japonez/e;
Japonca *em* japonisht, gjuha japoneze
Japonya *em* Japan
japon gülü *em bot* kamili (*Camellia japonica*)
jarse *em tekst* zharse
jartiyer *em* kordhelë - lidhëse për çorapë
jelâtin *em* xhelatinë
jelatinlemek *fl* xhelatinoj
jelatinli *mb* me xhelatinë
jeneratör *em* gjenerator
jenosit *em* gjenocid
jeodezi *em* gjeodezi
jeofizk *em* gjeofizik
jeofizikçi *em* gjeofizikant
jeolog *em* gjeolog
jeoloji *em* gjeologji
jeolojik *mb* gjeologjik
jeosantrizm *em* gjeocentrizëm
jest *em* gjest
jet ose **jet uçağı** *em* avion reaktiv
jeton *em* zheton, pullë telefoni
jigolo *em* gjigolo
jilet *em* zhilet, brisk rroje
jimnastik *em sp* gjimnastikë
jimnastikçi *em sp* 1. gjimnast/e, ai/ajo që merret me gjimnastikë; 2. arsimtar gjimnastike
jinekolog *em* gjinekolog
jinekoloji *em* gjinekologji
jip *em oto* xhip
jiroskop *em* xhiroskop
joker *em* shakaxhi
jokey *em* xhokej, vrapues në kal
judo *em sp* xhudo
jübile *em* përvjetor, jubile
Jüpiter *em astr* Jupiter
jüri *em* juri; ***jüri komisyonu,*** komisioni i jurisë

Copyrighted material

K

k -shkronja e katërmbëdhjetë e alfabetit Turk
kaba *mb* 1. i vrazhdë, i ashpër, i pagdhendur, i papëpunuar; 2. brutal/e, vulgar/e, jo i edukuar; 3. i madh, i trashë, 4. i përafërt, ***kaba hesap,*** llogari e përafërt
kabadayı *em* 1. përdhunues, shtypës, mizor; 2. lëvdimtar, ai që lëvdohet tepër; 3. guximtar
kabahat *em* gabim, faj
kabahatlı *mb* i fajshëm, fajtor
kabahatlılık *em* fajësi
kabahatsiz *mb* i pafajshëm
kabak *em bot* kungull
kaba kulak *em med* shytat, zhushka
kabalık *em* vrazhdësi, ashpërsi, trashësi, brutalitet
kabarcık *em* 1. fluskë, mëshikë; tumullaci i sapunit; 2. *med* puçërr, puçërzë
kabarık *mb* i fryrë, i mufatur, i ënjtur, i bymuar, i gufuar
kabarma *em* fryerje, ënjtje, bymim, gufim
kabarmak *fl* fryhem, ënjtem, bymehem, gufohem; shtohet, rritet, çohet (lumi, uji, brumi)
kabartmak *fl* fryj, bymej, rris, gufoj
kabataslak *ndf* përafërsisht, afro
kabız, kabızlık *em med* kapsllık, shtërzim barku
kabile *em* fis, gjak; familje
kabiliyet *em* aftësi, zotësi
kabiliyetli *mb* i aftë, i zoti, e zonja
kabiliyetsiz *mb* i paaftë, i pazoti, e pazonja
kabiliyetsizlik *em* paaftësi, pazotësi
kabin *em* 1. kabinë, kthinë e vogël, ***telefon kabini***, kabinë telefonike; 2. dhomë e vogël zhveshjeje në plazh
kabine *em* kabinet, këshilli i ministrave, qeveri
kabir *em* varr, varr
kablo *em* kabllo, përçues elektrik
kablolu televizyon *em* televizion me kabllo
kabristan *em* varreza, varreza
kabuk *em* lëvor, lëvozhgë
kabul *em* 1. pranim; 2. miratim, pajtim; ***kabul etmek,*** 1. pranoj, 2. miratoj, pajtohem
kaburga *em anat* 1. shporta e krahërorit; 2. *anat* bri, brinjë
kâbus *em* ankth, makth, morë, tmerr nate, ëndër i tmerrëshëm
kaç *ndf* sa? ***Kaç para?*** Sa pare? ***Kaç kilo?*** Sa kilogram?
kaça? *mb* sa vlen? (për çmime)
kaçak *em* 1. i ikur, i arratisur; ***asker kaçağı***, dezertues; ***kaçak inşaat***, ndërtim joligjor; ***kaçak***

Copyrighted material

mal, mall kontrabandisti; 2. rrjedhje (uji, gazi); ***bu boruda kaçak gaz var***, nga ky gyp rrjedh (del) gazi
kaçakçı *em* kontrabandist
kaçakçılık *em* 1. kontrabandë, tregti joligjor; ***kaçakçılık yapmak,*** bëj tregti joligjor; 2. dezertim
kaçık *mb* 1. i shtrembëruar, i mënjanuar; 2. *fig* anormal, i marrë
kaçıklık *em* marrëzi
kaçıncı *mb* e sata (me radhë), ***kaçıncı katta oturuyorsunuz?*** Në satin kat (në cilin kat) banoni?
kaçınmak *fl* shmangem, ruhem, largohem, ik (nga detyra, nga belaja, nga takimi me dikë)
kaçırmak *fl* 1. rrëmbej, ***suçluyu kaçırdılar***, fajtorin e rrëmbyen; 2. mundësoj dikë të ikë (nga burgu etj.) 3. lëshoj,vonohem; ***treni kaçırdım,*** treni më iku; ***fırsatı kaçırdım,*** e lëshova rastin; 4. *fig* marrëzohem, hutohem; 5. dështoj, nuk qëlloj
kaçış *em* ikje
kaçma *em* ikje
kaçmak *fl* iki
kadastro *em* kadastër
kadar *ndf* aq sa; ***deniz kadar engin***, i gjerë sa deti; ***öküz kadar büyük***, i madh sa kau; ***o senin kadar çalışkandır***, ai është i zellshëm aq sa ti; 2. deri, gjer; ***akşama kadar,*** deri në mbrëmje; ***İstanbula kadar***, deri në Stamboll; ***ben gelinceye kadar bekle***, prit më gjer sa të vij; 3. përafërsisht, rreth; ***iki hafta kadar kalacağım***, do të mbes rreth (përafërsisht) dy javë
kadayıf *em* kadaif
kadeh *em* 1. gotë e vogël për raki; 2. sasija e pijes që ndodhet në gotë
kademe *em* 1. rang, shkallë, gradë; ***kademe kademe*** ca nga ca, shkallë shkallë; 2. pozitë, funksion
kader *em* e ardhme, fat, kësmet, përcaktim
kaderci *em* fatalist
kadercilik *em* fatalizëm
kadın *em* 1. grua, zonjë, damë; 2. shërbëtore
kadife *em* kadife
kadro *em* kuadër, personal (i ndonjë enti)
kadrolu *mb* personal i përhershëm (i entit)
kafa *em anat* kokë, krye; ***boş kafa***, kokë e zbrazët; ***kafası işlemez***, nuk i punon koka; ***kafası kalın***, kryetrashë
kafalı *mb fig* inteligjent, i zgjuar, i mençëm, me inteligjencë
kafasız *mb* kokëtrashë
kafa tası *em anat* kafkë, rrashtë koke, rradake
kafein *em* kafeinë
kafes *em* kafaz
kafeterya *em* kafeteri
kâfi *mb* i mjaftueshëm, që mjafton; *ndf* mjaft
kafile *em* grup udhëtarësh, varg njerëzish në të hecur përpara; karavan; *usht* konvoj
kâğıt *em* letër

Copyrighted material

kâğıtçılık *em* industria e letrës
kahır *em* hidhërim, pikëllim
kahırlı *mb* i hidhëruar, i pikëlluar, i brengosur
kahkaha *em* qeshje gjëmuese; ***kahkaha atmak***, qeshem me zë gjëmuese
kahpe *em* lavirë, grua e ligë, kurvë; *fig* i pabesë, besëthyes, dinak, tinzak
kahraman *em* hero; trim, guximtar; ***milli kahraman***, hero popullor
kahrolmak *fl* (më vete) dëshprohem, hidhërohem, mërzitem, mundohem, brengosem, vuaj, heq keq; ***Kahrolsun***! *pasth* Qoftë e mallkuar! Le të zhduket! Posht!
kahvaltı *em* kafjallë, buka (ngrënja) e mëngjezit; ***kahvaltı etmek***, ha bukën e mëngjezit
kahve em 1. *bot* dru; 2. kafe (frut); 3. kafe (pije e ngrohtë); 4. kafene
kahvehane *em* kafene
kahverengi *em* ngjyrëkafe
kâhya *em* drejtues pasurie, qehaja
kaide *em* rregull, bazë, princip; ***kaide olarak***, sipas rregullit; ***gramer kaideleri***, rregulla gramatikore
kaka *em* 1. (në gjuhë të fëmijëve) kakë, ndyrësi; 2. *mb* i ndyrë, i keq
kakmak *fl* 1. ngjesh, rras, shtyj; 2. ngul; 3. skalit, gdhend, latoj
kaktüs *em bot* kaktus
kakül *em* kaçurrel, krela
kaküllü *mb* me kaçurrela, me krela
kala *em* në, deri, gjer, mbetur; (*saat*) ***beşe on kala***, dhjetë minuta gjer më pesë (për kohë); ***köye üç kilometre kala benzin bitti***, mbeti edhe tre kilometra gjer në fshat benzina mbaroi (për distancë)
kalabalık *em* 1. turmë, grumbuj njerëzish (për njerëz); 2. *mb* i shumtë, i pa numërt; ***kalabalık bir şehir***, qytet me shumë banorë; ***kalabalık bir aile***, familje e madhe (me shumë antar)
kalamar *em zool* sipë, cipë
kalas *em* dërrasë e trashë dhe e gjatë
kalay *em kim* 1. kallaj; 2. *fig* gënjeshtër; 3. *fig* sharje
kalaylamak *fl* 1. kallajis; 2. *fig* fsheh (mangësitë e veta); 3. *fig vullg* shaj shumë
kalaylı *mb* i kallajisur
kalaysız *mb* i pakallajisur, pa kallaj
kalbur *em* shoshë (me vrima të mëdha)
kalbucu *em* shoshar
kalburlama *em* shoshitje
kalburlamak *fl* shoshit, shoshis
kalburlanmak *fl* shoshitem
kalça *em anat* kofshë, kërdhëkull, ***kalça kemiği***, asht kofshe
kaldıraç *em fiz* lloz
kaldırım *em* 1. rrugë e shtruar me gurë; kalldërm; 2. trotuar
kaldırımlı *mb* me trotuar, me kalldërm
kaldırma *em* ngritje, naltësim
kaldırmak *fl* 1. ngre, naltësoj; 2. tërheq, bart; ***arabam bu yükü kaldırmaz***, qerrja ime nuk e bartën këtë barrë; 3. heq ,

Copyrighted material

abrogoj (një ligj), anuloj (një vendim), nxjerr nga përdorimi, shfuqizoj; 4. duroj (ofendimin); 5. zgjoj (nga gjumi); 6. varros
kale *em* 1. fortesë, kala, kështjellë; 2. *sp* portë (në futboll); kala (në lojën e shahut)
kaleci *em sp* portier (në futboll)
kalem *em* laps
kalemtraş *em* mprehës lapsi
kalfa *em* 1. kalfë; 2. mjeshtër murator, ndihmë arkitekti; 3. njeri që fëmijët i çon në shkollë
kalıcı *mb* i përhershëm, i vazhdueshëm, permanent
kalıcılık *em* përherëshmëri
kalın *mb* i trashë; ***buz kalındır***, akulli është i trashë
kalın barsak *em anat* zorrë e trashë
kalınlık *em* trashësi
kalıntı *em* 1. mbeturinë, tepricë, ajo që mbetet; 2. mbeturinë, gërmadhë, rrënim (historike, arkitekte)
kalıp *em* kallëp, shabllon, model
kalıplaşmak *fl* fitoj trajtën e kallëpit, jap një formë (një trajtë)
kalış *em* qëndrim, mbetje
kalıt *em* trashëgim
kalıtım *em biol* gjenetikë
kalıtımsal *mb* i trashëguar, trashigues, gjenetik; ***kalıtımsal hastalık,*** sëmundje trashiguese
kalite *em* cilësi, kualitet
kaliteli *mb* cilësorë, me cilësi të mirë, i kualitetshëm, me kualitet të mirë
kalitesiz *mb* që nuk ka cilësi të mirë, me kualitet të keq
kalkan *em* 1. mburojë; 2. *fig* ai ë del zot, mbrojtës; 3. *zool* lloj peshku (*Skophtalmus Maximus*)
kalkınma *em* zhvillim, përparim, ngritje
kalkınmak *fl* zhvillohem, përparoj
kalkışma *em* orvatje, tentativë
kalkışmak *fl* orvatem, filloj, zë, nis (një punë); vendos, tentoj (të bëj një punë)
kalkmak *fl* ngrihem, çohem (në këmbë); nisem
kalleş *mb* i pabesueshëm, dinak, tinzak
kalleşlik *em* pandershmëri, poshtërsi, mashtrim, dredhi, tradhti; ***kalleşlik etmek***, mashtroj, nuk e plotësoj premtimin
kalma *em* mbetje, të mbeturit
kalmak *fl* 1. mbes, ngel; 3. banoj; 4. mbetem (në klasë), përsëris (klasën); 5. ndalem, mbetem (në një kohë më të gjatë); 6. shtyj, vonoj, pezulloj; ***yolculuğumuz gelecek haftaya kaldı***, udhëtimi i ynë mbeti për javën e ardhshme
kalori *em fiz* kalori (njësi për matjen e nxehtësisë)
kalorifer *em* 1. instalim për ngrohje qendrore; 2. *pop* radiator
kalorimetre *em* kalorimetër
kalp *em anat* zemër; ***kalp atışı*** (***çarpıntısı***), rrahja e zemrës
kalp *mb* i rrejshëm, jo i vërtetë, i falsifikuar; ***kalp para***, para e falsifikuar
kalpazan *em* falsifikator
kalpazanlık *em* fallsifikim
kalpsız *mb fig* i pandieshëm, i pazemër, zemërgur
kalpsizlik *em* pandiesi

Copyrighted material

kalsiyum *em kim* kalcium
kama *em* kamë (thikë)
kamalamak *fl* vras me kamë
kamara *em* 1. kabinë (në anije), një nga kthinat e vogla në anije; 2. Trup ligjdhënës në Angli; ***Lortlar kamarası***, Kabinë e lordeve
kamarat *em* kamarier i anijes, stjuard i anijes
kamaşmak *fl* 1. (për sytë) verbohem për një moment (nga drita e fortë); 2. (për dhëmbët) mpihet (nga diçka e tharët)
kambiyo *em* 1. këmbim (i valutave); 2. këmbimore
kambur *em* gungë, xhungë, dalje kurrizi; 2. *mb* i gungëzuar
kamçı *em* kamxhik, kërbaç
kamçılamak *fl* rrah me kamxhik
kamer *em astr* hënë, satelit i tokës
kamera *em* kamerë
kameraman *em* kameraman
kamış *em* 1. *bot* kallam, ***kamış dam***, mbulesë (çati) kallami; 2. *vulg* organ mashkulli
kamp *em* 1. kamp; 2. kampim; ***toplama kampı***, kamp përqendrimi
kampana *em* kambanë
kampanya *em* fushatë
kampüs *em* kompleks universiteti (ndërtesa, objekte, fusha sportive etj.)
kamu *mb* publik/e, shoqëror/e, shtetror/e; ***kamu düzeni***, rendi shoqëror
kamuflaj *em* kamuflim, maskim, fshehje
kamufle *mb* i kamufluar, i maskuar, i fshehur; ***kamufle etmek***, maskoj, fsheh
kamulaştırma *em* shpronëzim, nacionalizim
kamulaştırmak *fl* nacionalizoj, kryej nacionalizmin, shtetëzoj, shpronësoj
kamuoyu *em* mendim publik, opiniomi publik; ***kamu- oyu araştırması***, hulumtim i mendimit publik
kamusal *mb* publik
kamyon *em* kamion
kamyoncu *em* kamionist
kamyonet *em* kamionetë, kamion i vogël
kan *em anat* gjak; ***kan basıncı***, tension gjaku; ***kan dolaşımı***, qarkullim i gjakut; ***kan grupu***, grupi i gjakut; ***kan bağı***, lidhje gjaku; ***kan veren***, dhurues gjaku; ***kan davası***, hakmarje gjaku, armiqësi (me vdekje); ***kana susamış***, gjakpirës, gjakatar
kanaat em 1. kënaqësi (me atë që disponon), modesti; 2. bindje, bindshmëri
kanal *em* kanal
kanalizasyon *em* kanalizim
kanama *em* gjakim, derdhje e gjakut
kanamak *em* rrjedh gjaku
kanepe *em* kanape, kolltuk i gjerë me shpinëz
kanarya *em zool* kanarinë *(Serimus Canaria)*
kanat *em* fletë, krah (i zogut, i insektit, i aeroplanit *)*
kanca *em* kanxhë, çengel, grremç
kandırmak *fl* bind (dikë), i mbush mendjen dikujt, kandis

Copyrighted material

kanguru *em zool* kangur
kanı, kanış *em* bindje
kanıt *em* argument, dëshmi, vërtetim, provë
kanıtlamak *fl* argumentoj, dëshmoj, vërtetoj
kanlama *em* gjakosje
kanlamak *fl* gjakos
kanlanmak *fl* gjakosem
kanlı *mb* i gjakosur, i gjakshëm, i përgjakshëm
kanmak *fl* 1. bindem, kandisem; 2. pajtohem; 3. mashtrohem;
kanser *em med* kancer
kanserli *mb* me kancer, i sëmurë nga kanceri
kansız *mb* 1. *med* anemik; 2. i pagjak
kantin *em* kantinë
kanun *em* ligj; ***kanın dışı***, jasht ligjit; ***kanuna göre***, sipas ligjit; ***kanunu kırmak***, thyej ligjin
kanun *em muz* një lloj instrumenti me tela
kanunen *ndf* ligjërisht, sipas ligjit
kanunî *mb* ligjor, i ligjshëm, ***kanunî karar***, vendim ligjor
kanunilik, kanunluluk *em* ligjëshmëri
kanunlu *mb* ligjor
kanunsuz *mb* i paligjshëm, joligjor
kanyak *em* konjak (pije)
kap *em* 1. enë; 2. ambalazh; këllëf, strajcë, sandëk etj.
kapak *em* 1. kapak, mbulese ene; 2. derë (e dollapit etj); 3. kapak (i librit)
kapaklanmak *fl* rrëzohem me fëtyrë nga dheu (për shkak të pengesës të këmbës)
kapalı *mb* i mbyllur; 2. i mbuluar; ***kapalı çarşı***, çarshia e mbuluar; 3. *fig* i mbyllur në vehte, misterioz; 4. i paqartë, i pakuptueshëm (bisedim); 5. i vrenjtur (për kohën); ***kapalı hava***; kohë e vrenjtur
kapama *em* mbyllje, mbyllim
kapamak *fl* mbyll (dikë a diçka); ***kapıyı kapa***, mbylle derën; 2. mbuloj; 3. pengoj, mbyll, vë pengesa; 4. burgos
kapan *em* grackë, kurth
kapanış *em* 1. mbyllje; 2. përfundim; 3. mbarim (i mbledhjes, kongresit etj)
kapanmak *fl* mbyllem; mbulohem; shërohet, mbyllet (plaga); verbërohem; ***trafik kazasından sonra bir gözü kapandı***, pas aksidentit trafik njëri sy u verbua
kaparo *em* kapar, paradhënie; ***kaparo vermek***, jap kapar
kapasite *em* kapacitet
kapı *em* derë; ***kapıyı çalmak***, e trokas derën
kapıcı *em* portier, derëtar
kapılmak *fl* 1. rrokem (nga diçka); 2. bie (nën ndikimin e dikujt
kapışmak *fl* grindem, zihem, përleshem
kapital *em* kapital
kapitalist *em* kapitalist
kapitalizm *em* kapitalizëm
kaplama *em* shtresë e hollë mbulese, mbulesë
kaplamak *fl* mbuloj, vesh (me një shtresë të hollë)

Copyrighted material

kaplan *em zool* tigër
kaplı *mb* i mbuluar
kaplıca *em* burim i nxehtë, banjë
kaplumbağa *em zool* breshkë
kapmak *fl* zë, rrok, kap
kaporta *em oto* 1. mbulesë e motorit; 2. mbulesë e automobilit (e bërë përgjithësisht prej llamarine), kaportë
kaportacı em kaportandreqës
kapris *em* inat, kapricë
kaprisli *mb* kapricioz
kapsamak *fl* përmbaj, përfshij, kaploj
kapsamlı *mb* i gjithëpërfshirës, i tërësishëm
kapsül *em* kapsollë
kaptan *em usht* kapiten, kapedan
kaput *em* 1. kapotë, pallto ushtarake; 2. mbulesë e motorit të automobilit
kar *em* borë; ***kar yağıyor,*** bie borë; ***kar topu***, top bore; ***kar gibi beyaz***, i bardh si bora; ***kar fırtınası,*** stuhi bore
kâr *em* fitim, përfitim, dobi, qar; ***kâr etmek***, fitoj, nxjerr dobi (nga një punë)
kara *mb* i zi, e zezë
kara *em* tokë, truall; ***karaya çıkmak***, zbres nga anija, shkel në tokë
karabiber *em bot* piper i zi
karabimyer *em* karabinier, xhandar italian
karaborsa *em* treg i zi, treg jo ligjor
karaborsacı *em* njeri që merret me treg të zi
karaca *mb* zeshkan/e, zeshkaman/e, ziash/e
karaca *em zool* kaproll
karaciğer *em anat* mëlçi e zezë
Kara Deniz *em* Deti i Zi
kara haber *em* lajm i zi
karakış *em* dimër i ashpër
karakol *em* 1. stacion i policisë; 2. patrullë
karakter *em* karakter
karakteristik *em* karakteristikë, veçori, cilësi, veti karakteristike; *mb* karakteristik/e
karakterli *mb* i karaktershëm, me karakter
karaktersiz *mb* pa karakter
karalamak *fl* 1. nxij (diçka), lyej me ngjyrë të zezë; 2. njollos, ndyj; 3. fshij (me viza), shkaravis; 4. konceptoj; 5. *fig* shpif, turpëroj (dikë)
karamsar *em* pesimist; *mb* pesimist/e, i pikëlluar
karamsarlık *em* pesimizëm
karanfil *em bot* karafil (lule)
karanlık *em* errësirë, terr
karar *em* vendim, dekret, rezolutë; *jur* aktgjykim, vendim gjyqi; ***karar vermek***, vendos, sjell vendim
karargâh *em usht* shtab
kararlaştırmak *fl* vendos
kararlı *mb* 1. i vendosur;2. *fiz* stabil; ***kararlı denge***, drejtpeshim stabil
kararlılık *em* 1. vendosmëri; 2. stabilitet, qëndrueshmëri
kararma *em* errësim
kararmak *fl* nxihem, bëhem i zi; 2. errësohet, ngryset

Copyrighted material

kararname *em* 1. dekret, urdhëresë me fuqi ekzekutive; 2. vendim i shkruar
kararsız *mb* i pavendosur, i luhatshëm, i dyshimtë, i paqëndrueshëm, i lëkundshëm; jo stabil; ***kararsız denge***, derjtëpeshim labil
kararsızlık *em* pavendosmëri, paqëndrueshmëri, lëkundshmëri, labilitet
karartmak *gl* 1. errësoj, terroj; 2. lyej me ngjyrë të zezë, nxij; 3. *fig* turpëroj (dikë), poshtërsoj
kara sevda *em* 1. dashuri e fort pa shpresë; 2. brengë, shtypje shpirtërore, melankoli
karasular *em* ujëra territoriale (të një shteti)
kara tahta *em* dërrasë e zezë (shkollore)
karate *em sp* karate
karavana 1. enë e madhe ushtarake ushqimore; 2. ushqim (në internat, në ushtri etj); 3. diamant shpatuk
karayel *em* erë veriperëndimi
karayol *em* rrugë toksor
karbon *em kim* karbon; ***karbon kâğıdı***, kopiativ, letër kopjimi
karbonat *em kim* acid karbonik
karbondioksit *em kim* karbon dioksid
karbonhidrat *em kim* karbon hidrat
karbüratör *em oto* karburator
kardeş *em* vëlla, motër
kardeşçe *ndf* vëllazërisht
kardeşlik *em* 1. vëllazërim, vëllazëri; marrëdhënie vëllazërore; 2. fis, mik i afërt i pranuar si vëlla
kare *em mat* 1. katror
karekök *em mat* rrënja katrore
kareli *mb* i shkaravitur me katrora; ***kareli kumaş***, stof me katrora; ***kareli defter***, fletore me katrora
karga *em zool* galë; ***karga bok yemeden***, shumë herët, në agim
kargaşa *em* anarki, çrregullim, përzierje, kaos
kargaşacı *em* anarkist
kargo *em* 1. anije që bart barrë, ngarkesë; barra, ngarkesa e aeroplanit, e anies etj
karı *em* 1. grua, femër; 2. grua e martuar, bashkëhorte; ***karı koca***, burrë e grua
karın *em anat* stomak, bark, abdomen; ***karın ağrısı***, dhembja e barkut
karınca e*m zool* thnegëll, milingonë, mizë përdhese
karış *em* pëllëmbë
karışık *mb* i përzier (p. sh. : vera me ujë); 2. i komplikuar, i ndërlikuar, i ngatërruar; i përbërë; 3. i paqartë; i pakuptueshëm (për bisedime); 4. (sipas besimit popullor): njeri i lidhur me xhinde e zana (ninfa)
karışıklık *em* 1. komplikim; ndërlikim, ngatërrim; 2. çrregullsi; tollovi; konfuzion
karışım, karışma *em* përzierje
karışmak *fl* 1. përzihem; ***su ile yağ karışmaz***, uji me vajin nuk përzihen; ***su ile sirke karışır***, uji me uthullin përzihen; 2. ndërlikohem, ngatërrohem (flokët); 3. ndërhyj, përzihem; ***sen***

Copyrighted material

bu işe karışma, ti mos u përzi në këtë punë
karıştırmak *fl* përziej, ndërlikoj, ngatërroj,
karides *em zool* një lloj gafore (*Palaemon*)
karikatür *em* karikaturë
karikatürcü *em* karikaturist
kariyer *em* karierë
karlı *mb* me borë, i borës
kârlı *mb* fitimprurës, i leverdishëm, i dobishëm; ***kârlı iş*** punë e dobishme (që sjell fitim)
karma *mb* i përzier, i kombinuar; ***karma takım***, skuadër i kombinuar
karmakarışık *mb* i shpërndarë, tepër i ngatëruar, i përmbysur, i çrregulluar
karmaşık *mb* 1. i përzier, i përbërë (prej disa elementeve); 2. i komplikuar, i ndërlikuar
karnabahar *em bot* lule lakër
karne *em* librezë, ***öğrenci karnesi***, librezë nxënësi; ***sağlık karnesi***, librezë shëndetëse;
karpuz *em bot* shalqi
karşı *mb ndf* i kundërt; ***karşı taraf***, ana e kundërt; ***karşıya geçti***, kaloi në anën e kundërt (të rrugës) 2. para, përpara; ***okulun karşısı***, përpara shkollës; ***müdürün karşısına çıktı***, doli (qëndroj) para drejtorit; 3. kundër; ***ben bu öneriye karşıyım***, unë jam kundër këtij propozimi; 4. përkundrejt; ***buna karşın***, përkundrejt kësaj; ***karşı hücum***, kundërsulm; ***karşı teklif***, kundër propozim; ***karşı devrim***, kundër revolucion; ***insanlara karşı sevgi***, dashuri ndaj njerëzve; ***karşı değilim***, nuk jam kundër
karşılama *em* pritje
karşılamak *fl* 1. pres (diçka ose ardhjen e dikujt); pranoj; ***bu haberi sevinçle karşıladım***, këtë lajmë e prita me kënaqësi; ***önerinizi iyi karşıladılar***, propozimin tuaj e pranuan me kënaqësi; 2. kompensoj, shpagoj; ***yapılan harcamaları karşıladılar***, shpenzimet i bëra e kompenzuan
karşılaşma *em* 1. takim, kontakt; 2. mbledhje; 3. *sp* ndeshje; ***futbol karşılaşması*** ndeshje futbolli
karşılaştırma *em* krahasim, barazim
karşılaştırmak *fl* krahasoj
karşılık *em* 1. kthim (me masë të njëjtë), hakmarje; ***karşılık vermek***, jap përgjigje me të njëjtën masë, reagoj; 2. përgjigje; 3. reciprocitet
karşılıklı *mb* reciprok (midis dy vetëve); ***karşılıklı güven***, besim reciprok; *ndf* reciprokisht
karşın *parfj ndf* përballë, përkundër, ndaj, megjithatë, ndonëse, edhe pse
karşıt *mb* kundërt; ***karşıt anlamlı***, me kuptim të kundërt (ngrohtë – ftohtë)
kart *mb* 1. i vjetër, i moçëm; ***kart tavuk***, pulë e moçme (nuk është zog); 2. bajat, nuk është taze
kart *em* kartë

Copyrighted material

kartal *em zool* shqiponjë, shqipe, skifter
karton *em* karton
kartotek *em* kartotekë
kartpostal *em* kartëpostale
kartvizit *em* kartëvizitë
karyola *em* krevat
kas *em anat* muskul
kasa *em* 1. arkë, kasë; kasafortë; 2. zyrë arkëtari; 3. arkë, sëndyk (për nevoja të ndryshme); 3. kornizë (e derës, e dritares etj)
kasaba *em* qytet i vogël
kasabalı *mb* qytetar
kasadar *em* arkëtar
kasap *em* 1. kasap; mishtar; 2. mishtore, mishshitës
kâse *em* enë e vogël dhe e thellë, tas
kaset *em* kasetë
kasık *em anat* kliza e kofshës
kasılmak *fl* shkurtohem, ngushtohem, rrudhem
kasım *em* nëntor (muaj)
kasımapti *em bot* krizantemë, lule shënmitri
kasınç *em* ngreç, ngërth
kasırga *em* 1. ciklon, stuhi, erë e fuqishme dhe e tmerrshme, shakullinë, stërgatë; 2. *fig* shqetësim i fortë
kasıt *em* 1. qëllim; 2. *fig* paramendim (qëllim i keq)
kasıtlı *mb* qëllimor, i qëllimshëm, me paramendim, me dashje, me vetëdije
kasıtsız *mb* i pa qëllim, që është bërë pa qëllim të keq, me pahirë
kasiyer *em* arkëtar
kasket *em* kasketë, kësulë, kapelë
kasko *em* sigurim i automobilit
kasnak *fl* 1. rreth, unazë (i sitës, i dajres etj. përgjithësisht e bërë prej druri); 2. rreth për qëndisje; 3. rrotë transmetuese (nëpër maqina të ndryshme)
kasten *ndf* qëllimisht, me qëllim
kastetmek *fl* kam për qëllim, synoj, mendoj
kasvet *em* mjerim, brengë, brengosje, hidhërim, pikëllim, trishtim
kasvetli *mb* i mjeruar, i brengosur, i hidhëruar, i pikëlluar, i helmuar, i trishtueshëm
kaş *em anat* vetull; ***kaşlarını çatmak***, ngrys vetullat
kaşar *em* kaçkavall, lloj djathi
kaşe *em* vulë
kaşık *em* lugë
kaşımak *fl* kruaj, gërryej
kaşınma *em* kruarje
kaşınmak *fl* kruhem
kaşıntı *em* kruarje, të kruarit
kâşif *em* zbulues, hulumtues, gjurmues; çpikës, shpikës
kaşkol *em* shall
kat *em* 1. kat; ***üçüncü kat***, kati i tretë; 2. banesë (në apartament); 3. shtresë; 4. palë (për rrobe); ***bir kat yeni elbise satınaldım***, bleva një palë rrobe të reja; 5. pozitë; 6. rrudhë
katalog *em* katalog
katar *em* varg
katedral *em* katedrale
kategori *em* kategori
kategorik *em* kategorik
